



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 150 Akti

Nr. 227 Vendimi  
Tiranë, më 17.1.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në Tiranë, në datën 14.1.2020, ora 14.00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Sandër Simoni**, gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i cili kërkoj konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Sandër Simoni, vëzhguesin ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Sandër Simoni, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

Subjekti i rivlerësimit, z. Sandër Simoni, ushtron detyrën e gjyqtarit/kryetarit të gjykatës, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtuar rivlerësimit, *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit u është nënshtuar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15 maj 2018 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bektishi, Alma Faskaj dhe Roland Ilia. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Alma Faskaj.

Me vendimin e Komisionit nr. \*\*\*, datë 16.7.2018 u vendos rishpërndarja e çështjeve të komisioneres Alma Faskaj dhe nga procedura e shortit u caktua si komisioner zëvendësues dhe njëherazi relator, komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr. 1, datë 8.10.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ mbështetur në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Sandër Simoni në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Brunilda Bektishi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Elka Ermenkova.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 16.12.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Sandër Simoni, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 16.12.2019, mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, në datën 9.1.2020.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 14.1.2020, ora 14:00, në sallën e konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, i cili parashtrroi shpjegimet e tij në seancë dhe i depozitoi me shkrim në Komision.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit z. Sandër Simoni, kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Sandër Simoni ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Sandër Simoni, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit u krye për të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Sandër Simoni, i cili është subjekt deklarues në ILDKPKI, që prej vitit 2003, me nr. indeksi \*\*\*, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 27.1.2017.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo aset të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*

### **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, drejtoritë vendore të kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a., zyra noteriale, DRSSH-të etj.;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive

në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, neni 33, e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1<sup>1</sup>, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Sandër Simoni, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

➤ Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë - shtojca 2.

**1. Apartament me sip. 116.2 m<sup>2</sup>, në vlerën 6,500,000 lekë, nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Njësia Administrative nr. \*\*\*, Tiranë.** Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: kredi bankare në “Raiffeisen Bank” në shumën 5,000,000 lekë; kursime nga pagat dhe të ardhurat në vitet 2004 - 2005.

ZVRPP-ja Tiranë<sup>2</sup> ka konfirmuar regjistrimin në emër të z. Sandër Simoni të pasurisë së llojit “apartament” me sip. 116.2 m<sup>2</sup> <sup>3</sup> me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, përfituar me kontratën e shitjes datë 29.10.2011<sup>4</sup> me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerës Sandër Simoni për çmimin 6,500,000 lekë. Subjekti është pajisur me certifikatën për vërtetim pronësie datë 30.10.2006.

Subjekti ka depozituar aktmarrëveshjen e datës 1.9.2005, lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me cilësinë e sipërmarrësit dhe z. Sandër Simoni si porositës për ndërtimin e apartamentit në katin e \*\*\*, 2+1, me sip. 116.2 m<sup>2</sup> me vendndodhje në Rr. “\*\*\*\*”.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2005 subjekti ka deklaruar: “*Prenotim i një apartamenti banimi në ndërtim e sipër, i paregjistruar, 2+1, sip. 116 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, Tirana e Re mbi bazën e lejes së ndërtimit. Vlera: 6,500,000 lekë. Pjesa takuese 100 %*”. Nuk deklarohet burimi i krijimit.

Në aktmarrëveshje pasqyrohet vlera e përgjithshme e apartamentit në shumën 6,500,000 lekë, e cila do të shlyhet me këste në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.:

- kësti i I-rë, në vlerën 1,500,000 lekë do të shlyhet datën e lidhjes së aktmarrëveshjes;
- kësti i II-të, në vlerën 5,000,000 lekë do të shlyhet tre muaj pas likuidimit të këstit të parë.

Subjekti ka depozituar pagesat e bëra për llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>5</sup>

Komisioni ka hetuar në lidhje me çmimin e blerjes të këtij apartamenti nga subjekti i rivlerësimit, pasi duke llogaritur çmimin total të blerjes prej 6,500,000 lekësh për sip. 116.2 m<sup>2</sup>, rezultoi se çmimi i blerjes për m<sup>2</sup> i apartamentit është 55,938 lekë/m<sup>2</sup> ose 452 euro/m<sup>2</sup> (1 euro =123.88 lekë sipas kursit të këmbimit) ose 558 USD (1 USD =100.18 lekë). Për këtë qëllim, Komisioni ka kërkuar kontrata të ngjashme në të njëjtën ndërtesë dhe për të njëjtën periudhë.

<sup>1</sup> Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë në ILDKPKI.

<sup>2</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë.

<sup>3</sup> Pasuri me nr. \*\*\*, z.k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*.

<sup>4</sup> Kontrata e shitjes së apartamentit nr. \*\*\*, datë 29.10.2011 mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe z. Sandër Simoni.

<sup>5</sup> Mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 1.9.2005 në shumën 1,000,000 lekë, arkëtuar nga z. Sandër Simoni “për këstin e ap. 2+1, kati \*\*\*, teknik”; mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 30.12.2005, në shumën 5,000,000 lekë, arkëtuar nga Sandër Simoni; mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 18.4.2006, në shumën 250,000 lekë, arkëtuar nga Sandër Simoni; mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 20.10.2011, në shumën 250,000 lekë, arkëtuar nga Sandër Simoni.

Komisioni ka kërkuar nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., t’i vihen në dispozicion kontrata sipërmarrjeje të vitit 2005, që shoqëria ka lidhur me subjekte të tjera për apartamente tek e njëjta ndërtesë ku është dhe apartamenti i subjektit, për të krahasuar çmimet e aplikuara.

Shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.<sup>6</sup> ka vënë në dispozicion të Komisionit 6 (gjashtë) aktmarrëveshje të lidhura në periudhën 2003 – 2005 midis shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe subjekteve të ndryshme (ku një ndër këto aktmarrëveshje është ajo e lidhur me subjektin Sandër Simoni)<sup>7</sup>.

Referuar aktmarrëveshjeve të dërguara nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., vërehet se ky apartament i është shitur subjektit Sandër Simoni me çmim më të ulët në krahasim me çmimin e ofruar subjekteve të tjera përfitues në kontratat përkatëse.

Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 6,500,000 lekë (çmimi i blerjes së apartamentit) të përbërë nga:

- kredi bankare (në “Raiffeisen Bank” në shumën 5,000,000 lekë);
- kursime nga pagat e të ardhurave në vitet 2004-2005, në shumën 1,000,000 lekë;
- detyrimi ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., në shumën 500,000 lekë.

**a) Kredia me kushte lehtësuese e përfituar nga subjekti Sandër Simoni, në shumën 5,000,000 lekë.**

“Raiffeisen Bank”<sup>8</sup> ka përcjellë dokumentacionin në lidhje me kredinë bankare me kushte lehtësuese që ka përfituar subjekti Sandër Simoni, ku përfshihet dhe marrëveshja e lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe “Raiffeisen Bank” sh.a., datë 20.6.2005 me qëllim trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore sipas listës së Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, “Raiffeisen Bank”<sup>9</sup>, ka vënë në dispozicion të Komisionit listën e funksionarëve dhe nëpunësve të cilëve do t’u jepet kredi për strehim nga kjo bankë (listë kjo e miratuar nga Kryeministri), ku rezulton edhe emri i subjektit Sandër Simoni me nr. rendor \*\*\*, për shumën e kredisë 5,000,000 lekë.

Në datën 9.11.2005 është lidhur kontrata e kredisë bankare (për blerje shtëpie banimi ose rikonstrukcion) me kredihënës “Raiffeisen Bank” sh.a. dhe kredimarrës Sandër Simoni për shumën 5,000,000 lekë, me afat shlyerje 300 muaj (ose 25 vjet).

VKM-ja nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore” ka përcaktuar si kriter në pikën 2 të saj që nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, të mos kenë banesë në momentin që ata përfitojnë kredinë e butë nga shteti dhe më konkretisht: “Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të

---

<sup>6</sup> Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2019, nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.

<sup>7</sup> Aktmarrëveshja e datës 4.8.2005 për apartamentin me sip.  $136.6 \text{ m}^2 \times 800 \text{ euro/m}^2 = 109,280 \text{ euro}$ , me adresë: Rr. “\*\*\*”, Tiranë; aktmarrëveshja e datës 1.9.2005 për apartamentin me sip.  $116.2 \text{ m}^2 = 6,500,000 \text{ lekë}$ . (Marrëveshja me subjektin) çmimi për  $\text{m}^2$  e llogaritur me kursin ditor të Bankës së Shqipërisë është 55,938 lekë:  $100.10 \text{ (lekë} = 1 \text{ USD)} = 558 \text{ USD/m}^2$ ); aktmarrëveshja e datës 7.3.2003 për apartamentin me sip.  $134 \text{ m}^2 \times 600 \text{ USD/m}^2 = 80,400 \text{ USD}$ ; aktmarrëveshja e datës 8.3.2003 për apartamentin me sip.  $138.5 \text{ m}^2 \times 700 \text{ USD/m}^2 = 96,950 \text{ USD/m}^2$ ; aktmarrëveshja e datës 9.8.2004 për apartamentin me sip.  $131.9 \text{ m}^2 + 131.57 \text{ m}^2 = 263.4 \text{ m}^2 \times 900 \text{ euro/m}^2 = 237,060 \text{ euro}$ ; aktmarrëveshja e datës 30.1.2004 për apartamentin me sip.  $142.1 \text{ m}^2 \times 700 \text{ euro/m}^2 = 99,470 \text{ euro}$ .

<sup>8</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>9</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2018, nga “Raiffeisen Bank”.

*administratës së lartë shtetërore janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqeje banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti”.*

Subjekti i rivlerësimit, në momentin që ka përfituar kredinë me kushte lehtësuese të miratuar nga shteti, nuk ka pasur banesë tjetër, kështu dhe përfitimi i kredisë është bërë në përputhje të zbatimit të VKM-së nr.102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

➤ **Në lidhje me kontratën e kredisë bankare, lidhur me “Raiffeisen Bank”, ku është vënë si fillim garanci për sigurimin e kredisë pasuria e paluajtshme në emër të shtetas H.K.**

Subjekti ka depozituar kontratën e kredisë bankare të datës 9.11.2005<sup>10</sup> lidhur me kredidhënësin “Raiffeisen Bank” dhe kredimarrësin Sandër Simoni për dhënie kredie (për blerje shtëpie banimi ose rikonstrukcion), në shumën 5,000,000 lekë.

Kontrata, në nenin 6 të saj “sigurimi i kredisë”, parashikon që kredimarrësi siguron bankën me anë të garancisë nga hipotekimi i pasurisë së paluajtshme sipas kontratës së hipotekës nr. \*\*\*, datë 9.11.2005.

“Raiffeisen Bank”, në përgjigje të saj, ka konfirmuar dhënien e kësaj kredie subjektit në datën 24.11.2005, në shumën 5,000,000 lekë duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës.

“Raiffeisen Bank” ka vënë në dispozicion kontratën e hipotekës datë 9.11.2005,<sup>11</sup> ku shtetasja H.K. (përfaqësuar me prokurë nga z. S.K.), për të garantuar shlyerjen e plotë të detyrimit në shumën 5,000,000 lekë, marrë nga z. Sandër Simoni, ka vënë garanci në favor të bankës pasurinë “apartament” me sip. totale 41.71 m<sup>2</sup>, në adresën: Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë lidhjen me shtetasit H.K. dhe S.K. (i biri), të cilët kishin dalë garant në “Raiffeisen Bank” për të garantuar me pasuri të paluajtshme kthimin e kredisë së marrë nga subjekti.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se me shtetasen H.K. ka miqësi të vjetër familjare të hershme që në vitet 1970 –1980. Babai dhe ish-bashkëshorti i shtetas H.K. kanë krijuar njohje familjare. Arsyeja e vënies së apartamentit të saj si garanci ka qenë tërësisht humane, ngaqë subjekti në kohën kur ka prenotuar apartamentin për marrjen e kredisë i duhej vënë një pasuri në kolateral, gjë që u mundësua nga mikja e familjes, e cila dispononte pasurinë e paluajtshme në Tiranë. Subjekti deklaron se ka bërë dhe ndërrimin e kolateralit, ku si garanci u vu apartamenti në fjalë i subjektit.

Subjekti shpjegon me tej se: “Shtetasi S.K. është djali i shtetas H.K. dhe ish të ndjerit R.K., i cili ka nënshkruar kontratën e garancisë hipotekore në emër të nënës së tij.”

Subjekti ka depozituar dhe dokumentin bankar me titull “veprim arke” lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, datë 30.12.2005, ku ka tërhequr *cash* shumën 5,000,000 lekë, si dhe kontratën e hipotekës së datës 6.1.2012<sup>12</sup> me hipotekues shtetasit Sandër Simoni dhe A.J., të cilët kanë vënë si garanci apartamentin me sip. 116.2 m<sup>2</sup>.

**b) Kursime nga pagat e të ardhurat në vitet 2004 - 2005, në shumën 1,000,000 lekë, si burim i dytë krijimi për diferencën e çmimit të apartamentit.**

<sup>10</sup> Kontrata e kredisë bankare nr. \*\*\*, datë 9.11.2005.

<sup>11</sup> Kontrata hipotekore nr. \*\*\*, datë 9.11.2005.

<sup>12</sup> Kontrata e hipotekës nr. \*\*\*, datë 6.1.2012.

Subjekti ka deklaruar si burim krijimi për shumën 1,000,000 lekë, kursimet e vitit 2004 me një total prej 422,602 lekësh<sup>13</sup>, të deklaruara edhe në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2004, si dhe kursimet nga paga dhe mësimdhënia gjatë vitit 2005, të cilat janë disponuar në llogarinë rrjedhëse të pagës e më pas tërhequr në datën 25.7.2005, në shumën 605,500 lekë. Kjo tërheqje konfirmohet edhe nga dokumentacioni bankar i “Raiffeisen Bank”<sup>14</sup>.

Tabela e mëposhtme pasqyron aftësinë paguese të subjektit të rivlerësimit për pagesën e këstit të apartamentit në datën 1.9.2005, sipas burimit të deklaruar, duke llogaritur të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 1.1.2005 - 1.9.2005.

Data e veprimeve	Përshkrim	Vlera në lekë
1.1.2005	Likuiditete në <i>cash</i> 31.12.2004	422,602
1.1.2005	Likuiditete në bankë 31.12.2004	1,146
31.8.2005	Të ardhura nga pagat	1,703,478
31.8.2005	Shpenzime jetike	73,038
31.8.2005	Shpenzime <i>TIMS</i>	73,524
31.8.2005	Likuiditete në bankë ( <i>overdraft</i> )	-130,081
1.9.2005	Pagesë për këstin e apartamentit	1,000,000
	Aftësia paguese në momentin e pagesës së këstit të ap.	1,110,745

Sipas analizës financiare, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar këstin e apartamentit në shumën 1,000,000 lekë.

**c) Në lidhje me pjesën e mbetur subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 detyrimin ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shumën prej 500,000 lekësh.**

Në vitin 2006 subjekti ka likuiduar shumën prej 250,000 lekësh ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas mandatar-këtimit nr. \*\*\*, datë 18.4.2006. Si burim krijimi për shumën 250,000 lekë kanë shërbyer kursimet *cash* të vitit 2005. Nga analiza financiare për vitin 2006 subjekti rezulton me balancë pozitive.

Në deklaratat periodike vjetore të periudhës 2007 – 2010, subjekti ka deklaruar në mënyrë të saktë detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Në vitin 2011 subjekti ka kryer pagesën përfundimtare të vlerës së apartamentit në shumën e mbetur prej 250,000 lekësh, sipas mandatar-këtimit nr. \*\*\*, datë 20.10.2011. Referuar analizës financiare, viti 2011 rezulton me balancë pozitive (shikoni analizën financiare të viteve 2003 – 2016, f. \*\*\*).

➤ **Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit**

Komisioni ka hetuar dhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., ish-administratorin A.Ç., administratorin e ri L.V., shtetasit H. dhe S.K. dhe për këtë arsye ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe me Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda<sup>15</sup>.

<sup>13</sup> Kursimet *cash* në monedhë dollarë dhe në euro janë konvertuar sipas kursit të Bankës së Shqipërisë.

<sup>14</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>15</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2019; Gjykata e Krimeve të Rënda nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë të nëntorit 2019.



Nga përgjigjet e administruara nuk rezultojn të jenë dhënë vendime gjyqësore (civile apo penale) për subjektet e sipërcituar, nga subjekti i rivlerësimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit që nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. duket se është shitur me një çmim më të lirë, krahasuar me subjektet e tjera në të njëjtën ndërtesë.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se arsyet që e ka përfituar apartamentin me çmim të tillë janë, si vijon:

*“Marrëveshjen verbale për prenotimin e apartamentit me atë çmim unë e kisha bërë me shoqërinë në fillim të vitit 2004, kohë kur pallati ishte në ndërtim e sipër. Sipas marrëveshjes, unë do ta paguaja menjëherë, brenda vitit, të gjithë shumën sapo të merrja kredinë, ndryshe nga blerësit e tjerë që pagesat i bënin në shtrirje në kohë dhe me këste. Apartamenti i prenotuar nga ana ime ishte më i vogël në sipërfaqe se apartamentet e tjera që janë shitur më shtrenjtë e se sipërfaqja e përbashkët si holli, shkallët ishte e konsiderueshme në raport me sipërfaqen e brendshme të apartamentit tim, e cila është 90, 8 m<sup>2</sup>. Apartamenti im binte në një anë të pallatit (seksioni \*\*\*), që nuk ishte i preferuar për banorët e tjerë, nga ana e rrugës, e për shkak të zhurmës që kishte, ana e kundërt është shitur më shtrenjtë nga ana e shitësve.”*

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja Tiranë, “Raiffeisen Bank”, gjykatat, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., dokumentacionin e depozituar nga subjekti, si dhe deklaratimet e tij arrin në konkluzionin se:

- Nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarinimin e apartamentit me sip. 116.2 m<sup>2</sup> me adresë Rr. “\*\*\*\*”, pasi përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja Tiranë.
  - Nuk është konstatuar ndonjë situatë konflikti interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit Sandër Simoni me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., ish-administratorin A.Ç., administratorin e ri L.V., si dhe shtetasit H. dhe S.K.
  - Subjekti ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me njohjen me shtetasit H. dhe S.K., si dhe në lidhje me situatën e pasurisë së vënë si kolateral nga znj. H.K. për të garantuar kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit.
  - Subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredinë me kushte lehtësuese në përputhje me kushtet e VKM-së nr.102, datë 5.3.1999.
  - Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 116.2 m<sup>2</sup> nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.
  - Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshortja) kanë pasur mundësi financiare, të krijuara me burime të ligjshme financiare, për të paguar shumën prej 1,000,000 lekësh, në datën 1.9.2005, si këst për blerjen e apartamentit, duke rezultuar me një balancë financiare pozitive.
- 2. Automjeti tip “Ford Escort” me targa \*\*\*, prodhim i vitit 1989, posedimin faktik të të cilit subjekti e ka humbur që në vitin 2003 kur është larguar nga Shkodra, në proces**

**çregjistrimi, pasi nuk dispononte as automjetin, as targat dhe dokumentet e pronësisë së tij.**

Në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar vlerën e këtij automjeti dhe burimin e krijimit.

DPSHTRr-ja<sup>16</sup> ka të administruar shkresën e Drejtorisë Rajonale Shkodër, e cila në vërtetimin e datës 6.2.2019 shprehet se automjeti me targa \*\*\*, i tipit “Ford Escort” është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datën 20.11.2017, sipas kërkesës së aplikantit Sandër Simoni dhe bazuar në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 (i ndryshuar).

Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 subjekti ka deklaruar: “Autoveturë ford, 4+1, vlera 0.15 milionë lekë, pjesa 100 %, me burim: kursime familjare”.

Subjekti, duke qenë se ka deklaruar të humbur zotërimin faktit të këtij automjeti, i është drejtuar DPSHTRr-së për të kërkuar informacion nëse automjeti është i çregjistruar në sistem apo jo.

DPSHTRr-ja<sup>17</sup> ka vënë në dijeni subjektin se ndaj këtij automjeti nuk janë kryer procedura çregjistrimi dhe se ky automjet rezulton aktiv në sistemin elektronik të tyre.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRr-ja rezulton se ky automjet është përfituar nga subjekti me kontratën e shitblerjes datë 22.1.2003<sup>18</sup>, me shitës M.Sh. për vlerën 100,000 lekë. Deklarata doganore e datës 24.12.2002 pasqyron pagesën e detyrimit doganor në vlerën 150,713 lekë e paguar nga shitësi M.Sh.

Subjekti, në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI<sup>19</sup> në datën 23.1.2015, ka deklaruar se ka blerë automjetin tip “Ford Escort” në fund të vitit 2002 me vlerë 50,000 lekë dhe së bashku me doganën dhe targimin në fillim të vitit 2003 ka shkuar në vlerën 150,000 lekë, ashtu siç ka deklaruar.

Subjekti, në deklaratën pasurore për vitin 2003, ka deklaruar si burim krijimi për këtë automjet kursimet familjare. Referuar të ardhurave nga paga për periudhën 2000 – 2002, subjekti i rivlerësimit ka përfituar 1,391,018 lekë të ardhura. Gjatë kësaj periudhe rezulton se është blerë automjeti në vlerën 150,000 lekë dhe janë përballuar shpenzimet jetike në shumën 281,892 lekë. Subjekti i rivlerësimit rezulton me burime të mjaftueshme, të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe krijuar pasurinë.

	<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera në lekë</b>
<b>A</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>1,391,018</b>
1	Të ardhurat nga pagat si gjyqtar 2000-2002	1,391,018
<b>B</b>	<b>Pasuri</b>	<b>150,000</b>
1	Blerë automjet 22.1.2003	150,000
<b>C</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>281,892</b>
1	Shpenzime jetike 2000-2002	281,892
	<b>Aftësia paguese në momentin e blerjes së automjetit datë 22.1.2003 (A-B-C)</b>	<b>959,126</b>

<sup>16</sup> DPSHTRr-ja me nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2019.

<sup>17</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016, drejtuar subjektit nga DPSHTRr-ja.

<sup>18</sup> Kontrata e shitblerjes se automjetit tip “Ford Escort” nr. \*\*\*, datë 22.1.2003.

<sup>19</sup> ILDKPKI-ja me nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2019 ka depozituar dokumentacionin përkatës.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

Komisioni, në rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me mospërputhjen/pasaktësinë e deklaratimit për sa i përket çmimit të blerjes së automjetit tip “Ford Escort”, pasi në deklaratën e vitit 2003 subjekti ka deklaruar vlerën e automjetit 0.15 milionë ose 150,000 lekë, ndërsa kontrata e shitblerjes së automjetit datë 22.1.2003, pasqyron vlerën 100,000 lekë.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “... kur kam deklaruar vlerën e automjetit kam pasur parasysh vlerën e kontratës së blerjes së tij, (kontratën nuk e kam pasur në atë moment pasi nuk disponoj as automjetin e as dokumentet), si dhe shpenzimet për dokumentacionin, ndërrimin e targave, kontrollin fizik e teknik etj. Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI datë 23.1.2015, kam deklaruar të njëjtën shifër 150.000 lekë të vlerës së blerjes së automjetit. Vlerësoj se deklarimi im është i saktë: në tri raste unë kam deklaruar të njëjtën vlerë, atë prej 150 000 lekësh duke pasur parasysh çmimin e blerjes së automjetit dhe shpenzimet e tjera të dokumentacionit, targimit. Duke pasur parasysh kohën e largët, vitin 2003 dhe faktin që këtë automjet dhe dokumentacion e tij unë nuk e posedoja në momentin kur kam bërë deklarimin, vlerësoj se jam përpjekur maksimalisht për të dhënë një deklaram të saktë për këtë automjet”.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRr-ja, dokumentacionin e depozituar nga subjekti, si dhe deklaratimet e tij arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me mospërputhjen e çmimit të blerjes së deklaruar prej tij.

### **3. Shpenzime për mobilimin e apartamentit me adresë: Rr. “\*\*\*” dhe ceremoninë martesore më 2 – 3.9.2007, në vlerat 700,000 lekë, 800,000 lekë dhe 438,000 lekë.**

Burimi i krijimit: kredia konsumatore në vlerën prej 700,000 lekësh, datë 4.7.2007, marrë nga bashkëshortja në “NBG” sipas kontratës për kredi konsumatore; kursimet e subjektit në vlerën 800,000 lekë, të tërhequra datë 2.2.2007; vlera prej 438,000 lekësh, të tërhequra datë 1.8.2007.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2007, subjekti ka deklaruar: “Kredi konsumatore për mobilim shtëpie dhe ceremoni martese marrë te ‘NBG’ në shumën 700,000 lekë, me afat 4-vjeçar, me interes 11.5 %, kësti mujor në vlerën 18,300 lekë filluar në datën 4.7.2007, në emër të bashkëshortes”. Shuma e shlyer 91,500 lekë, detyrimi i mbetur 609,500 lekë.”

Bashkëshortja, znj. A.J., deklaroi: “Shlyer kredia tërësisht në fund të vitit 2008, me kursime nga paga dhe të ardhurat familjare”.

Në lidhje me kredinë konsumatore, “ABI” (e cila ka përthithur bankën “NBG”)<sup>20</sup> ka konfirmuar se klientja A.J. ka marrë kredinë konsumatore në shumën 700,000 lekë, me afat maturimi 4 vjet, datë 12.7.2007.

Nga dokumentacioni bankar i nxjerrjes së llogarisë rezulton që kredia është mbyllur në vitin 2008 dhe shuma prej 518,690 lekësh i përket pagesës së këstit të fundit datë 20.11.2008. Referuar analizës financiare për vitin 2008 (shiko analizën financiare 2003 – 2016, f. \*\*\*), subjekti dhe bashkëshortja kanë rezultuar me balancë pozitive. Kjo do të thotë se kanë pasur të ardhura të

<sup>20</sup> Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2019, nga “ABI” (e cila ka përthithur bankën NBG).

ligjshme, nga burime të ligjshme financiare, të mjaftueshme për të kryer shpenzimet, paguar kredinë, krijuar pasurinë dhe kursimet.

Në lidhje me shumën 800,000 lekë nga kursimet e subjektit, të tërhequra datë 2.2.2007.

“Raiffeisen Bank”<sup>21</sup> me dokumentin “veprim arke” të datës 2.2.2007 konfirmon tërheqjen *cash* të shumës 800,000 lekë nga z. Sandër Simoni nga llogaria e pagës.

Në këtë llogari, e cila është aktive që nga viti 2005, janë përfituar pagat nga puna e tij si gjyqtar, nga të cilat subjekti deri në datën 2.2.2007 ka arritur të kursejë shumën 800,000 lekë.

Në pasqyrën e mëposhtme është analizuar aftësia paguese në momentin e tërheqjes së shumës 800,000 lekë, duke marrë në analizë shpenzimet dhe të ardhurat e disponueshme deri në momentin e tërheqjes datë 2.2.2007.

Data e veprimeve	Përshkrim	Vlera në lekë
1.1.2007	Likuiditete në <i>cash</i> 31.12.2006	250,000
1.1.2007	Likuiditete në bankë 31.12.2006	761,886
2.2.2007	Të ardhura nga pagat (të ardhurat e hyra në bankë)	60,490
2.2.2007	Shpenzime jetike	11,385
2.2.2007	Shpenzime <i>TIMS</i>	0
2.2.2007	Likuiditete në bankë 2.2.2007 (overdraft)	-69,853
2.2.2007	Tërheqja e shumës 800,000 lekë nga “Raiffeisen Bank”	800,000
	Aftësia paguese në momentin e tërheqjes së shumës	330,844

Sipas analizës financiare, subjekti ka pasur në dispozicion në total shumën 1,072,376 lekë, nga të cilat 250,000 lekë nga kursimet *cash*, 761,886 lekë nga likuiditetet në bankë dhe 60,490 lekë nga pagat (të kaluara me bankë deri në datën 2.2.2007). Me shumën në dispozicion, subjekti ka pasur mundësi të përballojë shpenzimet jetike për një muaj në shumën 11,385 lekë dhe të tërheqë nga banka shumën 800,000 lekë me destinacion shpenzim mobilimi, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 330,844 lekë.

Në lidhje me shumën 438,000 lekë, të tërhequr në datën 1.8.2007, “Raiffeisen Bank” me dokumentin “veprim arke” të datës 1.8.2007 konfirmon tërheqjen *cash* të shumës 438,000 lekë nga z. Sandër Simoni nga llogaria e pagës.

Shuma prej 438,000 lekësh rezulton të jetë shuma e kursyer deri në datën 1.8.2007 nga të ardhurat e përfituara nga paga, të cilat kanë kaluar nëpërmjet sistemit bankar në llogarinë rrjedhëse.

Data e veprimeve	Përshkrim	Vlera në lekë
2.2.2007	Likuiditete në bankë 2.2.2007 (overdraft)	-69,853
1.8.2007	Të ardhura nga pagat (të ardhurat e hyra në bankë 2.2.2007-1.8.2007)	1,220,937
1.8.2007	Shpenzime jetike	79,695
1.8.2007	Shpenzime <i>TIMS</i>	0
1.8.2007	Likuiditete në bankë 1.8.2007	479

<sup>21</sup> Shkresa nr. \*\*\*, datë 24.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

1.8.2007	Tërheqja e shumës 438,000 lekë nga “Raiffeisen Bank”	438,000
	Aftësia paguese në momentin e tërheqjes së shumës	632,910

Sipas analizës financiare, subjekti ka pasur në dispozicion të ardhura të mjaftueshme për të paguar shpenzimet jetike për shtatë muaj në shumën 79,695 lekë dhe për të tërhequr nga banka shumën 438,000 lekë, e cila është përdorur për shpenzime martesore, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 632,910 lekë.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2007, subjekti ka deklaruar në f. \*\*\*: “kursimet në vite cash, kursimet nga pagat të deklaruara 800,000 lekë, si dhe ndihmën financiare 5,000 USD nga vëllai i kam përdorur për mobilimin e apartamentit”.

Në lidhje me kursimet cash, referuar deklaratimeve periodike ndër vite, rezulton se më 1.1.2007 subjekti disponon 250,000 lekë kurse në banesë.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në f. \*\*\* të deklaratës periodike të pasurisë së vitit 2007, te të dhënat konfidenciale: “dhuratë nga vëllai im në formën e ndihmës financiare për mobilimin e shtëpisë 5,000 USD.”

Referuar deklaratimeve të subjektit në deklaratën periodike shpenzimet e mobilimit, të kryera në vitin 2007 rezultojnë të jenë në shumën 1,465,150 lekë dhe kanë si burim krijimi: a) 250,000 lekë nga kursimet në cash; b) 800,000 lekë nga kursimet nga pagat; c) dhuratë nga vëllai në formën e ndihmës financiare në shumën 5,000 USD, konvertuar<sup>22</sup> në vlerën 415,150 lekë.

Në pyetësin nr.1 subjekti ka deklaruar se në vitin 2007 ka shpenzuar në total për mobilimin e banesës shumën prej 950,000 lekësh.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

Komisioni, në rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me mospërputhjen/pasaktësinë në deklaratim për sa i përket shpenzimeve të mobilimit, pasi në deklaratën periodike të vitit 2007 subjekti deklaroi: a) 250,000 lekë nga kursimet në cash; b) 800,000 lekë nga kursimet nga pagat; c) dhuratë nga vëllai në formën e ndihmës financiare në shumën 5,000 USD, ndërsa në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi: 700,000 lekë, dhe në pyetësin nr. 1 deklaroi si shpenzim mobilimi për vitin 2007 shumën 950,000 lekë.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “...në deklaratën periodike të vitit 2007 unë kam deklaruar mundësitë financiare që kam pasur për mobilim dhe ceremoninë martesore pa i ndarë më vete. Në deklaratën ‘Vetting’ unë i jam përmbajtur të njëjtit deklaratim që kam bërë në deklaratën periodike të vitit 2007, duke deklaruar se për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit të banesës dhe ceremonisë martesore kanë shërbyer të ardhurat nga paga, kredia konsumatore e marrë nga bashkëshortja, përkatësisht, edhe këtu pa i ndarë më vete. Në përgjigjet e dhëna në pyetësin nr. 1 unë kam bërë edhe inventarizimin e mobilimit të shtëpisë e më ka rezultuar se në vitin 2007 kam shpenzuar në total për mobilimin e banesës/apartamentit shumën prej 950,000 lekësh, ku përfshihen mobilje, etj. Pra, unë i mbahem deklaratimit se shpenzimet e mobilimit të banesës dhe ceremonisë së martesës janë ato të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2007, në deklaratën ‘Vetting’, ndërsa të ndara vetëm shpenzimet për mobilim të shtëpisë janë ato të deklaruara në përgjigjet e pyetësorit nr. 1. Unë dhe bashkëshortja ime kemi pasur të ardhura të mjaftueshme për të bërë këto shpenzime dhe vlerësoj se nuk ka mospërputhje apo pasaktësi në këtë rast”.

<sup>22</sup> Bazuar në kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë 83.03 lekë/dollar.

## Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga subjekti, informacionin e përcjellë nga bankat e nivelit të dytë dhe shpjegimet e subjektit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me shpenzimet e mobilimit të apartamentit dhe shpenzimeve martesore.

**4. Blerje e automjetit tip “Ford J4D KA” me targa \*\*\*, prodhim i vitit 1997 me vlerë 200,000 lekë (kontrata datë 27.4.2010<sup>23</sup>). Pjesa takuese: 50 % me bashkëshorten.** Burimi krijimit: kursime nga pagat.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2010 subjekti ka deklaruar: *“Blerje e një automjeti tip ‘Ford KA’ prodhim i vitit 1997, blerë në bashkëpronësi me bashkëshorten A.J., sipas kontratës së shitblerjes së datës 27.4.2010. Vlera: 200,000 lekë. Pjesa takuese 50 %”*.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2015 subjekti ka deklaruar: *“Shitje e automjetit ‘Ford J4D’ me targa \*\*\*, prodhim i vitit 1997 (në bashkëpronësi me bashkëshorten, në vlerën 200,000 lekë. Kontratë shitje e datës 12.12.2015)”*.

DPSHTRr-ja<sup>24</sup> ka përcjellë dosjen e automjetit tip “Ford J4D KA” me targa \*\*\*, ku rezulton se ky automjet është përfituar nga kontrata e shitblerjes së datës 27.4.2010<sup>25</sup> me shitës F.Xh. dhe blerës Sandër Simoni dhe A.J., blerë me çmimin 200,000 lekë.

Me kontratën e datës 12.12.2015<sup>26</sup> subjekti Sandër Simoni dhe znj. A.J. ia shesin këtë mjet blerëses V.M. me çmimin 200,000 lekë.

### Analizë financiare burimit të krijimit, shumës 200,000 lekë

Subjekti ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri kursimet nga pagat. Për të analizuar mundësinë financiare për blerjen e kësaj pasurie me të ardhurat nga pagat, janë marrë në konsideratë të ardhurat për periudhën janar-prill 2010, shpenzimet e kryera deri në datën e krijimit të pasurisë, si dhe ndryshimet në likuiditete për këtë periudhë.

Data e veprimeve	Përshkrim	Vlera në lekë
1.1.2010	Likuiditete në <i>cash</i> 31.12.2009	0
1.1.2010	Likuiditete në bankë 31.12.2009	200,443
27.4.2010	Të ardhura nga pagat	1,444,486
27.4.2010	Shpenzime jetike	102,465
27.4.2010	Shpenzime <i>TIMS</i>	0
27.4.2010	Likuiditete në bankë	791,602
27.4.2010	Pagesë për blerjen e automjetit	200,000
	Mundësia financiare në momentin e krijimit të pasurisë	550,862

<sup>23</sup> Kontrata e shitblerjes së automjetit tip “Ford” nr. \*\*\*, datë 27.4.2010.

<sup>24</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2019, nga DPSHTRr-ja; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2019.

<sup>25</sup> Kontrata e blerjes së automjetit tip “Ford KA” me nr. \*\*\*, datë 27.4.2010.

<sup>26</sup> Kontrata e shitjes së automjetit tip “Ford KA” me nr. \*\*\*, datë 12.12.2015.

Nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit me të ardhurat e disponuara ka pasur mundësi për të përballuar shpenzimet, për të krijuar pasuri në formën e likuiditeteve në bankë dhe për të blerë automjetin me vlerë 200,000 lekë.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRr-ja, si dhe nga subjekti i rivlerësimit nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarin e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja, kanë pasur të ardhura të mjaftueshme, të krijuara me burime të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie.

### **5. Huadhënie vëllait të subjektit, z. L.S., në datën 10.3.2014, në shumën 1,400,000 lekë (deklaratë noteriale e datës 31.7.2014<sup>27</sup>).**

Burimi i krijimit: të ardhura nga honorare nga mësimdhënia në Universitetin “\*\*\*\*” në vitet 2008 – 2013 kaluar në llogari të “Union Bank”, të tërhequra në shumën 984,000 lekë, datë 10.12.2012 dhe të deklaruara si gjendje *cash* në deklarin e datës 29.3.2013; kursime në shumën 400,000 lekë gjatë vitit 2013; si dhe nga të ardhurat në muajt janar - mars 2014.

Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale datë 31.7.2014<sup>28</sup> “për detyrim në të holla” me deklarues Sandër Simoni dhe L.S., ku deklarohet se: “... në datën 10.3.2014 i kam dhënë hua babait tim, V.S., për llogari të vëllait tim, L.S., një shumë të hollash në vlerën 1,400,000 lekë, për prenotimin e një apartamenti të ndodhur në adresën Rr. ‘\*\*\*’, Tiranë, sa më sipër duke u nisur nga marrëdhëniet gjinore, nuk kemi lidhur kontratë huaje dhe se huaja është dhënë pa afat dhe pa shpërblim’.

Z. L.S. deklarohet se: “Lidhur me detyrimin e mësipërm në shumën 1,400,000 lekë e njeh dhe se do ia kthejë vëllait të tij Sandër Simoni”.

Në lidhje me burimin e krijimit të shumës së dhënë hua prej 1,400,000 lekësh

Shuma prej 984,000 lekë konfirmohet nga “Union Bank”, e tërhequr nga subjekti datë 10.12.2012. Në lidhje me kursimet në shumën 400,000 lekë gjatë vitit 2013 dhe nga të ardhurat në muajt janar – mars 2014 për shumën 16,000 lekë, Komisioni ka kryer analizën si më poshtë:

### **Analiza financiare**

Në lidhje me burimin e krijimit të shumës prej 1,400,000 lekësh, subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer kursimet nga mësimdhënia për periudhën 2008 – 2012. Këto kursime subjekti i ka disponuar në llogaritë bankare në “Union Bank”<sup>29</sup> (kursimi ose depozitë me afat), të deklaruara në deklaratat e pasurisë për vitet 2010 – 2012. Në datën 10.12.2012 subjekti ka tërhequr shumën prej 984,000 lekësh dhe e ka mbajtur gjendje në shtëpi, duke e deklaruar në formën e kursimeve *cash* për vitin 2012.

Referuar analizës financiare për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit rezulton me burime të mjaftueshme, të ligjshme për të mbuluar shpenzimet, krijuar pasurinë dhe kursimet e deklaruara në shumën 984,000 lekë.

<sup>27</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 31.7.2014.

<sup>28</sup> Deklarata noteriale (për detyrim në të holla) nr. \*\*\*, datë 31.7.2014.

<sup>29</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2019 nga “Union Bank”.

Përshkrimi	2012	2013	2014
<b>Të ardhurat</b>	<b>3,145,431</b>	<b>4,198,333</b>	<b>5,270,569</b>
Të ardhura nga paga si gjyqtar	1,371,543	1,493,386	1,806,057
Të ardhura nga paga si pedagog	278,910	523,350	333,000
Të ardhura si ekspert	-	37,457	107,677
Të ardhura nga paga e b/shortes	1,441,072	1,621,529	1,654,419
Të ardhura nga konsulenca e b/shortes	53,906	-	-
Të ardhura nga aktiviteti si notere	-	522,611	518,891
Të ardhura nga shitja e automjetit	-	-	500,000
Të hyra nga kthimi i huasë	-	-	350,525
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>	<b>-796,008</b>	<b>-3,755,244</b>
Detyrime të biznesit si person fizik	-	- 445,483	446,956
Kredi bankare në RBAL 10,000 euro	-	-	1,401,100
Hua dhënë L.J.	-	- 350,525	-
Hua dhënë L.S.	-	-	- 5,603,300
<b>Shpenzime</b>	<b>849,759</b>	<b>879,890</b>	<b>4,130,115</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	558,192	564,096	879,992
Shpenzime udhëtimi	-	31,267	26,621
Shpenzime mobilimi	-	-	500,000
Shpenzime kredie (principal +interes)	284,527	284,527	284,527
Shpenzime sigurim kredie	7,040	-	137,875
Shpenzime konsumi nga kredia 10,000 euro	-	-	900,000
Pagesë kredie RBAL	-	-	1,401,100
<b>Pasuri</b>	<b>870,218</b>	<b>1,007,245</b>	<b>-4,219,687</b>
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	870,218	940,854	- 4,206,409
Aktive AAGJ të biznesit	-	66,391	- 13,278
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>1,425,454</b>	<b>1,515,191</b>	<b>1,604,897</b>

Në deklaratën e pasurisë për vitin 2013, subjekti ka deklaruar një shumë të hollash prej 400,000 lekësh të kursyera gjatë këtij viti. Referuar analizës financiare për vitin 2013, subjekti dhe personi i lidhur me të rezultojnë me burime të mjaftueshme, të ligjshme për të mbuluar shpenzimet, krijuar pasurinë dhe kursimet e deklaruara në shumën 1,384,000 lekë.

Për periudhën janar – mars 2014 , subjekti ka përfutur shumën prej 407,322 lekësh në formën e pagave dhe honorareve të kaluara në llogarinë e tij bankare në “Raiffeisen Bank”. Nga nxjerrja e llogarisë bankare rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare të tërheqë nga kjo llogari shumën prej 16,000 lekësh.

Tabela e kursimeve në *cash*

Përshkrim	Gjendje <i>cash</i>
<b>Gjendje <i>cash</i> më 31.12.2011</b>	<b>0</b>
Shtesë kursimesh për vitin 2012 (nga tërheqja e datës 10.12.2012 në “Union Bank”)	984,000
<b>Gjendje <i>cash</i> më 31.12.2012</b>	<b>984,000</b>
Shtesa për vitin 2013 (deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2013)	400,000
<b>Gjendje <i>cash</i> më 31.12.2013</b>	<b>1,384,000</b>
Kursime nga pagat për periudhën janar - mars 2014	16,000
<b>Gjendje <i>cash</i> më 10.3.2014</b>	<b>1,400,000</b>

## Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues



Komisioni, pasi analizoi burimet e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e shumës 1,400,000 lekë, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për të dhënë hua shumën prej 1,400,000 lekësh vëllait të tij, z. L.S., në vitin 2014.

#### **6. Bashkëshortja A.J.: huadhënie kunatit L.S. në shumën 30,000 euro.**

Burimi i të ardhurave: kursime nga paga, kaluar në llogari bankare në “Raiffeisen Bank” dhe më pas në llogari depozitë kursimi, sipas kontratës së depozitës me afat datë 11.6.2012; kthim huaje nga vëllai; dhe pjesa tjetër kursime.

Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale “për detyrim në të holla” të datës 31.7.2014<sup>30</sup> me deklarues shtetasit A.J. dhe L.S., ku znj. A.J. deklaroi se: “...i ka dhënë hua V.S. për llogari të djalit të tij L.S. datë 10.3.2014 një shumë të hollash në vlerën 30,000 euro për prenotim apartamenti në Rr. ‘\*\*\*’, Tiranë, pa afat dhe pa shpërblim. Nisur nga marrëdhëniet familjare, nuk kemi lidhur kontratë huaje dhe se huaja në vlerën e sipërcituar është dhënë pa afat dhe pa shpërblim”.

Ndërkohë që z. L.S. ka deklaruar se konfirmon marrjen e kësaj huaje në shumën 30,000 euro dhe merr përsipër ta kthejë këtë shumë me kërkesën e znj. A.J.

#### **Në lidhje me burimin e krijimit**

Në lidhje me burimin e krijimit të shumës prej 30,000 euro, subjekti ka deklaruar se si burim ka shërbyer depozita e tërhequr në “Raiffeisen Bank” në vlerën 20,000 euro, kthimi i huas nga vëllai në shumën 2,500 euro dhe kursimet nga pagat.

a) Kursime nga pagat në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank”<sup>31</sup>, kaluar në llogari depozitë kursimi, sipas kontratës së depozitës me afat datë 11.6.2012.

Kursimet e akumuluar në llogarinë rrjedhëse të pagës në “Raiffeisen Bank” deri në datën 11.6.2012 kanë qenë në shumën 20,349.95 euro. Po në këtë datë, bashkëshortja e subjektit, ka çelur depozitë me afat 12 muaj në “Raiffeisen Bank”, në shumën 20,000 euro. Kjo shumë është tërhequr nga “Raiffeisen Bank”, në datën 10.12.2012. Tërheqjen e kësaj depozite, bashkëshortja e subjektit e ka deklaruar në formën e kursimeve *cash* për vitin 2012.

b) Kthim huaje nga vëllai, z. L.J., në shumën 2,500 euro.

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat e pasurisë për vitet 2013 dhe 2014, përkatësisht, huan e dhënë vëllait në shumën 2,500 euro, në datën 13.12.2013 dhe kthimin e saj në mars të vitit 2014. Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se shuma e huas prej 2,500 euro, e kthyer nga vëllai i bashkëshortes në mars të vitit 2014, ka shërbyer si burim për krijimin e shumës prej 30,000 euro. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja rezultojnë me balancë financiare pozitive për vitet 2013 dhe 2014.

c) Pjesa tjetër kursime.

Pjesa e mbetur që nevojitet për të plotësuar shumën prej 30,000 euro ka si burim kursimet e krijuara nga pagat gjatë vitit 2013 dhe kursimet e krijuara për periudhën janar – mars 2014.

Në deklaratën e pasurisë për vitin 2013, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar shtesë në kursimet e saj *cash*, në shumën 2,000 euro.

<sup>30</sup> Deklarata noteriale (për detyrim në të holla) nr. \*\*\*, datë 31.7.2014.

<sup>31</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2019, përgjigjja nga “Raiffeisen Bank”.

Nga llogaria në euro e bashkëshortes<sup>32</sup> për periudhën 1.1.2014 -10.3.2014 rezultojnë të tërhequra shumat: 600 euro, në datën 24.1.2014; 3,573 euro në datën 13.2.2014 dhe 930 euro në datën 25.2.2014, duke arritur shumën totale prej 5,103 euro.

Subjekti ka shpjeguar se pjesa e mbetur prej 400 euro u konvertua nga bashkëshortja nga të ardhurat e veprimtarisë së zyrës noteriale.

Nga analiza financiare e kursimeve *cash*, në datën 10.3.2014, rezulton gjendje shuma 30,003 euro.

Përshkrim	Gjendje <i>cash</i> euro
<b>Gjendje <i>cash</i> më 31.12.2011</b>	<b>0</b>
shtesë kursimesh për vitin 2012 (nga tërheqja e datës 10.12.2012 në "Raiffeisen Bank")	20,000
<b>Gjendje <i>cash</i> më 31.12.2012</b>	<b>20,000</b>
Shtesa për vitin 2013 (deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2013)	2,000
<b>Gjendje <i>cash</i> më 31.12.2013</b>	<b>22,000</b>
Kthim huaje nga L.J. në mars	2,500
Kursime nga pagat për periudhën janar - mars 2014	5,103
Të ardhura nga veprimtaria e zyrës noteriale	400
<b>Gjendje <i>cash</i> më 10.3.2014</b>	<b>30,003</b>

➤ **Në lidhje me qëllimin e dhënies së huas prej 40,000 euro (30,000 euro + 1,400,000 lekë) nga subjekti dhe bashkëshortja, vëllait L.S. për blerje apartamenti.**

Qëllimi i dhënies së huas në shumën totale 40,000 euro (30,000 euro dhënë nga bashkëshortja e subjektit, znj. A.J., dhe 1,400,000 lekë dhënë nga subjekti) në vitin 2014, sipas subjektit të rivlerësimit, ka qenë për të ndihmuar vëllain, z. L.S., që të blinte një shtëpi në Shqipëri, në Tiranë, pasi ishte me banim në SHBA.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit ka rezultuar se shtetasi L.S., i përfaqësuar me prokurë nga znj. A.J., ka lidhur një kontratë shitjeje me rezervë datë 21.12.2015, nr. \*\*\*, me shitës shoqërinë "\*\*\*\*" sh.p.k., për blerjen e apartamentit me sip. totale 125.48 m<sup>2</sup>, me adresë Rr. "\*\*\*\*" Tiranë, për çmimin 223,980 euro, ku kësti i parë prej 175,000 euro do të paguhej menjëherë me lidhjen e kontratës dhe kësti i dytë prej 48,980 euro do të paguhej brenda datës 31.3.2016.

Gjithashtu, midis palëve është lidhur edhe një kontratë shitjeje me rezervë në po të njëjtën ditë për blerjen e një garazhi me sip. 12.5 m<sup>2</sup> për çmimin 18,000 euro në të njëjtën godinë, me afat përfundimtar pagese deri në datën 31.3.2016.

Komisioni, në vlerësim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, e ka konsideruar shtetasin L.S. si person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të, bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, për shkak të marrëdhënies së huas që ekziston ndërmjet tyre.

Komisioni, me qëllim hetimin e çdo dyshimi të ngritur mbi pasuri të fshehura të subjektit, ka bërë hetime në lidhje me apartamentin dhe garazhin, të blera nga vëllai, z. L.S. dhe konkretisht:

- Për pagesat e kësteve të likuidimit të apartamentit shoqërisë sipërmarrëse dhe më pas shitëse.

<sup>32</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2019, nga "Raiffeisen Bank".

Komisioni ka verifikuar në lidhje me këto pagesa të kryera në mënyrë periodike si këste për pagimin e apartamentit, duke kërkuar informacion nga “Raiffeisen Bank” për pagesat e kryera për llogari të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.

“Raiffeisen Bank”,<sup>33</sup> në përgjigje të saj, ka vënë në dispozicion informacionin në lidhje me derdhjet e bëra për këstet e apartamentit ku përveç shtetasit B.T., pagesat e tjera janë bërë nga shtetasit e identifikuar me emrat B.D. dhe E.C.

Subjekti i rivlerësimit është ftuar të japë shpjegime mbi lidhjen e vëllait, z. L.S. me shtetasit e sipërpërmendur.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se nuk ka asnjë lidhje dhe as njohje me këta shtetas duke deklaruar se nuk mund të jetë në dijeni të çdo veprimi që kryen i vëllai i tij. Subjekti i ka kërkuar sqarime të vëllait për këtë fakt, i cili ka konfirmuar se paratë ia ka dorëzuar z. B.T., duke referuar dhe prokurën lëshuar për këtë të fundit për të kryer veprimet me pagesat. Vëllai i ka shpjeguar subjektit se edhe vetë nuk i njeh dy personat e sipërpërmendur që kanë bërë pagesat e kësteve në bankë. Në një komunikim me e-mail që ka pasur vëllai i subjektit, z. L.S. me shtetasin B.T., ky i fundit ka shpjeguar se: *“personat në fjalë B.D. dhe E.C. janë të njohurit e mi dhe i kam ngarkuar unë personalisht për të kryer pagesat, pra, shumat siç mi ke dhënë mua, unë në disa raste i kam kaluar dhe në disa raste kam autorizuar personat në fjalë për të bërë depozitat”*.

- Në lidhje me shtetasin B.T., nga hetimi i kryer nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të kishte njohje, lidhje apo të ndodhej në ndonjë situatë konflikti interesi; gjithashtu, në lidhje me këto pagesa, Komisioni i është drejtuar edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) për të verifikuar nëse janë bërë hetime në lidhje me këto pagesa nga kjo drejtori.

DPPPP-ja,<sup>34</sup> në përgjigje të saj, ka konfirmuar se në sistemin elektronik të tyre nuk rezultojnë raportime aktiviteti të dyshimtë për rastin në fjalë dhe as praktika të filluara prej saj dhe, për rrjedhojë, nuk kanë pasur *indicie* për dyshime këtë rast.

- Për shtetasin M.J., si mik i z. L.S., i cili kishte në përdorim apartamentin e z. L.S. prej 3 vitesh, pa asnjë lloj detyrimi për të paguar, por me kushtin e mobilimit të një pjese të apartamentit, i cili u thirr dhe si dëshmitar nga Komisioni, nga hetimi nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të kishte njohje, lidhje apo të ndodhej në ndonjë situatë konflikti interesi me këtë shtetas;
- Mundësitë financiare të z. L.S. dhe të bashkëshortes në lidhje me: aftësinë paguese për të likuiduar këstet e apartamentit dhe blerjen e tij; dhe dokumentacionin ligjor të përcjellë nga z. L.S. për krijimin e këtyre të ardhurave nga burime të ligjshme, në një vlerësim të përgjithshëm, duket se i ka pasur mundësitë financiare për të paguar këstet e apartamentit në mënyrë periodike deri në likuidimin total të tij. Sipas formularëve të taksave të Departamentit të Thesarit të SHBA-së, konfirmohet se për vitet 2004 – korrik 2016, të ardhurat e shtetasit L.S. dhe bashkëshortes, përfshirë edhe vlerën e *rimbursuar* nga shteti, arrijnë në vlerën 410,690 USD.

Për periudhën 2004 – korrik 2016, janë marrë për bazë deklaratimet e z. L.S. në lidhje me shumat monetare të sjella në Shqipëri, me të cilat është bërë e mundur blerja e apartamentit dhe garazhit

---

<sup>33</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.12.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>34</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2019, nga DPPPP-ja.

si dhe të dhënat e sistemit *TIMS* dhe vërtetohet se kjo shumë monetare arrin në vlerën 203,000 USD.

### **Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit që të japë shpjegime më të qarta dhe të përmbledhura në lidhje me aftësinë paguese të vëllait të tij, shtetasit L.S., për blerjen e apartamentit dhe garazhit, si dhe për mënyrën e sjelljes së shumave nga shteti amerikan për pagesën e kësteve të apartamentit dhe garazhit në Shqipëri.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, si vijon:

*“Për sa i përket huas që unë dhe bashkëshortja i kemi dhënë vëllait tim në vitin 2014, sipas konstatimit të Komisionit, unë si subjekt dhe bashkëshortja ime kemi pasur mundësi financiare për të dhënë këtë hua.*

*Vëllai im L.S. ka shlyer një pjesë të kësaj huaje dhe ka mundësi financiare për të shlyer pjesën tjetër të huas. Burimi i shlyerjes së tyre janë kursimet nga të ardhurat e vëllait dhe bashkëshortes së tij, sipas deklaratimit të taksave vjetore të tyre, nga të cilat del se në vitin 2018 kanë të ardhura të taksueshme në shumën 57,000 USD. Formulari i të ardhurave për vitin 2018, në shumën 57.008 USD, sipas formatit 1040 të Departamentit të Thesarit – Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme (ShAB), dhe kthim tatimi individual, deklaroj që unë dhe bashkëshortja kemi deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2014 këtë hua dhe me përgjegjësinë e përgjegjshmërinë më të madhe kemi deklaruar destinacionin dhe qëllimin e saj për blerjen e një apartamenti.*

*Në interpretim të nenit 3, pika 14<sup>35</sup> dhe të nenit 32, paragrafi 4<sup>36</sup>, i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë,” vlerësoj se duhet bërë dallimi në mes rastit kur subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e huamarrësit apo përfituesit të dhurimit me rastin kur është në cilësinë e huadhënësit apo dhuruesit. Kur subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e huadhënësit, duhet të ketë detyrimin për të justifikuar atë pjesë të pasurisë që ka dhënë hua apo ka dhuruar, pra në këtë rast barrë prove ka vetëm subjekti i rivlerësimit. Vlerësoj se pozita ime si person që i ka dhënë hua vëllait të tij nuk është e njëjtë me pozitën e një subjekti tjetër rivlerësimi që ka marrë hua apo dhuratë, pasi nuk është ky qëllimi i ligjit në kuptim të paragrafit 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, mbi personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në mënyrë të kundërt mund të mos jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit.*

*Në rastin e marrëdhënieve me vëllain, motrën, prindërit nuk jemi para lidhjeve të interesit që rrjedh nga një interes pasuror apo marrëdhënie tjetër biznesi. Në rastin tim për shkak të marrëdhënieve së afërt familjare nuk bëhet fjalë për ndonjë situatë konflikti interesi në kuptim të parashikimeve të legjislacionit të posaçëm.*

*Vendimi nr. \*\*\*, datë 17.7.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke bërë interpretimin e nenit të sipërcituar shprehet se: “...në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar nga neni 32/4 i ligjit nr. 84/2016 ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjithë pasurinë. Interpretimi i kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar*

<sup>35</sup> Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin, ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie biznesi.

<sup>36</sup> Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar me cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre.

*të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit të lidhur që nuk ka qenë subjekt deklarues, me atë të subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket i pamundur.”*

*Nën frymën e këtij interpretimi, vlerësoj se meqë unë jam në pozitën e huadhënësit, në përputhje me parimin e proporcionalitetit kam detyrim të vërtetoj që kam pasur mundësi për të dhënë huan.*

*Unë, pas dhënies së huas në vitin 2014, nuk kam kryer asnjë veprim tjetër që ka të bëjë me këtë marrëdhënie pronësore të vëllait, as me vëllain dhe as me personat me të cilët ai ka bashkëpunuar e ka ngarkuar, nuk kam asnjë kontakt apo interes me këtë pronë dhe as me personat me të cilët ka marrëdhënie vëllai im. Ai i ka kryer vetë të gjitha veprimet ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij.*

*Huaja është shlyer pjesërisht në vitin 2019 dhe vëllai im kishte mundësi që të shlyente huan, pasi kishte të ardhura në atë vit 57,000 USD.*

*Unë u jam përgjigjur në mënyrë të hollësishme çdo pyetjeje dhe kam sjellë shumë prova e akte në formën e duhur ligjore, megjithëse bëhej fjalë për sjellje dhe veprime të vëllait tim, duke paraqitur para Komisionit 15 deklarata tatimore dokumente origjinale, formular të të ardhurave të vëllait dhe bashkëshortes për vitet 2004 – 2018, sipas formatit \*\*\* të Departamentit të Thesarit – Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme (ShAB), të vërtetuara nga Noteri Publik i Floridas, me vulë apostile, lëshuar nga Sekretari i Shtetit të Floridas, SHBA, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, nga ku del që të ardhurat e taksueshme kanë qenë në total në shumën 482,332 (katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e dy) USD,<sup>37</sup>*

*Në vlerësim të këtyre provave, L.S. kishte mundësitë financiare për të paguar këstet e apartamentit në mënyrë periodike deri në likuidimin total të tij, duke konstatuar se sipas formularëve të të ardhurave të Departamentit të Thesarit, SHBA, të ardhurat e shtetasi L.S. dhe bashkëshortes, përfshirë edhe vlerën e rimbursuar nga shteti për periudhën (2004 – korrik 2016 ) arrijnë në vlerën 410, 690 USD.*

*Në lidhje me pagesat e kësteve të apartamentit të vëllait, ato janë bërë në disa këste në kohë të ndryshme, e për këtë L.S., vëllai im ka ngarkuar të porositurin e tij B.T. sipas Prokurës e Posaçme të datës 20.8.2015, nr. \*\*\*, Dhoma e Noterisë Tiranë, dorëzuar nga ana ime në përgjigje të pyetësorit nr. 3, me anë të së cilës L.S. emëron si përfaqësues të posaçëm për këtë qëllim z. B.T., duke i lënë atij një shumë parash në USD, që kishte mbledhur ndër vite si kursime dhe ato të marra hua nga unë, bashkëshortja dhe motra me qëllim që të lidhte kontratën e sipërmarrjes me kompaninë ndërtuese dhe të bënte pagesat e kësteve për llogari të tij. Pagesat janë bërë në bankë, në 7 (shtatë) këste pagese gjatë vitit 2016<sup>38</sup>. Këstet janë paguar nga i porosituri prej vëllait, miku i tij B.T., i cili ka paguar tri këste pagese vetë ai personalisht. Ndërsa, për dy këste, përfaqësuesi*

<sup>37</sup> Formular i të ardhurave sipas formatit \*\*\* të Departamentit të Thesarit – Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme (ShAB), dhe kthim tatimi individual, lëshuar nga Sekretari i Shtetit të Floridas, USA, të vërtetuara nga Noteri Publik i Floridas, me vulë apostile, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara: për vitin 2018, në shumën 57.008 USD; për vitin 2017, në shumën 42.391 USD; për vitin 2016, në shumën 33.187 USD; për vitin 2015, në shumën 25.403 USD; për vitin 2014, në shumën 24.598 USD; për vitin 2013, në shumën 26.018 USD; për vitin 2012, në shumën 24.820 USD; për vitin 2011 në shumën 30.280 USD; për vitin 2010, në shumën 30.201 USD; për vitin 2009, në shumën 31.841 USD, për vitin 2008, në shumën 33.082 USD; për vitin 2007, në shumën 37.749 USD; për vitin 2006, në shumën 30.438 USD; për vitin 2005, në shumën 30.961 USD; për vitin 2004; në shumën 24.158 USD.

<sup>38</sup> konkretisht me nga 40 000 euro (të konvertuara nga sasia në USD ) në datat 7.1.2016, 8.1.2016, 11.1.2016, 20.1.2016 dhe në këstin prej 24 000 euro, të depozituara në bankë në datën 10.2.2016, kësti prej 30 290 euro, i depozituar në bankë në datën 29.7.2016 dhe ai prej 27 690 euro, të depozituara në bankë në datën 28.8.2016.

*i vëllait z. B.T. ka ngarkuar bashkëpunëtorin e tij me të cilin punonte z. E.C.V. dhe për një kësht përfaqësuesi i vëllait z. B.T. ka ngarkuar bashkëpunëtoren e tij me të cilën punonte zj. B.D.Y..<sup>39</sup>*

*Bashkëngjitur po dërgoj deklaratën e vëllait tim, L.S., tetor 2019 para Noterit Publik L.U., me vulë apostile të Sekretarit të Shtetit të Floridas, që unë e kam dërguar në përgjigje të pyetësorit nr. 10 dhe që dokumentin origjinal po ua bashkëngjis këtyre shpjegimeve, si dhe 7 faturat e pagesave të kësteve në bankë, që më ka dërguar vëllai.*

*Burimi i ligjshëm i këtyre pagesave në bankë, në emër të vëllait tim L.S., kanë qenë sasia e parave në USD që vëllai i kishte sjellë në Shqipëri si kursime nga vitet 2004 – 2014 dhe ia ka lënë të porositurit dhe mikut të tij B.T. në vitin 2014 nga kursimet në vite të vëllait e bashkëshortes, ato të sjella B.T. me personat e tij të afërm përgjatë viteve 2014 – 2016, si dhe huaja e marrë tek unë dhe bashkëshortja, gjithashtu dhe huaja e marrë nga motra jonë F.Rr. sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 13 gusht 2014, nga ku del se motra jonë F.Rr. i ka dhënë hua vëllait tonë L.S., shumën prej 20 000 euro (dorëzuar nga ana ime gjatë pyetësorëve, deklaratën origjinale po e dorëzoj bashkëngjitur këtij shpjegimi).*

*Të ardhurat e motrës sime F.Rr. (S.) vërtetohen nga ekstrakt i llogarisë së z. A.Rr. dhe znj. F.Rr., lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Romë (në formën e kërkuar nga ligji<sup>40</sup>), bashkëngjitur këtyre shpjegimeve, nga ku del se kanë pasur të ardhura për periudhën 2002 – 2014 në shumën prej 188,083 euro.*

*Për të gjitha sa shpjegoj më sipër, unë bazohem në deklaratimet e vëllait tim, në një deklaratë noteriale të bërë në tetor të vitit 2019, para noterit në J., Florida, bashkëlidhur Deklarata tetor 2019<sup>41</sup>.*

*Të ardhurat e vëllait L.S. në SHBA janë të vërtetuara nga provat mbi të ardhurat familjare të vëllait dhe bashkëshortes së tij, znj. Zh.Rr., në total në shumën 482.332 (katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e dy) USD, sipas 15 deklaratave origjinale, formularëve të taksave të Departamentit të Thesarit - Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme (SHB) për vitet 2004 – 2018, të vërtetuara nga Noteri Publik i Floridas, me vulë apostile nga Sekretari i Shtetit të Floridas shoqëruar dhe me vërtetimet përkatëse të punësimit.*

*Për të vërtetuar që vëllai im nuk ka pasur nevojë të blejë shtëpi në SHBA, pasi ka jetuar në shtëpinë e bashkëshortes dhe vjehrrit, kam paraqitur në pyetësorin nr. 2, kontratë dhurimi të datës 8.11.2018, lëshuar nga kancelari i gjykatës së provincës Duval, me anë të së cilës prindërit e bashkëshortes së vëllait tim znj. K.R. dhe z. Gj.R. i kanë dhuruar vajzës së tyre, bashkëshortes së vëllait tim Zh.R. dhe vëllait tim L.S., tokën dhe ndërtesën sipër saj, shtëpinë në adresën: \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, shtëpi në të cilën vëllai im ka jetuar dhe jeton familjarisht që nga viti 2004. Kjo për të vërtetuar se vëllai im nuk ka pasur nevojë të blejë shtëpi në Florida. Bashkëngjitur këtyre shpjegimeve po paraqes një vërtetim të zyrës së taksave Xpress E- File, Inc i datës 31 dhjetor 2019 dhe së bashku me deklarinimin e të ardhurave të taksueshme nga ana e vjehrrit dhe vjehrrës vëllait, babait të kunatës sime, z. Gj.R. dhe nënës së kunatës, znj. K.R., të cilët kanë jetuar me vëllanë tim dhe në vitin 2018 i kanë dhuruar shtëpinë vëllait dhe kunatës, nga ku del se ai ka pasur të ardhura të taksueshme në vlerën prej 450,879 USD. Vetëm për periudhën 2004 – 2016 ka pasur*

<sup>39</sup> Sipas deklarinimit të z. B.T. në komunikimin elektronik me vëllanë tim L.S., korrespondencë dërguar mua nga vëllait im datë 5.12.2019, paraqitur nga ana ime në përgjigjet e pyetësorit nr. 10.

<sup>40</sup> me vulë të institucionit nga Bashkia Romë dhe me vulë apostile sipas Konventës së Hagës 1961, të përkthyerat e të noterizuara në gjuhën shqipe.

<sup>41</sup> para noterit publik L.U., me vulë apostile të Sekretarit të Shtetit të Floridas.

të ardhura në shumën 310, 251 USD. Pra, vëllai im së bashku me bashkëshorten dhe vjehrrën kanë pasur të ardhura mbi shumën prej 730,000 USD.

Një vërtetim i datës 30.9.2019 nga Community First Credit Union of Florida, banka ku kanë llogaritë bankare dhe të kursimeve vëllai dhe kunata, dokument origjinal me vulë apostile.

Në lidhje me mënyrën dhe kohën e sjelljes së tyre në Shqipëri, shpjegoj se janë sjellë në Shqipëri nga viti 2004 deri në vitin 2016, herë pas herë në sasi të vogla cash në formë kursimesh nga vëllai im L.S. dhe kunata Zh.R. përgjatë vizitave të tyre të shpeshta në Shqipëri herë çdo vit e herë një herë në dy vjet dhe konkretisht në vitet 2004; 2005; 2007; 2010; 2012; 2014; 2017; 2019.

Pjesa tjetër është dërguar herë pas here cash dhe në sasi të vogla nëpërmjet të afërmeve të bashkëshortes së vëllait, konkretisht, vjehrrit të vëllait z. Gj.R., xhaxhait të bashkëshortes së tij z. M.R., tezes së bashkëshortes së tij znj. A.R., gjatë viteve 2006 – 2016 dhe nëpërmjet kumbarës së vëllait dhe mikut të tij z. J.M., të fejuarës së një kushëriri të vëllait, zj. J.B. si dhe të fejuarës së nipit të tij zj. K.Y. gjatë viteve 2015 - 2016.

Dhe për këtë shpjegim i referohem deklaratës tetor 2019 para noterit publik L.U., me vulë apostile të Sekretarit të Shtetit të Floridas”.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi burimet e krijimit të shumës 30,000 euro nga bashkëshortja e subjektit për dhënien hua të kësaj shume vëllait të subjektit, z. L.S., si dhe duke analizuar dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit arrin në konkluzionin se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. A.J., ka pasur të ardhura të mjaftueshme të krijuara nga burime të ligjshme për shumën 30,000 euro, dhënë hua kunatit të saj L.S.

Komisioni, pasi mori në analizë dokumentacionin e administruar gjatë procesit të rivlerësimit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pyetjen e dëshmitarit, i konsideroi të plota dhe bindëse, duke arritur në konkluzionin se personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, vëllai i tij, shtetasi L.S., vërtetoi se kishte burime të ligjshme financiare për kryerjen e këtij investimi, mënyrën e sjelljes së shumave monetare në Shqipëri, mundësinë financiare me burime të ligjshme të shtetasve A. dhe F.Rr. (motra e L.S.), për dhënien hua të shumës prej 20,000 euro vëllait të saj, z. L.S., pagesën e kësteve shoqërisë ndërtuese, dhe për rrjedhojë, nuk u vërtetua se kemi të bëjmë me fshehje të pasurisë nga subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja A.J., në emër të vëllait të subjektit, z. L.S.

### **7. Bashkëshortja A.J.: huadhënie vëllait, z. L.R.J., në shumën 2,500 euro, datë 13.12.2013.**

Burimi i të ardhurave: kursime nga paga.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2013, bashkëshortja e subjektit, znj. A.J., ka deklaruar: “Dhënë hua vëllait L.J. në shumën 2500 euro, tërhequr nga llogaria e ‘Raiffeisen Bank’ në datën 13.12.2013”.

Në deklaratën periodike të vitit 2014, bashkëshortja e subjektit, znj. A.J., ka deklaruar: “Kthim huaje në mars 2014 nga vëllai 2500 euro (pa kontratë noteriale për shkak të marrëdhënieve familjare)”.

<b>Përshkrimi</b>	<b>2013</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>4,198,333</b>

Të ardhura nga paga si gjyqtar	1,493,386
Të ardhura nga paga si pedagog	523,350
Të ardhura si ekspert	37,457
Të ardhura nga paga e b/shortes	1,621,529
Të ardhura nga aktiviteti si notere (***) <sup>42</sup>	522,611
<b>Detyrime</b>	<b>-796,008</b>
Detyrime të biznesit si person fizik <sup>43</sup>	- 445,483
Hua dhënë L.J. (2,500 euro)	- 350,525
<b>Shpenzime</b>	<b>879,890</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	564,096
Shpenzime udhëtimi	31,267
Shpenzime kredie (principal +interes)	284,527
<b>Pasuri</b>	<b>1,007,245</b>
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	940,854
Aktive AAGJ të biznesit <sup>44</sup>	66,391
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>1,515,191</b>

### Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi burimet e krijimit, arrin në konkluzionin se nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2013 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi për dhënien e huas, pagimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve me burime të ligjshme.

**8. Bashkëshortja A.J.: automjet tip “Mercedes-Benz A 160”, me targa \*\*\*, prodhim i vitit 2002, në vlerën 300,000 lekë (kontratë shitblerjeje datë 12.12.2015<sup>45</sup>).** Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: shitja e automjetit tip “Ford Ka” me targa \*\*\*; kursime nga pagat.

DPSHTRr-ja<sup>46</sup> ka përcjellë dosjen e automjetit tip “Mercedes Benz A 160”, viti 2002 i përfituar nga kontrata e shitblerjes së datës 12.12.2015<sup>47</sup> me shitës shoqërinë “\*\*\*” dhe palë blerëse, znj. A.J., për çmimin 300,000 lekë.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2015 bashkëshortja e subjektit nuk ka deklaruar burim krijimi.

### Analizë financiare e burimit të krijimit

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi në deklaratën “Vetting” për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz” me targa \*\*\*, në shumën 300,000 lekë, në datën 12.12.2015, të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit tip “Ford Ka” me targa \*\*\*, në shumën 200,000 lekë, në datën 12.12.2015, si dhe 100,000 lekë nga kursimet nga pagat.

Referuar analizës financiare të vitit 2015, e cila ka rezultuar me gjendje pozitive, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për të kursyer nga pagat 100,000 lekë dhe për të blerë së bashku me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Ford Ka”, automjetin e ri tip “Mercedes Benz”.

### Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

<sup>42</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2005, nga ILDKPKI-ja.

<sup>43</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2005, nga ILDKPKI-ja.

<sup>44</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2005, nga ILDKPKI-ja.

<sup>45</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 12.12.2015.

<sup>46</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2019, nga DPSHTRr-ja; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2019.

<sup>47</sup> Kontrata e shitblerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz A 160”, nr. \*\*\*, datë 12.12.2015.



Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRr-ja, dokumentacionin dhe shpjegimet e depozituara nga subjekti, arrin në konkluzionin se nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarimin e këtij automjeti dhe se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme financiare për blerjen e kësaj pasurie.

**9. Bashkëshortja A.J.: blerje automjeti tip “Mercedes Benz 203”, vit prodhimi 2000, me vlerë 840,000 lekë (kontrata e datës 23.6.2009<sup>48</sup>).**

Burimi i krijimit: kursime nga paga, të tërhequra datë 8.5.2009, në “Raiffeisen Bank” në shumën 4,800 euro konvertuar në lekë në vlerën 633,600 lekë; kursimet familjare.

DPSHTRr-ja<sup>49</sup> ka përcjellë dosjen e automjetit tip “Mercedes-Benz C 220 CDI E 203” me targa \*\*\*, ku rezulton se ky automjet është blerë nga shitësi D.Ç. në shtetin gjerman datë 8.6.2009, me çmimin 6,000 euro.

Dokumenti doganor i datës 12.6.2009 konfirmon se shtetasi D.Ç. ka paguar taksën doganore në shumën 369,448 lekë. Vlera totale e automjetit është 1,164,448 lekë (çmimi 6,000 euro x 132.5, euro sipas kursit ditor te dokumenti doganor) = 795,000 lekë + 369,448 lekë dogana = 1,164,448 lekë).

Në datën 23.6.2009, shitësi D.Ç. ia shet këtë automjet blerëses A.J., për çmimin 840,000 lekë me kontratën e datës 23.6.2009<sup>50</sup>, pra, 324,448 lekë më lirë se çmimi që ka paguar për blerjen e këtij automjeti.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2009, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Blerje autoveture e tipit ‘Daimlerchrysler tip 203 (C 220 CDI)’, prodhim i vitit 2000, me kontratë të datës 23.6.2009 nga shtetasi D.Ç. Vlera: 840,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burim krijimi: kursime të tërhequra nga paga datë 8.5.2009, në ‘Raiffeisen Bank’ në shumën 4800 euro dhe pjesa e mbetur nga kursimet familjare”*.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2014, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Shitje automjeti tip ‘Mercedes Benz 203’, vit prodhimi me targa \*\*\*, shitur në çmimin 500,000 lekë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 17.11.2014”*.

Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti në lidhje me çmimin e blerjes së këtij automjeti, pasi rezulton i blerë me vlerë 324,448 lekë, më lirë se çmimi total që shitësi e ka blerë këtë automjet, duke ia shitur bashkëshortes, znj. A.J., vetëm pas 12 ditësh, pasi e ka sjellë automjetin në Shqipëri.

Subjekti ka shpjeguar se: *“...ky automjet ishte ofertë e mirë pasi ishte sjellë nga shteti gjerman dhe kishte probleme me llamarinën, por rezultoi se kishte probleme dhe me paketën elektronike që duhej ndërruar herët a vonë. I është kërkuar shitësit ulje çmimi meqenëse do të bëheshin këto rregullime. Gjatë korrikut të vitit 2009 është bërë lyerja e automjetit dhe ndërrimi i paketës në vlerën 180,000 lekë. Duke pasur parasysh që shitësi do të rimbursohet në Gjermani në vlerën 19 % TVSh, afërsisht shuma 1140 euro dhe del që shitësi nuk ka pasur humbje për shitjen e automjetit”*.

Subjekti ka depozituar dokumentacion provues si: a) preventiv punimesh i datës 22.7.2009 nga personi fizik A.P. me vlerë totale 110,000 lekë dhe ‘fletë dalje’ nr. \*\*\*, datë 21.9.2009, me vlerë

<sup>48</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 23.6.2009.

<sup>49</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2019, nga DPSHTRr-ja; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2019.

<sup>50</sup> Kontrata e blerjes së automjetit tip “Benz W 203” nr. \*\*\*, datë 23.6.2009, nga znj. A.J.

110,000 lekë nga A.P.; b) preventiv punimesh nga personi fizik E.G. me vlerë 70,000 lekë dhe dokument “fletë dalje” e datës 8.9.2010 me vlerë 70,000 lekë.

**Analiza financiare e burimit të krijimit të shumës 840,000 lekë (vlerë kjo e blerjes së apartamentit).**

Subjekti ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri kursimet nga pagat, të tërhequra në datën 8.5.2009 në “Raiffeisen Bank” në shumën 4,800 euro konvertuar në 633,600 lekë, si dhe pjesa e mbetur nga kursimet familjare.

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti i rivlerësimit me të ardhurat e disponuara dhe likuiditetet ka pasur mundësi për të blerë mjetin me vlerë 840,000 lekë, duke rezultuar me balancë financiare pozitive.

Data e veprimeve	Përshkrim	Vlera në lekë
1.1.2009	Likuiditete në bankë 31.12.2008	605,269
1.1.2009	Likuiditete në <i>cash</i> 31.12.2008	0
23.6.2009	Të ardhura nga pagat	1,373,645
23.6.2009	Shpenzime jetike	170,775
23.6.2009	Shpenzime kredie	118,553
23.6.2009	Shpenzime <i>TIMS</i>	0
23.6.2009	Likuiditete në bankë	95,845
23.6.2009	Likuiditete në <i>cash</i>	0
23.6.2009	Pagesë për blerje automjeti	840,000
	Mundësia financiare në momentin e krijimit të pasurisë	753,742

**Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit që të japë shpjegime në lidhje me dyshime që kanë të bëjnë me çmimin real të blerjes së automjetit.

Subjekti ka përsëritur shpjegimet e tij të përmendura në pikën 9.3 dhe ka referuar të njëjtat dokumente, të depozituara më parë prej tij.

**Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRr-ja, dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit, arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika për sa i përket dokumentacionit dhe deklarimit të këtij automjeti dhe se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse në lidhje me diferencën e çmimit të konstatuar nga Komisioni, si dhe referuar analizës financiare, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, kanë pasur në dispozicion të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e pasurisë, kursimeve dhe mbulimin e shpenzimeve duke rezultuar me balancë pozitive.

**10. Bashkëshortja A.J.: kredi bankare me kushte favorizuese në “Raiffeisen Bank”, datë 18.4.2014, shuma e kredisë në vlerën 10.000 euro (e përdorur pjesërisht për rimobilim apartamenti me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, P. “\*\*\*\*”, Tiranë). Data e disbursimit 23.4.2014, me interes 9.60 %, shlyer tërësisht në dhjetor të vitit 2014.**

Burimi i shlyerjes: kursimet nga pagat; shitja e automjetit tip “Mercedes Benz 203”, me çmim 500,000 lekë.

Subjekti ka depozituar kontratën e kredisë bankare të datës 18.4.2014 të lidhur mes palëve “Raiffeisen Bank” dhe kredimarrëses A.J. dhe bashkëkredimarrësit Sandër Simoni, për kredinë në shumën 10,000 euro për përdorim personal.

Dokumenti bankar “tërheqje nga llogaria”, lëshuar nga “Raiffeisien Bank” pasqyron veprimin e datës 25.4.2014, ku znj. A.J. ka tërhequr shumën 10,000 euro.

Subjekti ka bashkangjitur një faturë tatimore shitjeje lëshuar nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 61,296 lekë për blerje materiale për mobilim shtëpie.

Në datën 12.12.2014, znj. A.J. ka bërë shlyerje totale përpara kohe të kredisë së marrë, duke paguar principalin e mbetur në shumën 9,067 euro. Burimi i fondeve për mbyllje është nga kursimet nga paga dhe shitje automjeti.

Znj. A.J. ka depozituar në datën 12.12.2014 në “Raiffeisen Bank”, shumën 2,500 euro.

### **Analizë financiare në lidhje me mundësinë e subjektit për shlyerjen e kredisë**

Nga nxjerrja e veprimeve bankare në llogarinë rrjedhëse në euro<sup>51</sup> të shtetases A.J., konfirmohet pagesa e principalit të kredisë në shumën 9,067 euro, në datën 12.12.2014. Kjo shumë rezulton të jetë krijuar nga pagat e kursyera në monedhën euro që shfaqen si gjendje:

- a) në llogari në datën 12.12.2014, shuma 3,948 euro;
- b) nga shuma prej 2,623 euro, e hyrë në llogari nga konvertimi i kursimeve në lekë, në llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, e cila ka si burim krijimi të ardhurat prej 500,000 lekësh nga shitja e automjetit; si dhe
- c) nga depozitimi i shumës prej 2,500 euro.

<b>Përshkrimi</b>	<b>2014</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>5,270,569</b>
Të ardhura nga paga si gjyqtar	1,806,057
Të ardhura nga paga si pedagog	333,000
Të ardhura si ekspert	107,677
Të ardhura nga paga e b/shortes	1,654,419
Të ardhura nga aktiviteti si notere (***)	518,891
Të ardhura nga shitja e automjetit	500,000
Të hyra nga kthimi i huas L.J.	350,525
<b>Detyrime</b>	<b>-3,755,244</b>
Detyrime të biznesit si person fizik	446,956
Kredi bankare në RBAL 10,000 euro	1,401,100
Hua dhënë L.S.	- 5,603,300
<b>Shpenzime</b>	<b>4,130,115</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	879,992
Shpenzime udhëtimi	26,621
Shpenzime mobilimi	500,000
Shpenzime kredie S.S. (principal +interes)	284,527

<sup>51</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

Shpenzime konsumi nga kredia 10,000 euro	900,000
Shpenzime kredie A.J. (principal +interes)	1,538,975
<b>Pasuri</b>	<b>-4,219,687</b>
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	- 4,206,409
Aktive AAGJ të biznesit	- 13,278
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>1,604,897</b>

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur në dispozicion të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet për shlyerjen e kredisë së marrë nga bashkëshortja në shumën 1,538,975 lekë, duke rezultuar me një balancë pozitive prej 1,604,897 lekësh.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga subjekti dhe dokumentacionin bankar, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja për vitin 2014 rezultojnë me balancë pozitive dhe kanë pasur mundësi financiare për shlyerjen e kredisë.

#### **11. Marrje me qira e një pasurie të paluajtshme, ambient me sip. 20 m<sup>2</sup>, k. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, për ambient zyre noteriale për një afat kohor 5-vjeçar, duke filluar më 10.10.2015 dhe përfundim më 30.9.2020 (kontrata e qirasë datë 1.10.2015<sup>52</sup>). Vlera e qirasë është 16,500 lekë/muaj përfshirë dhe tatimin.**

Subjekti ka depozituar kontratën e qirasë së lidhur më 1.10.2015<sup>53</sup>, me qiradhënës L. dhe P.R. dhe qiramarrëse A.J. për ambientin me sip. 20 m<sup>2</sup> me vendndodhje në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë. Kjo kontratë është lidhur për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 1.10.2015 deri më 30.9.2020. Qiraja mujore do të jetë 16,500 lekë/muaj.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin përkatës dhe nuk konstatohen problematika.

#### **12. Bashkëshortja A.J.: të ardhura nga aktiviteti privat “zyrë noterie” në shumën 1,053,542 lekë, për periudhën 2013 –2016.**

QKB-ja<sup>54</sup> ka konfirmuar se shtetasja A.J. është e regjistruar si person fizik “noter”, datë 30.7.2013 me NIPT \*\*\* dhe është me status “aktiv”.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRT-ja Tiranë)<sup>55</sup>, në përgjigje të saj, ka dërguar informacion në lidhje me të ardhurat dhe fitimin *neto* të realizuar nga personi fizik, duke vënë në dispozicion të Komisionit deklaratën e tatimit mbi të ardhurat personale si biznes i vogël për vitin 2013, si dhe deklaratat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014 – 2018.

DRT-ja Tiranë konfirmon se personi fizik nuk ka detyrime tatimore të palikuiduara. Personi fizik ka deklaruar dhe paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 2013 – 2019, si dhe tatimin në burim për qiranë për periudhën 2015, 2016 dhe 2019.

<sup>52</sup> Kontrata e qirasë nr. \*\*\*, datë 1.10.2015.

<sup>53</sup> Kontrata e qirasë nr. \*\*\*, datë 1.10.2015.

<sup>54</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 5.2.2019, nga QKB-ja.

<sup>55</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2019 nga DPT-ja; shkresa nr. \*\*\*prot., datë 28.1.2019, nga DPT-ja; shkresa nr. \*\*\*prot., datë 21.10.2019, nga DPT-ja.

Në deklaratën periodike të pasurisë për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat, përkatësisht, shumat 522,610 lekë, 629,494 lekë, 438,549 dhe 40,493 lekë.

Rezulton se për vitin 2014 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti qarkullimin në shumën 629,494 lekë dhe jo fitimin e realizuar në shumën 518,891 lekë.

### **Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit që të japë shpjegime në lidhje me deklarin e bërë nga bashkëshortja në vitin 2014, për sa i përket të ardhurave nga aktiviteti si notere, pasi nuk është deklaruar në mënyrë të saktë duke iu referuar qarkullimit të realizuar dhe jo fitimit duke e krahasuar me informacionin e dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar: *“...ka një lapsus pasi tek të ardhurat është deklaruar shuma e aktivitetit të xhiros prej 629,494 lekësh dhe jo fitimi në shumën prej 518, 891 lekësh. Kjo është bërë pa asnjë qëllim, por thjesht një gabim njerëzor në pasqyrim. Por, bashkëngjitur deklaratës periodike ne kemi dërguar në ILDKPKI bilancin (pasqyrat finaciare, mikro njësitë për vitin 2014), kështu që ky është thjesht një lapsus, pa ndonjë qëllim të caktuar.”*

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit, arrin në konkluzionin se për vitet 2013, 2015 dhe 2016, deklarimi i bashkëshortes së subjektit përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga DRT-ja Tiranë dhe se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse në lidhje me pasaktësinë e deklaramit në vitin 2014.

### **13. Llogari bankare të subjektit dhe të bashkëshortes**

Llogari rrjedhëse page në lekë si gjyqtar në “Raiffeisen Bank”.

Gjendja e llogarisë datë 23.1.20017, në shumën 43,929.66 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Kjo shumë konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”<sup>56</sup>.

Llogari rrjedhëse në euro në “Raiffeisen Bank” me gjendje 0 (zero) deri me 23.1.2017. Pjesa takuese: 100 %. Kjo shumë konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”.

Llogari rrjedhëse në lekë në BKT, honorare nga mësimdhënia me gjendje 38,351 lekë deri me 23.1.2017. Kjo shumë konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë bankare në BKT<sup>57</sup>.

Llogari rrjedhëse në lekë në “Alpha Bank” honorare nga mësimdhënia me gjendje 28,444.62 lekë deri me 23.1.2017. Kjo shumë konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë bankare në “Alpha Bank”<sup>58</sup>.

Bashkëshortja: të ardhura në lekë nga angazhime të tjera në vlerën 372,010 lekë. Kjo shumë konfirmohet me vërtetimin e datës 18.9.2019, dërguar Komisionit nga qendra “\*\*\*\*”.

Bashkëshortja: të ardhura në euro nga angazhime të tjera në vlerën 3,596 euro.

- konfirmohet shuma prej 1,226 euro përfituar nga qendra “\*\*\*\*” me dokumentacionin financiar të kësaj OJF-je;

<sup>56</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>57</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2019, nga BKT-ja.

<sup>58</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2019, nga “Alpha Bank”.

- konfirmohet përfitimi i shumës prej 1,870 euro nga Kisha Ortodokse \*\*\* sipas mandatit nr. \*\*\*, datë 19.7.2012 për shumën 1,070 euro dhe mandatit nr. \*\*\*, datë 27.10.2012, për shumën 800 euro;
- konfirmohet përfitimi i shumës prej 500 euro në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank” nga \*\*\*.

Bashkëshortja: të ardhura nga angazhime të tjera në vlerën 513 USD.

Kjo shumë konfirmohet me vërtetimin e datës 18.9.2019, dërguar Komisionit nga \*\*\* dhe nga dokumenti bankar i pagesës në BKT, të shumës 260 USD më 15.11.2011 dhe shumës 253 USD më 6.1.2012.

Bashkëshortja: llogari rrjedhëse në euro në “Raiffeisen Bank”. Gjendja e llogarisë në vlerën 10,042 euro deri më 26.1.2017. Kjo shumë konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”<sup>59</sup>.

Bashkëshortja: kartë krediti *Master Card* në “Raiffeisen Bank” me limit 1,400 euro. Konfirmohet disponimi i kartës së kreditit në “Raiffeisen Bank”.

Bashkëshortja: llogari rrjedhëse në lekë në “Raiffeisen Bank”, me gjendje 54 lekë deri më 31.1.2017. Kjo shumë konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”.

Bashkëshortja: llogari rrjedhëse në dollarë në “Raiffeisen Bank” me gjendje 0 (zero) deri më 24.1.2017. Kjo shumë konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”.

Bashkëshortja: llogari rrjedhëse si person fizik në lekë në BKT, me gjendje 715.75 lekë deri më 31.12.2016. Kjo shumë konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë bankare të personit fizik në BKT.

Bashkëshortja: llogari rrjedhëse si person fizik në euro në “ProCredit Bank” me gjendje 0 (zero) deri më 24.1.2017. Kjo shumë konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë bankare në “ProCredit Bank”<sup>60</sup>.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin bankar të depozituar nga bankat e nivelit të dytë, si dhe dokumentacionin e përcjellë nga subjekti, nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këto llogari.

### **14. Konstatime të tjera**

- **Shtëpi dykatëshe, me sip. 300 m<sup>2</sup> me adresë: \*\*\*, \*\*\*, Shkodër (e ndërtuar në vitin 1959). Vlera: 1.500.000 lekë. Pjesa takuese: 1/3.**

Burimi i krijimit: e trashëguar. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën e vitit 2003. Në deklaratën “Vetting” subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri.

ILDKPKI-ja me shkresën<sup>61</sup> e datës 6.6.2019 ka dërguar në Komision dokumentacionin përkatës, si dhe shpjegime të subjektit Sandër Simoni, kur është thirrur për t’u pyetur nga ky institucion në vitin 2015.

<sup>59</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>60</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2019, nga “ProCredit Bank”.

<sup>61</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2019, ka përcjellë dokumentacionin në lidhje me subjektin Sandër Simoni, kur është thirrur pranë këtij institucioni.

Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, datë 23.1.2015, subjekti Sandër Simoni ka deklaruar se: *“Kjo pasuri është përmendur në deklaratën e vitit 2003 si pasuri në emër të babait tim V.S., kjo për shkak se gjatë vitit 2003 unë kam qenë në gjendje familjare civile me babanë dhe nënën time. Kjo banesë është e viteve 1908 dhe një shtesë e vitit 1958 banesë e vjetër trashëgim nga gjyshi. Për këtë banesë nuk ka dokumente të tjera përveç vërtetimit të pronësisë së truallit.”*

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe shpjegimet e subjektit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”.

- **Tokë bujqësore me sip. 6600 m<sup>2</sup>, ullishte me sip. 500 m<sup>2</sup>, me pjesë takuese 1/3 me adresë: \*\*\*. Burimi i krijimit: ligji nr. 7501 “Për tokën”.**
- **Tokë truall me sip. 900 m<sup>2</sup> me pjesë takuese 1/3 me adresë: \*\*\*. Burimi i krijimit: e trashëguar. Këto dy pasuri janë deklaruar në deklaratën e vitit 2003 por nuk janë deklaruar në deklaratën “Vetting”.**

ILDKPKI-ja me shkresën<sup>62</sup> e datës 6.6.2019 ka dërguar në Komision dokumentacionin përkatës, si dhe shpjegime të subjektit Sandër Simoni, kur është thirrur për t’u pyetur nga ky institucion në vitin 2015.

Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në datën 23.1.2015 subjekti Sandër Simoni ka deklaruar se: *“...kjo tokë bujqësore e deklaruar në vitin 2003 kur unë kam qenë në të njëjtën gjendje familjare me babain tim V.S. Deklarimi është bërë mbi bazën e AMTP-së në pronësi të vitit 1991. Deri në vitin 2003 regjistrimi i pronave ka pasur problem dhe në momentin e deklaramit unë nuk kam patur vërtetimet e pronësisë.*

*Në lidhje me pasurinë ‘ullishte’, i mbahem deklaramit të pasurive të paluajtshme në emër të babait tim. Kjo pasuri nuk është regjistruar për shkak të gabimeve në harta megjithatë është në pronësinë efektive të babait tim siç kam deklaruar në vitin 2003...”*

### **Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të japë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e këtyre dy pasurive në deklaratën “Vetting”.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar se: *“Paraprakisht theksoj se unë këto prona i kam deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe në shpjegimet që kam dhënë para ILDKPKI në janar të vitit 2015... Në deklaratën periodike të vitit 2003 unë kam deklaruar këto prona të familjes të regjistruara në emër të babait tim, pasi unë isha në certifikatën familjare dhe pjesë e kësaj familje dhe se këto prona megjithëse ishin prona të trashëguara, janë konsideruar si prona të përfituara nga ligji 7501 “Për tokën“ përfshi dhe shtëpinë dhe truallin nën të... Prandaj dhe deklarimi është bërë në vitin 2003 bazuar nga sa ne kujtonim dhe në gjendjen fizike të pronës dhe përshkrimit të një gjendje perceptuese të këtyre pronave.*

*Unë kam qenë në përbërje të trungut familjar deri në mars të vitit 2004. Në datën 15.3.2014 kam bërë ndarjen më vete me qëllim transferimin e gjendjes civile në Tiranë ku jetoja e punoja...Nga momenti që unë jam larguar për të jetuar në Tiranë, kam përfutuar kredi për banesë këtu dhe kam*

<sup>62</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2019, ka përcjellë dokumentacionin në lidhje me subjektin Sandër Simoni, kur është thirrur pranë këtij institucioni.

*bërë ndryshimin e gjendjes civile, kam vlerësuar se nuk jam me pjesë e familjes bujqësore në kuptim të nenit 222, 223 e vijues të Kodit Civil, meqenëse unë nuk kam dhënë asnjë kontribut për pasurinë tokë në bashkëpronësi të familjes bujqësore, dhe nuk kisha asnjë përfitim pasuror apo interes për pronat e regjistruara në emër të babait tim sipas ligjit 7501, datë 19.7.1991, “Për token”. Kjo pasi unë në vitin 1991 kam qenë në moshën 17 vjeç, dhe në vitin 1992 jam larguar nga familja me studime duke jetuar në Tiranë fillimisht e pastaj në qytetin e Shkodrës...*

*Unë nuk kam asnjë pretendim, nuk disponoj, nuk gëzoj apo begatoj, dhe nuk kam asnjë të ardhur nga pronat e regjistruara në emër të babait tim, nuk kam dhënë asnjë kontribut mbi pasurinë e familjes bujqësore pasi efektivisht nuk kam jetuar me prindërit por më vete, edhe se kam qenë pjesëtar i kësaj familje juridikisht sipas regjistrimit të gjendjes civile, deri në fillim të vitit 2004...*

*Mund të jetë një vlerësim i gabuar ligjor nga ana ime ky mosdeklarim në Deklaratën Vetting, por nuk përbën përpjekje për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë që unë kam në pronësi ose në përdorim.. shpjegimet e subjektit vijoje si më poshtë.<sup>63</sup>*

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqësor**

Komisioni i ka rezultuar se këto pasuri nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”. Këto pasuri janë përfituar nga babai i subjektit, z. V.S., në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për token” (në vijim, “ligji nr. 7501”), në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore, anëtar i së cilës rezulton të ketë qenë edhe subjekti i rivlerësimit z. Sandër Simoni.

Bazuar në nenin 222 të Kodit Civil, anëtarët e familjes bujqësore tërheqin të drejta reale pronësore mbi pasuritë e mësipërme dhe sipas nenit 4, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, kanë pasur detyrimin ligjor t’i deklaruar këto pasuri dhe të drejtat reale mbi to të përcaktuara nga Kodi Civil. Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore paraqitet si bashkëpronësi në tërësi dhe, për sa kohë nuk është bërë pjesëtimi sipas nenit 207 të Kodit Civil, ndaj saj zbatohen

---

<sup>63</sup> Mund të jetë një vlerësim i gabuar ligjor nga ana ime ky mosdeklarim në deklaratën “Vetting”, por nuk përbën përpjekje për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë që unë kam në pronësi ose në përdorim, ashtu siç parashikon pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Kjo pikë e Kushtetutës parashikon që: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit të subjektit dhe subjekti ka detyrimin që të provojë të kundërtën”.

Detyrimi i subjektit për të deklaruar në mënyrë të plotë dhe të saktë pasuritë që ka në pronësi ose përdorim buron edhe nga pika 1 e nenit D, sipas të cilit: “Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ato që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”.

Mosdeklarimi i saktë dhe i plotë i pasurisë si shkak kushtetues që parashikohet në pikën 1 të Aneksit, nuk mund të interpretohet nëse nuk analizohet i lidhur edhe me parashikimin e pikës 5 në nenin D. Ana subjektive është element thelbësor për vërtetimin e këtij shkak kushtetues. Përpjekja për të fshehur ose për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë, ka si qëllim ose synim për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë, duke kryer edhe një veprim të dënueshëm penalisht. Qëllimi i subjektit është përcaktues për të vërtetuar fshehjen ose paraqitjen e pasaktë të pasurisë, prandaj edhe Kushtetuta jo pa qëllim ka përdorur fjalët “përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij”.

Në rastin konkret nuk ndodhemi para deklarimit të pasaktë ose të paplotë të pasurisë nga ana ime, pasi për pasurinë “Arë” 6,600 m<sup>2</sup> dhe të pasurinë “Ullishtë”, 500 m<sup>2</sup>, në kuptimin e shkakut kushtetues me pasojë për subjektin, sipas pikës 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sepse:

“Së pari: Unë i kam deklaruar këto dy pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 dhe

Së dyti: Unë i kam deklaruar këto pasuri, në mënyrë të detajuar në shpjegimet që kam dhënë para ILDKPI-së në vitin 2015.

Së treti: Pasuria “Ullishtë” nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme e, për rrjedhojë, juridikisht nuk është në pronësinë e babait tim. Ajo figuronte vetëm në AMTP në vitin 1991, por që më vonë kur është bërë regjistrimi nuk është regjistruar.

Nëse unë do të kisha si qëllim t’i fshehja ose të mos i deklarova këto pasuri, siç kërkojnë pikat 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, unë nuk do t’i kisha deklaruar ato pranë ILDKPKI-së në vitet 2003 dhe 2015, si organ kompetent për verifikimin e pasurisë së gjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë dhe nga sa më sipër, rezulton e qartë që, nuk jemi para deklarimit të pasaktë ose të paplotë të këtyre pasurive”.



rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të Kodit Civil për kryerjen e veprimeve juridike në tërësi apo dhe disponimit mbi to në veçanti.

Sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, ligjvënësi e njohu bashkëpronësinë mbi tokën bujqësore për të gjithë ata anëtarë të familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma bujqësore, por që ishin në përbërje të familjes bujqësore. Personat që kishin lindur para datës 1.8.1991, kishin të drejtë të përfitonin nga dispozitat e ligjit, për t’u bërë bashkëpronarë të tokës bujqësore, dhe që do të përfitonin pas shpërbërjes së kooperativave dhe fermave bujqësore. Numri i anëtarëve të gjallë të familjeve bujqësore dhe rrjedhimisht numri i personave që do të ishin bashkëpronarë mbi tokën bujqësore, ishte një numër i përcaktuar me miratimin e ligjit “Për tokën” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”. Në analizë literale të këtyre normave, konstatohet se natyra e bashkëpronësisë së familjes bujqësore në këtë rast, referuar edhe nenit 222 të Kodit Civil të vitit 1994, nuk mund të ndryshojë nën logjikën e pakësimit apo shtimit në mënyrën që pretendon subjekti i rivlerësimit. Bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, për sa kohë nuk është pjesëtuar sipas rregullave të nenit 207 të Kodit Civil, secili prej tyre tërheq të drejta dhe detyrime ndaj asaj pasurie.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuritë e tij në bashkëpronësi. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të “pasurisë” së tij për “burimin” në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra, shkaku apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj.

Për sa më sipër Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i këtyre pasurive në deklaratën “Vetting” sjell si pasojë që subjekti i rivlerësimit të ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë për kriterin e pasurisë, por në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave (subjekti i ka deklaruar këto pasuri në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti është ndarë nga trangu familjar i familjes bujqësore, këto pasuri nuk janë rrjedhojë e një transaksioni financiar të kryer nga subjekti, për këto pasuri nuk është kryer procesi i regjistrimit fillestar dhe nuk është lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie), Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi nuk është në atë peshë që do të çonte deri në shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

➤ **Bashkëshortja A.J.: apartament banimi 1+1, me sip. 70 m<sup>2</sup>, fituar nga privatizimi në vitin 1992, me adresë: Rr. “\*\*\*” në bashkëpronësi me prindërit dhe të vëllanë.** Pjesa takuese: 25 %. Në deklaratën “Vetting” subjekti nuk e ka deklaruar më këtë pasuri.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2007, bashkëshortja e subjektit, znj. A.J., ka deklaruar “*Apartament banimi 1+1, me sip. 70 m<sup>2</sup>, fituar nga privatizimi në vitin 1992, adresa Rr. ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Pjesa takuese: 25 %*”.

ILDKPKI-ja me shkresën<sup>64</sup> e datës 6.6.2019 ka dërguar në Komision dokumentacionin përkatës, si dhe shpjegime të dhëna nga subjekti Sandër Simoni, pranë këtij institucioni në vitin 2015. Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në datën 23.1.2015, subjekti Sandër Simoni ka deklaruar se: “*Në lidhje me këtë apartament, ky tashmë ka kaluar në emrin e vëllait të bashkëshortes L.J.*”. Subjekti

---

<sup>64</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2019, ka përcjellë dokumentacionin në lidhje me subjektin Sandër Simoni kur ai është thirrur pranë këtij institucioni.

ka depozituar edhe certifikatën për vërtetim pronësisë, datë 10.4.2014, për apartamentin në emër të L.J.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë kontratën e dhurimit të këtij apartamenti shtetasit L.J.

Subjekti ka depozituar kontratën e dhurimit, datë 5.3.2014<sup>65</sup>, me dhurues Zh.J. dhe pranues i dhurimit L.J. i apartamentit me sip. 60 m<sup>2</sup>, adresë: Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja dhe nga subjekti, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në vitin 2015 ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me këtë apartament të deklaruar në vitin 2007 dhe se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, pavarësisht deklarimit të apartamentit në deklaratën e vitit 2007, nuk kanë asnjë lidhje pronësore apo të drejtash reale mbi këtë apartament për arsye se ka kaluar në pronësi të vëllait të saj me anë të kontratës së dhurimit, ku si dhurues është shtetasja Zh.J. (halla e bashkëshortes së subjektit), për rrjedhojë nuk konstatohen problematika.

#### **➤ Në lidhje me llogarinë dyemërore të shtetasve Sandër Simoni dhe A.Rr. në monedhën lekë të mbyllur në datën 17.12.2004.**

BKT-ja<sup>66</sup> ka konfirmuar llogarinë rrjedhëse dyemërore në emër të shtetasve Sandër Simoni dhe A.Rr. në monedhën lekë e hapur në datën 1.10.2002, llogari kjo e mbyllur më 17.12.2004, me gjendje zero.

Në këtë llogari, rezultojnë tre depozitime *cash* në shumën 800,000 lekë, datë 1.10.2002; në shumën 400,000 lekë, datë 21.10.2002; dhe në shumën 800,000 lekë, datë 26.8.2003, por banka nuk identifikon personin i cili i ka depozituar këto shuma. Këto shuma janë mbajtur në formën e depozitave.

Në datën 17.3.2004 llogaria është mbyllur nëpërmjet dy tërheqjeve, përkatësisht në shumat 868,992 lekë dhe 432,587 lekë (banka nuk e identifikon personin që i ka tërhequr), si dhe shumës së transferuar në vlerën prej 828,000 lekësh në llogarinë e shtetasit A.Rr.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me mosdeklarimin e kësaj llogarie dyemërore në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe deklaratën periodike të vitit 2004, kontributin e tij në këtë llogari dyemërore, burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe destinacionin e shumave të tërhequra në mbyllje të llogarisë.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar se: *“Llogaria dyemërore është hapur me kërkesë të shtetasit A.Rr. (burri i motrës së subjektit) në datën 1.10.2002 me qëllim depozitimin e parave të kursyera në emigracion nga ai dhe bashkëshortja e tij dhe paratë e marra nga shitja e pasurisë apartament. Hapja e një llogarie dyemërore është sugjeruar për lehtësi veprimi dhe për shkak se BKT-ja nuk bënte dallimin në mes të personit të autorizuar për kryerje veprimi në llogari dhe personit me llogari të përbashkët”.*

Subjekti ka vijuar: *“...në fillim të vitit 2004, para se të bëja deklarimin periodik për vitin 2003, unë i kam kërkuar kumatit që të hiqte emrin tim nga ajo llogari, pasi unë isha subjekt i deklarimit të pasurisë e për më tepër që në atë kohë u transferova me punë në Tiranë.”*

<sup>65</sup> Kontrata e dhurimit nr. \*\*\*, datë 5.3.2014.

<sup>66</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2019, nga BKT-ja në lidhje me llogarinë dyemërore S.Simoni dhe A.Rr.

Veprimet bankare për tërheqjen dhe transferimin e shumave për llogari të shtetasit A.Rr. janë kryer në datën 17.3.2004.

Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 subjekti nuk e ka deklaruar këtë fakt me arsyetimin se llogaria nuk ishte e tij, por e kunatit, si dhe për shkak të paqartësisë së plotësimit të deklarimeve periodike pasi në kohën e deklarimit kjo llogari ishte e mbyllur.

Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti se sa ka qenë kontributi i tij në këtë llogari dhe cili ka qenë burimi i ligjshëm i kësaj shume.

Subjekti në përgjigje të tij ka shpjeguar se: *“...Unë nuk kam asnjë kontribut në këtë llogari. Kjo llogari është e përbërë nga kursimet familjare të kunatit e motrës sime si dhe nga paratë e përfituara nga shitja e apartamentit të tyre në lagjen “\*\*\*”, Shkodër. Motra dhe kunati jetonin e punonin në Romë, Itali e gjatë këtyre viteve kishin sjellë kursimet e tyre në Shqipëri.*

*Këtë fakt nuk e kam deklaruar në deklaratën fillestare periodike të vitit 2003, pasi vlerësova se nuk kisha detyrim për të deklaruar meqenëse ishte llogari depozite e kunatit dhe jo e imja. Përfshirja e emrit tim në atë llogari ka qenë vetëm me qëllimin që të veproja për llogari të kunatit apo motrës sime dhe të bëja tërheqje në rast se i nevojiteshin kunatit për të bërë ndonjë pagesë në Shqipëri.”*

Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume subjekti ka dhënë shpjegimet, si vijon: *“...në vitin 2002, kunati shiti apartamentin e tij në lagjen “\*\*\*”, Shkodër duke marrë dhe pagesën për këtë shitje në vlerën 1 000 000 lekë. Meqenëse motra ime si bashkëpronare dhe nipi nuk ishin në Shqipëri në atë periudhë, nuk u arrit të nënshkruhej kontrata e shitjes me blerësin. Më vonë blerësi ishte në Greqi dhe si kontratë është formalizuar në verën e vitit 2007 kur të gjithë palët ishin në Shqipëri”.*

Subjekti ka depozituar dhe kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme të ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Shkodër, si dhe certifikatën për vërtetim pronësie të tij.

Subjekti, lidhur me këtë fakt ka dhënë sqarime edhe në ILDKPKI<sup>67</sup>. Për këtë arsye në deklarinimin e vitit 2004 subjekti nuk ka deklaruar mbylljen e kësaj llogarie.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti shpjegime në lidhje me llogarinë dyemërore në shumën 2,000,000 lekë, se sa nga kjo shumë janë lekët e përfituara nga shitja e shtëpisë në Shkodër nga kunati A.Rr. dhe sa është pjesa nga kursimet e kunatit dhe motrës nga emigracioni.

Subjekti në shpjegimet e tij ka deklaruar se: *“Shuma prej 2,000,000 lekësh është e përbërë nga shuma 1,000,000 lekë të marra nga kunati A.Rr. në vitin 2002 nga shitja e apartamentit të tij. Pjesa tjetër prej 1,000,000 lekësh është nga kursimet në emigracion nga puna e kunatit A.Rr. dhe motrës sime F.Rr. ( S.)”.*

Komisioni, i ka kërkuar subjektit të vërtetojë marrjen nga kunati të shumës 1,000,000 lekë të përfituar nga shitja e shtëpisë në Shkodër.

Subjekti në përgjigje të tij ka dërguar me rrugë elektronike (e-mail) deklaratën noteriale të datës 5.10.2019<sup>68</sup> ku shtetasi K.N. deklaroi se: *“...në vitin 2002 jam vënë në dijeni nga M.P. kunata ime se në pallatin e saj ishte në shitje një apartament në pronësi të A. dhe F.Rr., ....Po atë vit (2002)*

<sup>67</sup> Procesverbal i mbajtur datë 20.12.2004, në ILDKPKI, në lidhje me subjektin Sandër Simoni, kur është thirrur pranë këtij institucioni.

<sup>68</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 5.11.2019.

*unë kam paguar shumën cash 1,000,000 lekë të cilën ia kam dhënë pronarit të apartamentit A.Rr. Kanë qenë marrëdhënie në mirëbesim dhe në atë kohë nuk kemi bërë kontratë me shkrim pasi nuk ishte në Shqipëri bashkëshortja e A. Më pas vitet e tjera nuk kemi qenë të gjithë bashkë në Shqipëri dhe vetëm në verën e vitit 2007 jemi bërë bashkë dhe shkuam tek noteri ku bëmë dhe kontratën e shitjes”.*

Subjekti ka depozituar dhe deklaratën noteriale të shtetas M.P., kunata e blerësit K.N., deklaratën e datës 5.11.2019<sup>69</sup>, ku deklaroi të njëjtin fakt të deklaruar nga K.N. që ka qenë ndërmjetësja për shitjen e këtij apartamenti dhe konfirmon faktin që ky apartament u shit nga shtetasit A. dhe F.Rr., me vlerën 1,000,000 lekë në vitin 2002 dhe se kunati i saj K.N. së bashku me familjen e tij në Korfuz, Greqi.

Gjithashtu, subjekti ka depozituar edhe një deklaratë të z. A.Rr. i cili ka shpjeguar se si është hapur llogaria dyemërore, qëllimin e saj, pagesat, si dhe shumat e derdhura, ashtu siç ka shpjeguar subjekti në pyetësorët e mëparshëm.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti që të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 1,000,000 lekë për krijimin e shumës 2,000,000 lekë të llogarisë dyemërore.

Subjekti ka depozituar ekstraktin e llogarisë së sigurimeve shoqërore Romë (INSP) të shtetasve A. dhe F.Rr. nga ku rezulton se gjatë viteve 2002-2003 ata kanë pasur të ardhura nga puna në shumën 24,387 euro.

Komisioni ka kërkuar shpjegime në lidhje me faktin që përse nuk u bë transferimi i gjithë shumës 2,000,000 lekë në emër të vëllait të kunatit A.Rr., si dhe të provojë dorëzimin e shumave prej 868,992 lekësh dhe 432,587 lekësh vëllait të A.Rr. dhe dorëzimin e tyre përfundimtar te z. A.Rr.

Subjekti në shpjegimet e tij ka deklaruar se: “... arsyeja pse nuk është bërë transferimi i gjithë shumës ishte sepse kunati im A.Rr., kishte qëllim të tij blerjen e një apartamenti tjetër më të madh se ai që kishte shitur.... Unë nuk mund ta ndihmoja më për këtë, pasi isha larguar me punë e banim në Tiranë dhe doja të hiqja emrin tim nga ajo llogari. Për këtë arsye ai kishte nevojë të tërhiqte një pjesë të kursimeve të tij me qëllim që dikush tjetër, në këtë rast i vëllai i tij L.Rr., ti kishte cash për prenotimin e një apartamenti tjetër duke i përdorur ato në formë kapari. Kunati nuk donte të transferonte të gjithë shumën në emrin e tij, pasi në këtë rast duke mos qenë në Shqipëri, askush tjetër nuk do mund të tërhiqte paratë e tij në rast nevojë apo ndonjë okazioni. Ai donte të tërhiqte vetëm sasinë e kursimeve që ai kishte në depozitë bankare me afat 3 dhe 6 mujore, të depozituara në bankë në vitin 2002, shumën 1,200,000 lekë së bashku me interesa. Kjo shumë sipas tij ishte e mjaftueshme për tu përdorur në rast kapari të blerje tjetër të mundshme apartamenti. Unë në këtë rast kam zbatuar vetëm porosinë e tij duke tërhequr atë shumë që më ka thënë, duke ia dorëzuar të vëllait e duke transferuar shumën tjetër të mbetur vetëm në llogarinë e tij. Kjo është arsyeja se pse unë nuk ia kam transferuar të gjithë shumën e kursimeve vetëm në llogarinë e tij. Këtë arsye ka shpjeguar dhe kunati në deklaratën e tij të sipërcituar të paraqitur për aplikim.”

Ky deklarim është shpjeguar në deklaratën e shtetasit A.Rr., si dhe në deklaratën noteriale të datës 4.11.2019<sup>70</sup>, ku jep të njëjtat deklarime me ato të subjektit të rivlerësimit.

<sup>69</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 5.11.2019, me deklaruese M.P.

<sup>70</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 4.11.2019, me deklarues L.Rr.

Për sa i përket faktit të të provuarit të dorëzimit të shumave 868,992 lekë dhe 432,587 lekë nga subjekti Sandër Simoni te vëllai i kunatit z. L.Rr., ky fakt deklarohet nga z. L.Rr. në deklaratën noteriale të sipërcituar, si dhe nga z. A.Rr. në deklaratën e tij.

### **Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit që të japë shpjegime më të argumentuara në lidhje me mosdeklarimin e kësaj llogarie dyemërore në emër të subjektit dhe të kunati i tij, z. A.Rr.

Subjekti ka shpjeguar se: ”...nuk e kam deklaruar në deklaratën fillestare periodike të vitit 2003, pasi vlerësova se nuk kisha detyrim për të deklaruar meqenëse ishte llogari depozite e kunatit dhe jo e imja. Përfshirja e emrit tim në atë llogari ka qenë vetëm me qëllimin që të veproja për llogari të kunatit apo motrës sime dhe të bëja tërheqje në rast se i nevojiteshin kunatit për të bërë ndonjë pagesë në Shqipëri....”

Subjekti i rivlerësimit ka vijuar me të njëjtat shpjegime të përmendura më lart. Gjithashtu, subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me këtë llogari edhe në vitin 2004 kur është thirrur në ILDKPKI duke shpjeguar situatën e lartpërmendur. Në mbështetje të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit, ka depozituar edhe dokumentacionin provues<sup>71</sup>.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin bankar, shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse në lidhje me krijimin e kësaj llogarie bankare dhe mbylljen e saj, si dhe mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe 2004, duke mos e konsideruar si të qëllimshme dhe për më tepër me qëllim fshehjen e saj nga subjekti i rivlerësimit.

#### **➤ Në lidhje me adresën Blv. “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, të deklaruar nga subjekti në deklaratën nga viti 2003 deri 2006**

Komisioni ka konstatuar se në deklaratën e pasurisë për vitet 2003 - 2006 subjekti ka deklaruar si adresë banimi: Blv. “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Subjekti është pyetur nëse adresa e mësipërme ka qenë apartament në pronësi të subjektit apo apartament me qira dhe nëse po sa ka qenë çmimi mujor i qirasë.

Subjekti ka shpjeguar se: “Ky apartament ka qenë i shtetases K.B. dhe e ka mbajtur në përdorim sipas një kontrate huapërdorje deri në gusht të vitit 2007 kur subjekti ka hyrë të banojë në apartamentin e tij.” Subjekti në mbështetje të këtij shpjegimi ka depozituar kontratën e

---

<sup>71</sup> Deklaratë noteriale e z. A.Rr. me nr. \*\*\*, datë 8.11.2019, lëshuar para Konsullit të Ambasadës Shqiptare në Romë, konform ligjit nr. 8372, datë 9.7.1998, ku ai deklaroi se shumën 1,000,000 lekë si vlef tës e shitjes së apartamentit të tij ia ka marrë blerësit K.N. në vitin 2002; deklaratë noteriale e datës 5.10.2019, z. K.N. N. (deklarata është dhënë në Sarandë, për shkak se deklaruesi punon e jeton në Korfuz aktualisht). Në këtë deklaratë noteriale z. K.N. deklaroi dhënien e shumës prej 1,000,000 lekësh si çmim për blerjen e apartamentit A.Rr. në vitin 2002, shumë e dhënë paraprakisht para nënshkrimit të kontratës; kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme (apartament), nr. \*\*\*, datë 28.8.2007. Me anë të kësaj kontrate është bërë kalimi i pronësisë nga A. dhe F.Rr. te blerësi K.N.; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, e datës 5.10.2019 e shtetases M.P. fqinja e motrës dhe e kunatit tim, e cila ka bërë ndërmjetësimin për shitjen e apartamentit ku blerës ka qenë kunati i saj K.N., nga ku del se deklaruesja ka qenë prezent kur është bërë dorëzimi i parave nga shitësi K.N. tek blerësi A.Rr. në vitin 2002.

huapërdorjes së datës 18.4.2005<sup>72</sup>, ku ndër të tjera, znj. K.B., e përfaqësuar nga znj. T.Ç. ka deklaruar se ia jep apartamentin me sip. 61.6 m<sup>2</sup> z. Sandër Simonit pa kundërshpërblim.

Referuar kësaj kontratë huapërdorje, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime në lidhje me shtetasit K.B. dhe T.Ç. se në çfarë rrethanash është njohur dhe nëse vazhdon të ketë lidhje me to.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Dy shtetasit e sipërpërmendura janë vajzat e të ndjerit F.J. dhe mbesat e T.J. me origjinë nga Shkodra ish-miq të vjetër dhe kumbarë të gjyshit tim nga ana e nënës, po nga Shkodra. Në të njëjtën kohë K.B. është nusja e dajës së mikut dhe kolegut tim P.Ç.,... Në Janar të vitit 2004 kur kam filluar punë si gjyqtar i kam kërkuar mikut të tij P.Ç. që të më gjente një shtëpi me qira aty afër gjykatës. P. më ka sugjeruar apartamentin e znj. K.B. (nusja e dajës së tij) e cila jetonte në Itali, por i kishte lënë prokurë motrës së saj T.Ç.,... Nisur nga lidhjet e dyfishta miqësore dhe shoqërore, kryesisht origjinën nga Shkodra, lidhjen e vjetër miqësore mes gjyshit të subjektit dhe babait të tyre, faktin që isha dhe shok i P.Ç., i sapo ardhur në Tiranë dhe duke parë nevojën për banesë, meqenëse apartamenti ishte për shitje por nuk ishte shitur akoma, meqenëse do rrinte aty për një kohë të shkurtër, K.B. e informuar nga e motra dhe P. për këtë nevojë timen, vendosi që apartamentin ta linte në përdorim pa kundërshpërblim deri sa të gjendej një blerës për të. ... nuk ka pasur kontakte në atë kohë dhe as sot me znj. K.B., ...”.*

Komisioni hetoi dhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasit K.B., T.Ç. dhe F.J. dhe për këtë arsye ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatën e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda<sup>73</sup>, nëse subjekti ka gjykuar çështje me palë dy shtetasit e sipërpërmendura.

Nga përgjigjet e administruara nga Komisioni nuk u konstatua ndonjë situatë konflikti interesi me shtetasit e lartpërmendur.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe përgjigjet nga dy gjykatat, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me adresën ku ka banuar për periudhën 2003 – 2006, si dhe nuk është konstatuar ndonjë situatë konflikti interesi e subjektit të rivlerësimit me shtetasit K.B., T.Ç. dhe F.J.

### **Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016**

Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni përgatiti analizën financiare mbështetur te të dhënat në deklaratimet periodike vjetore në ILDKPKI, në deklaratën “Vetting”, në informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse, si dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, z. Sandër Simoni, i cili ka qenë subjekt deklarimi pa ndërprerje që prej vitit 2003.

### **Metodologjia e kryerjes së analizës financiare**

Për efekt të pasqyimit të metodologjisë së ndjekur, Komisioni në këtë analizë financiare është bazuar në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, në deklaratën “Vetting”, në pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe në korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe

---

<sup>72</sup> Kontrata e huapërdorjes nr. \*\*\*, datë 18.4.2005 me pronar K.B. e përfaqësuar me prokurë nga T.Ç. dhe përdoruesi Sandër Simoni.

<sup>73</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2019; Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2019; Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda nr. \*\*\* prot., datë nëntori 2019.

jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete), si dhe shpenzimet e kryera.

Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar 2003 – 2016 bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat dhe honorarët në vlerë neto, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit<sup>74</sup> dhe bashkëshorten<sup>75</sup>, që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

Për të ardhurat nga aktiviteti<sup>76</sup> janë marrë në analizë vlerat sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë drejtuar Komisionit për të ardhurat dhe fitimin neto të realizuar, në të cilën konfirmohet se personi fizik nuk ka detyrime tatimore të pa likuiduara. Personi fizik ka deklaruar dhe paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 2013-2019, si dhe tatimin në burim për qiranë për periudhën 2015, 2016 dhe 2019.

Për të ardhurat në formën e interesave bankare të depozitave janë marrë në analizë vlerat sipas nxjerrjes së llogarive bankare.<sup>77</sup>

Për të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme (automjete) janë marrë në analizë vlerat sipas kontratave të shitblerjeve.<sup>78</sup>

Për të ardhurat në formën e dhuratës janë marrë në analizë vlerat e deklaruara nga subjekti në deklaratën e interesave pasurore për vitin 2007.

Në rubrikën e detyrimeve janë pasqyruar shumat e marra hua referuar kontratave të kredisë lidhur me bankat e nivelit të dytë dhe nxjerrjes së llogarive bankare<sup>79</sup>, si dhe detyrimin e deklaruar ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në deklaratat e interesave pasurore për vitet 2005, 2006 dhe 2011.

---

<sup>74</sup> Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën 3.9.1999-31.12.2003; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2017 nga Gjykata e Shkallës së I për Krime dhe Rënda për periudhën 2004 – 2017; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2016 nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 1997 – 2001 dhe 2005 – 2016; vërtetim datë 23.9.2019 nga OSCE (bashkëlidhur vërtetimit edhe marrëveshja RSH dhe OSCE); vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2016 nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor; nxjerrje llogarie e “Union Bank” për pagat e përfituara nga \*\*\*; vërtetim DPT nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2019, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 6.8.2014, lista e pedagogëve 2007, 2012; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016 nga Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara dhe vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2019; vërtetim datë 20.9.2019 nga Universiteti “\*\*\*”; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2019 nga \*\*\* University; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016 nga Qendra për Nisma Ligjore; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2017 dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2019 nga KLD-ja; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.9.2019 nga \*\*\* Albania.

<sup>75</sup> Vërtetim datë 13.1.2017 nga OSCE për periudhën 2003 – 2016; vërtetim datë 18.9.2019 nga Qendra “\*\*\*\*” për vitin 2008; dokumentacioni i datës 17.9.2019 nga qendra ” \*\*\*\*”, raportet financiare 2009 - 2010; vërtetim i datës 18.9.2019 nga Instituti Shqiptar i Shkencave për periudhën 2011.

<sup>76</sup> Shkresa e DPTatimeve nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2019; shkresa e DPTatimeve nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2019; shkresa e DPTatimeve nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2019.

<sup>77</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 21.3.2019 nga “Union Bank”.

<sup>78</sup> Kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\*\*, datë 17.11.2014; kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\*\*, datë 12.12.2015.

<sup>79</sup> Kontratë kredie bankare nr. \*\*\*\*, datë 9.11.2005, nga “Raiffeisen Bank” marrë nga subjekti për shumën 5,000,000 lekë me afat 25 vjet me qëllim blerjeje apartamenti; kontratë kredie bankare datë 18.4.2014 me “Raiffeisen Bank” marrë nga bashkëshortja e subjektit për shumën 10,000 euro me qëllim për përdorim personal; kontratë kredie bankare datë 12.7.2007 me “BNG Bank” marrë

Në këtë rubrikë janë pasqyruar edhe të drejtat dhe detyrimet e personit fizik ndaj të tretëve, referuar pasqyrave financiare të aktivitetit tregtar dhe sipas shkresës së ILDKPKI-së nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2005, të drejta dhe detyrime këto që përfshihen në analizën financiare si të ishin të drejta dhe detyrime personale të bashkëshortes së subjektit.

Po në këtë rubrikë janë paraqitur edhe huat e dhëna<sup>80</sup> nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja. Këto hua rezultojnë si fond dalës për të ardhurat e familjes, prandaj në analizën financiare janë pasqyruar në kategorinë e detyrime me vlerë negative.

Lidhur me shpenzimet e deklaruara, u verifikua dhe u krahasua përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, në deklaratën “Vetting”, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë sa më poshtë:

- Shpenzimet e jetesës u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit. Për vitin 2007 konsumi për frymë është marrë sa shpenzimi i llogaritur për vitin 2008 në vlerën 136,620 lekë.

Për periudhën 2003 deri në gusht 2007 shpenzimet jetike janë llogaritur për familje me 1 anëtarë, ndërsa nga shtatori i vitit 2007 deri në nëntor 2008 janë llogaritur për familje me 2 anëtarë. Për periudhën dhjetor 2008 deri në prill 2011 shpenzime janë llogaritur për 3 anëtarë dhe pas kësaj date familja rezultoi të jetë me 4 anëtarë.

- Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit të dhëna në pyetësin nr. 1.

Për llogaritjen e shpenzimeve Komisioni i është referuar standardit të vendosur nga Kolegji në lidhje me çmimet e biletave, shpenzimeve për karburant, si dhe shpenzimeve ditore të qëndrimit.

Gjithashtu, shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar te të afërmit, duke përcaktuar adresën e qëndrimit, janë konsideruar sipas standardit të Kolegjit.

- Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshortja kanë deklaruar udhëtime për qëllime pune, për të cilat kanë vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion justifikues ligjor për mbulimin e këtyre shpenzimeve.
- Shpenzimet e mobilimit janë marrë në analizë referuar deklaratimit të subjektit për shumën totale prej 1,600,000 lekësh të detajuar sipas viteve kur janë kryer referuar deklarimeve të subjektit
- Shpenzimet e ceremonisë martesore janë marrë në analizë referuar deklaratimit të subjektit.
- Shpenzimet shëndetësore janë marrë në analizë referuar deklaratimit të subjektit.
- Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal+interes) i referohen pagesave të kësteve të kredisë bazuar në verifikimin e pasqyrave të lëvizjeve bankare në “Raiffeisen Bank” për periudhën 9.11.2005 deri në fund të vitit 2016 dhe në “NBG”, për periudhën 12.7.2007 – 20.11.2008.

---

nga bashkëshortja e subjektit për shumën 700,000 lekë me afat 4-vjeçar me qëllim mobilim apartamenti dhe ceremonie martesore, por mbyllur më 20.11.2008.

<sup>80</sup> Hua prej 1,400,000 lekësh e dhënë në datën 10.3.2014 sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 31.7.2014 dhënë nga Sandër Simoni.

Hua prej 30,000 euro e dhënë në datën 10.3.2014 sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 31.7.2014 dhënë nga A.J.



Lidhur me pasuritë e krijuara dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, në deklaratën “Vetting”, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë. Deklarimet e subjektit për gjendjen *cash* të akumuluar përputhen me gjendjen e kursimeve në *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”.

Në analizë janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare të individëve dhe të personit fizik tregtar.<sup>81</sup>

Likuiditetet (*cash*, bankë), janë regjistruar në një nënkategori të pasurisë “kursime” (pakësim/shtesa likuiditeti). Në këtë kategori kemi pasqyruar ndryshimin e zërit likuiditete, pra, shtesën ose pakësimin e ndodhur gjatë vitit përkatës në likuiditete.

Lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të krijuara për periudhën 2003 – 2016, janë marrë në konsideratë vlerat e tyre referuar kontratave të shitblerjes.<sup>82</sup>

Në analizën e subjektit janë marrë në analizë edhe pasuritë e personit fizik tregtar<sup>83</sup> si të ishin pasuritë personale të subjektit, në këtë rast të bashkëshortes së subjektit, për shkak të përgjegjësisë së pakufizuar të personit fizik tregtar.

Në përfundim të analizës financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, Komisioni konstaton se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar investimet, kursimet dhe shpenzimet e kryera prej tij dhe personave të lidhur me të, duke rezultuar me një balancë financiare pozitive për të gjithë periudhën.

---

<sup>81</sup> Sipas shkresës së ILDKPKI-së nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2005.

<sup>82</sup> Kontratë për prentim apartamenti nr. \*\*\*, datë 23.10.2005; kontratë nr. \*\*\*, datë 22.1.2003 për blerjen e automjetit tip “Ford Eskort”; kontratë nr. \*\*\*, datë 23.6.2009, për blerjen e automjetit tip “Daimlerchrysler 203”; kontratë nr. \*\*\*, datë 27.4.2010, tip “Ford KA”.

<sup>83</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2005, nga ILDKPKI-ja.

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Të ardhurat</b>	<b>586,412</b>	<b>1,326,222</b>	<b>1,643,714</b>	<b>1,707,604</b>	<b>2,747,035</b>	<b>3,839,856</b>	<b>3,342,917</b>	<b>3,716,804</b>	<b>3,570,487</b>	<b>3,145,431</b>	<b>4,198,333</b>	<b>5,270,569</b>	<b>4,812,846</b>	<b>4,316,228</b>
Të ardhura nga paga si gjyqtar	586,412	1,231,423	1,413,510	1,508,070	1,574,879	1,333,724	1,118,501	1,168,120	1,218,851	1,371,543	1,493,386	1,806,057	1,704,981	1,755,198
Të ardhura nga paga si pedagog	-	-	156,680	69,300	153,206	756,070	855,094	1,104,390	896,410	278,910	523,350	333,000	360,293	201,611
Të ardhura si ekspert	-	94,799	73,524	130,234	37,457	378,673	-	-	-	-	37,457	107,677	82,108	344,660
Të ardhura nga paga e b/shortes	-	-	-	-	324,522	999,380	1,243,309	1,371,859	1,389,638	1,441,072	1,621,529	1,654,419	2,026,916	1,974,266
Të ardhura nga konsuesia e b/shortes	-	-	-	-	-	372,010	113,302	55,524	-	53,906	-	-	-	-
Të ardhura nga aktiviteti si notere	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	522,611	518,891	438,549	40,493
Të ardhura nga imtreset	-	-	-	-	-	-	12,711	16,911	65,588	-	-	-	-	-
Dhuratë nga vëllai për mobilimin e shtëpisë	-	-	-	-	415,150	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Dhuratë nga motra për martesë	-	-	-	-	241,820	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shënjë e mjetit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	500,000	200,000	-
Të hyra nga kthimi i huasë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	350,525	-	-
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>5,500,000</b>	<b>0</b>	<b>700,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>-796,008</b>	<b>-3,755,244</b>	<b>-127,804</b>	<b>456,171</b>
Kredi bankare RBAL për blerje apartamenti	-	-	5,000,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Detyrim firmës Hella shpk	-	-	500,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi konsumatore NBG për mobilim shtëpie dhe ceram	-	-	-	-	700,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të biznesit si person fizik	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	445,483	446,956	127,804	456,171
Kredi bankare në RBAL 10,000 Euro	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,401,100	-	-
Hua dhënë L.J.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	350,525	-	-	-
Hua dhënë L.S.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-5,603,300	-	-
<b>Shpenzime</b>	<b>93,964</b>	<b>175,078</b>	<b>317,474</b>	<b>743,046</b>	<b>3,179,756</b>	<b>1,825,414</b>	<b>694,387</b>	<b>844,387</b>	<b>1,187,267</b>	<b>849,759</b>	<b>879,890</b>	<b>4,130,115</b>	<b>1,228,156</b>	<b>1,272,645</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI -së	93,964	93,964	109,557	109,557	182,160	284,625	409,860	409,860	500,940	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi	-	81,114	96,807	98,962	-	499,249	-	-	-	-	31,267	26,621	46,526	47,750
Shpenzime mobilimi	-	-	-	-	1,465,150	-	-	150,000	-	-	-	500,000	-	-
Shpenzime për ceram oninë martesore	-	-	-	-	1,138,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kredie S.S (principal +interes)	-	-	23,711	284,527	375,953	1,008,359	284,527	284,527	284,527	284,527	284,527	284,527	284,527	284,527
Shpenzime sigurim kredie	-	-	87,400	-	18,493	33,182	-	-	-	7,040	-	-	-	-
Shpenzime konsumi nga kredia 10,000 Euro	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	900,000	-	-
Shpenzime shëndetësore	-	-	-	-	-	-	-	-	151,800	-	-	-	-	-
Shpenzime kredie AJ(principal +interes)	-	-	-	250,000	-	-	-	-	250,000	-	-	1,538,975	-	-
<b>Pasuri</b>	<b>151,196</b>	<b>422,552</b>	<b>6,547,912</b>	<b>540,226</b>	<b>-974,140</b>	<b>567,523</b>	<b>435,174</b>	<b>1,657,156</b>	<b>1,537,506</b>	<b>870,218</b>	<b>1,007,245</b>	<b>-4,219,687</b>	<b>96,579</b>	<b>976,020</b>
Kursime (Pakësm/Shtesa likuiditet)	1,196	422,552	47,912	540,226	-974,140	567,523	-404,826	1,457,156	1,537,506	870,218	940,854	-4,206,409	-216,548	938,145
Autoveturë Ford Eskort ****	150,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Prenotim apartamenti 2+1, 162 m2 Rr. *****	-	-	6,500,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Autoveturë Daimlerchrysler 203 *****	-	-	-	-	-	-	840,000	-	-	-	-	-	-	-
Automjet tip Ford KA prodhim i vitit 1997	-	-	-	-	-	-	-	200,000	-	-	-	-	-	-
Automjet Mercedes Benz tipi A 160 ****	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	300,000	-
Aktive AAGJ të biznesit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	66,391	-13,278	13,127	37,875
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri</b>	<b>341,252</b>	<b>728,592</b>	<b>278,328</b>	<b>424,332</b>	<b>1,241,418</b>	<b>1,446,919</b>	<b>2,213,357</b>	<b>1,215,261</b>	<b>845,714</b>	<b>1,425,454</b>	<b>1,515,191</b>	<b>1,604,897</b>	<b>3,360,307</b>	<b>2,523,733</b>

## B. KONTROLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019, ka dërguar në Komision, Raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Sandër V. Simoni, i deklasifikuar plotësisht (me raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017 dërguar në Komision) dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se: *“Për subjektin e rivlerësimit z. Sandër V. Simoni nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Sa më sipër Grupi i Punës, konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Sandër Simoni”*.

DSIK ka dërguar në Komision, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2019, raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Sandër V. Simoni, i deklasifikuar pjesërisht (me raportin nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019. dërguar në Komision) dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se<sup>84</sup>: *“Grupi i Punës nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Sandër Simoni”*.

### Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit shpjegime në lidhje me konstatimet e bëra nga DSIK-ja.

Subjekti në përgjigjet e tij ka deklaruar se: *“...raporti i dytë i Grupit të Punës mbi papërshtatshmërinë e vazhdimin të detyrës nuk plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në nenin DH, pika 1 dhe 3 të Kushtetutës, Aneksi, Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk përmban asnjë nga elementët e parashikuara nga neni 38 pika 3, 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk është mbështetur në asnjë verifikim, nuk bazohet në asnjë provë prandaj ai duhet të konsiderohet i paplotë dhe i pavlerë për kontrollin e figurës sime.*

*Prandaj, unë kërkoj që në fillim që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të marrë parasysh vetëm Raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, të DSIK-së...”*

Subjekti i rivlerësimit ka vijuar të shpjegojë se: *“Kushtetuta dhe ligji parashikojnë se kontrolli i figurës nis me deklaratën e detajuar të figurës që mbulon periudhën 1 janari 2012 deri në ditën e deklaramit.*

*Sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se: “Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në*

---

<sup>84</sup>Për subjektin e rivlerësimit, z. Sandër Simoni, disponohen të dhëna të viteve 2003,2007-2010 xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx se mund të jetë përfshirë në veprimtari korruptive në disa procese gjyqësore, konkretisht: në një të dhënë të vitit 2003 thuhet se Sandër Simoni i ka premtuar vëllait të të pandehurit xxxxxxxxxxxxxx se do ta favorizonte/ndihmonte në çështjen penale kundrejt një shume të caktuar parash. Sandër Simoni ka dyshime se në vitet 2008-2010 ka pasur lidhje me shtetasin xxxxxxxxxxxxxx, person i përfshirë në trafik narkotikësh. Sandër Simoni mund të ketë favorizuar xxxxxxxx në mbylljen e problemeve të tij me drejtësinë si dhe mund të ketë favorizuar lidhjet e tij bashkëpunuese në çështje të caktuara penale.

Nga autoritetet verifikuese janë informuar dhe instancat kompetente xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx ku thuhet se:”...xxxxxxxxxxx një person i ndjekur për trafik të lëndëve narkotike xxxxxxxx nëpërmjet lidhjeve xxxxxxxx po pozicionohet si sekser për të krijuar lehtësi ose shmangie nga penalizimet e drejtësisë në favor të personave të ndryshëm. Ky person në bashkëpunim xxxxxxxxxxxxxx ndërmjetësojnë në trajtimin e çështjeve penale që lidhen me lirime të të burgosurve, ulje të dënimit, kalimit nga arrest me burg në arrest shtëpie etj., kundrejt pagesave në shuma të konsiderueshme. Për zgjidhjen e këtyre problemeve, ky person i evidentuar xxxxxxxx si sekser shprehet se do të marrë takim me kryesorin në funksion të favorizimeve të paligjshme në sistemin e drejtësisë xxxxxxxxxxxx.

*krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës”.*

*Neni 38, “Standardet e kontrollit të figurës”, pika 3, “Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parash në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6, të këtij neni, dhe rrethanat lehtësuese sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementët e parashikuar në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë.*

*Rrethanat ku duhet të bazohet vlerësimi sa i përket kontrollit të figurës, përcaktohen nga paragrafi 4 i nenit 38 të grupuara në 5 kategori....*

*Vlerësimi i informacionit të sjellë nga DSIK-ja i mbetet Komisionit, i cili është organi i vetëm kushtetues që vlerëson subjektet kalimtare në tre kriteret e vlerësimit. Në këtë përfundim ka arritur edhe Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2/2017...*

*Në këtë rast informacioni i përcjellë në Raportin i DSIK-së nuk përmban asnjë nga elementët e parashikuara nga neni 38 pika 3, 4 e ligjit nr. 84/2016, prandaj ai duhet të konsiderohet i paplotë dhe është në kompetencën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që ta konstatojë këtë.*

*Duket qartë që ky raport nuk përmban asnjë të dhënë të besueshme, objektive, provë apo fakt, por bazohet vetëm në shprehjet se mund të jetë përfshirë..., ka dyshime..., mund të ketë favorizuar..., apo se një person sekser paska deklaruar se mund të marrë takim me kryesorin etj. ...pa thënë asgjë konkrete, pa referuar në një rast konkret, pa burim prove të besueshëm, pa përmendur se çfarë veprimi kam bërë unë, a jam takuar me ata persona, a kam qenë unë gjyqtar në çështjet penale që përmenden në këtë informacion, a kanë qenë këto çështje në gjykim në gjykatën ku unë punoj, dhe a kam dhënë vendime favorizuese, kush janë këto persona që hiqen se kanë njohje me mua, a jam takuar unë ndonjëherë me këto persona, kur është realizuar kontakti i papërshtatshëm dhe pa dhënë asnjë provë për këtë etj.*

*Për mua ky raport nuk thotë asgjë e nuk ka asnjë të dhënë të besueshme përderisa nuk jep asnjë të dhënë konkrete, por vetëm supozime që hedhin dyshime pa vend e pa të drejtë mbi figurën time.*

*Informacioni që referon Raporti i dytë i DSIK-së nuk ka asnjë bazë, nuk jep asnjë të dhënë, as një veprim timin nëse kam qenë apo jo unë gjyqtar në çështjet që pretendohen, nëse kam patur kontakt me këto persona, a janë ato persona të përfshirë në krim të organizuar, çfarë veprimi kam bërë unë e si kam ndikuar apo përfituar. Janë vetëm hamendje dhe dyshime, përfolje dhe fjalë pa bazë.*

*Nuk është bërë asnjë verifikim nga ana e institucionit referues apo Grupit të Punës, rrethanave që lidhen me atë a ekzistojnë këto persona, a kanë lidhje apo njohje me mua, a kam qenë unë gjyqtar në çështjet që pretendohet se ato tentojnë të përfitojnë. Nga sa burime vjen ky informacion dhe a janë të besueshme këto burime.*

*Në këtë informacion nuk jepet kush është burimi e nëse ky burim është i besueshëm apo jo, mundet që ky burim të ketë tendencë ndaj personit tim për shkak të detyrës e funksionit tim në vite, nuk ka asnjë të dhënë konkrete, foto, dëshmitar që të përshkruajë nëse unë kam bërë ndonjëherë takim me ndonjë person të tillë, nuk ka asnjë të dhënë nëse unë vërtet i njoh apo kam lidhje me këto persona, a kam patur gjyqe apo takime me to apo njerëzit e tyre, a kam patur apo kur jam takuar jo rastësisht me to, çfarë favoresh kam shkëmbyer me to apo çfarë kam përfituar prej tyre, cilat janë lidhjet e mia me to dhe çfarë përfaqësojnë këto persona a janë apo jo persona të përfshirë në krim të organizuar, në cilat takime jam takuar me to, a kanë ndonjë fakt të njohur, të dokumentuar apo të publikuar për këto takime.*

*Për sa më sipër, ky Raport është i paplotë dhe nuk plotëson kushtet e nenit 38, të ligjit pika 3, 4. Grupi i Punës në rastin e Raportit të dytë nuk ka përmbushur detyrat sipas nenit 37 të ligjit duke mos iu përmbajtur kërkesave të përgjithshme e pa bërë asnjë verifikim dhe duke futur në raport apriori një informacion të paverifikuar të një institucioni. Do kishte qenë shumë e lehtë të verifikohesh minimalisht a kam qenë unë gjyqtar në çështjet e përmendura në informacion, a kanë qenë çështje në gjykim në gjykatën ku unë kam punuar dhe a kanë lidhje me mua këta apo ai person që citohet, a është person ai përfshirë në krim të organizuar apo kemi të bëjmë me mashtrim.*

*Nuk ka asnjë të dhënë që unë të jem përfshirë në ndikim mbi çështje të cilat siç del unë nuk kam qenë gjyqtar i tyre, nuk kam qenë as Kryetar Gjykate në atë periudhë që përmend informacioni i përfshirë në raport.*

*Për rrjedhojë, nuk ka asnjë të dhënë, provë, fakt që unë të kem patur “kontakte të papërshtatshme”, ku sipas pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: “Kontakt i papërshtatshëm” është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni, ose ndonjë marrëdhënie tjetër”.*

*Në raport thuhet “..mund të ketë kontakte të papërshtatshme... “nuk thotë se ka kontakte të papërshtatshme duke mos dhënë asnjë fakt, provë që ka patur kontakt të tillë.*

*“Marrëdhëniet që mund të jetë..... “ thotë raporti “...me personin në gjykim ose personin e lidhur me të.... “”po në fakt nuk del të jetë asnjë marrëdhënie pasi unë nuk kam patur në gjykim asnjë nga personat siç del nga hetimi i Komisionit.*

*Si është bërë verifikimi nëse ka tendenca kriminale për përfshirje në krim të organizuar pa verifikuar asnjë kontakt, gjykim, telefonatë etj. kërkesë kjo e pikës b) të nenit 37 të ligjit ?*

*Si u arrit në konkluzionin apo vlerësimin e përgjithshëm nëse unë si subjekt mund të vihem nën presion nga struktura kriminale. Si është arritur në këtë konkluzion hipotetik me mund kur unë kam qenë gjyqtar e kam drejtuar një gjykatë që ka gjykuar të gjitha rastet e krimit të organizuar në vend, duke konfirmuar në mbi 99 % të rasteve akuzat për krim të organizuar. Unë si gjyqtar më rezulton se kam konfirmuar në 100 % të rasteve akuzat për krim të organizuar të sjella nga prokuroria, por edhe për trafikim në rastet kur unë kam patur çështje të tilla.*

*Nga informacioni që ka dërguar Prokuroria e Përgjithshme e konkretisht Drejtoria e Përgjimeve të Komunikimeve Elektronike dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, shkresa \*\*\* datë 29.01.2019, del se ndaj personit tim nuk ka patur asnjëherë ndonjë informacion apo indicie nga agjencitë ligjzbatuese që të bëjë fjalë për implikim në kryerjen e ndonjë vepre penale apo për cenim të figurës...*

*Në Relacionin mbi hetimin paraprak të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit tek “Konstatime të tjera” pjesa e relacionit faqe \*\*\*, del se Komisioni ka bërë verifikime dhe hetime të mëtejshme nisur nga disa indicie duke kryer korrespondencë me gjykatat për të marrë informacione. Pas këtyre hetimeve ka rezultuar se:*

- 1. Unë nuk kam qenë gjyqtar i çështjes penale në ngarkim të shtetasit I.H. i gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në vitin 2003. Sipas vendimit nr. \*\*\* datë 20.06.2003 del se ky vendim është dhënë nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Rrethit Shkodër e jo nga unë.*
- 2. Unë nuk kam gjykuar çështje ndaj shtetasit K.H.N. ( të cilin nuk e njoh fare e nuk e kam dëgjuar asnjëherë si emër ) dhe në Gjykatën e Krimeve të Rënda apo Prokurorinë e Krimeve të Rënda nuk ka patur asnjë procedim ndaj këtij shtetasi.*

3. *Në Gjykatën e Krimeve të Rënda nuk ka patur procese gjyqësore apo procedime ndaj shtetasve F.C., M.C., E.Y., A. dhe P.K., I.K. (të gjithë emra të panjohur për mua)*
4. *Unë nuk kam qenë pjesë e trupave gjyqësore që ka gjykuar çështjet penale ndaj të pandehurve R.Sh., L.K., A.L. në vitet kur janë gjykuar këta persona kam qenë gjyqtar dhe jo Kryetar Gjykate e nuk kam patur asnjë dijeni për këto procese. Këta të pandehur janë gjykuar nga gjyqtarë të tjerë.*

*Duke u ndalur në referimin e të dhënës për vitin 2003, informacioni i përcjellë pranë Komisionit nuk përmend burimin e provës si dhe nuk i referohet ndonjë rasti apo ngjarje konkrete. Në këtë mënyrë, mbrojtja ime përballë këtij informacioni më kufizohet ndjeshëm për shkak se mungojnë të gjitha elementet referues të cilat do të më lejonin që unë të bëja kundërshtimet e mia konkrete. Në vlerësimin tim një informacion i pashoqëruar me burimet e ligjshme të provave, nuk duhet të merret në konsideratë nga ana e Komisionit. Informacioni në këtë rast është thjesht një hamendësim i dëmshëm dhe si tillë ai nuk përmban vlerën e provës.*

*Konstatoj që është një informacion pa një burim prove të besueshëm, dashakeq e tendencioz, pa përmendur se çfarë veprimi kam bërë unë, a jam takuar me ata persona, a kam patur unë çështje të tilla, dhe a kam dhënë vendime favorizuese, kur është realizuar kontakti i papërshtatshëm e pa dhënë asnjë provë a fakt për ato që referon.*

*Ky informacion i padrejtë dhe tendencioz që tenton ta paraqesë si shtrirje në kohë kompromentimin e figurës sime pa u mbështetur në asnjë fakt, provë, të dhënë të besueshme nuk citon se periudha e verifikimit nuk duhet të shtrihet pafundësisht duke cituar vitin 2003 në kontekst të të cilit vë një të dhënë krejt të pabazë, vite në të cilët unë nuk kam asnjë vendim të diskutueshëm pasi jam me 100 % të vendimeve në fuqi për 3 vjet e që kam kaluar verifikim të institucioneve të inteligjencës para se të dekretohesha gjyqtar i Krimeve të Rënda nga Presidenti i Republikës, dhe të caktohesha Kryetar i Gjykatës së Krimeve të Rënda...*

*Institucioni i verifikimit që ka dhënë atë informacion nuk ka bërë asnjë verifikim në të vërtetë minimumi për të saktësuar nëse kam qenë unë gjyqtar në çështjen e vitit 2003 që citohet në raport. Grupi i Punës po ashtu nuk ka bërë asnjë verifikim dhe nuk ka zbatuar detyrimin që rrjedh nga neni 39 i ligjit paragrafi 1 i tij<sup>85</sup> për të bërë verifikimin nëse informacioni është i saktë dhe nëse vërtet ka kontakt të papërshtatshëm apo jo.*

*Sipas Kushtetutës dhe ligjit, kontrolli i figurës nis me deklaratën e detajuar për figurën, që mbulon periudhën nga 1 janari 2012 deri në ditën e deklaramit<sup>86</sup>, sipas ligjit, pra, subjekti i rivlerësimit deklaroi për kontakte të papërshtatshme referuar kësaj periudhe.*

*Kështu që, pavarësisht se unë mbetem i hapur për verifikimin e figurës time që nga momenti kur unë kam filluar detyrën e gjyqtarit, vlerësoj se mbështetur në referencat e mësipërme ligjore viti 2003 nuk duhet të ishte i përfshirë në Informacionin e dërguar në Komision nga DSIK-ja.*

*Sipas konstatimeve të bëra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit tek relacioni mbi hetimin administrativ del që unë nuk kam qenë gjyqtar i çështjes së verifikuar në vitin 2003 .*

*Pjesa e informacionit për vitet 2008 - 2012. Nga verifikimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit del se unë nuk kam qenë gjyqtar në gjykimin e çështjeve ndaj personave të përmendur e 6 prej tyre nuk kanë patur proces asnjëherë në Gjykatën e Krimeve të Rënda.*

<sup>85</sup> Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar në bashkëpunim me Grupin e Punës, brenda 60 ditëve nga konstituimi i Grupit të Punës, verifikon nëse informacioni është i saktë dhe nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

<sup>86</sup> Neni DH, kontrolli i figurës, Aneks, rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

*Nga periudha 2008 – 2012 kam qenë në pozicionin e gjyqtarit e jo të Kryetarit të Gjykatës. Kjo është periudha sipas së cilës në informacion thuhet se unë mund të kem ndikuar me pozitën time për të ndihmuar e favorizuar një person që hiqej si sekser duke cituar se “ky person është shprehur se do të merrte takime me kryesorin...” Pra në këtë periudhë unë nuk kam patur funksion drejtues, pse atëherë sekseri duhej të më referohej mua si “kryesori “ ? Duket qartë që nëse ka diçka të vërtetë në këtë të dhënë kemi të bëjmë me një mashtrim. Informacioni në këtë rast, në vlerësimin më të mirë të tij është mbështetur në të dhëna të pavërteta dhe të pasakta, ndërsa në vlerësimin tim ai është jo profesional dhe i hartuar jo në përputhje me ligjin.*

*Më konkretisht, në informacion në mënyrë të nënkuptuar dhe jo të drejtpërdrejtë, rezulton se unë në vitet 2008 – 2012 kam qenë Kryetar i Gjykatës së Shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë. Kjo e dhënë nuk është e vërtetë. Në këtë kohë, unë kam ushtruar detyrën e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë. Gjithashtu informacioni nuk referon për burimin e provës që duhet të përfshijë së paku çështjen ose çështjet konkrete ku sekseri do të merrte takim me kryesorin. I ndodhur përballë kësaj situatë e cila është e paqartë dhe me natyrë tendencioze, vlerësoj se për këtë periudhë kohore informacioni nuk duhet të merret në konsideratë nga ana e Komisionit.*

*Sipas nenit 38 të ligjit për standardin e kontrollit të figurës, ky kontroll duhet të zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme. Unë këtu nuk kam parë asnjë provë të saktë apo ndonjë informacion tjetër të disponueshëm. Si proces kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet sipas rrethanave të parashikuara. Në Raport nuk ka asnjë konstatim, nuk ka asnjë vlerësim prove pasi nuk është dhënë asnjë provë. Nuk ekziston asnjë rrethanë nga ato që parashikon ligji në nenin 38 paragrafi 4...*

*Në këtë rast DSIK-ja dhe Grupi i Punës nuk ka zbatuar detyrimin që rrjedh nga neni 39 i ligjit paragrafi 1 i tij<sup>87</sup> për të bërë verifikimin nëse informacioni është i saktë dhe nëse vërtet ka kontakt të papërshtatshëm apo jo. Minimalisht Grupi i Punës duhej të verifikonte nëse unë kam qenë gjyqtar në çështjet që pretendohet se është ndërhyrë e nëse ka prova për kontakt të papërshtatshëm. Në këtë rast është marrë e futur në Raport apriori informacioni i institucionit të verifikimit....*

*Për të gjitha këto ky informacion dhe Raporti që mbështetet në të pa e verifikuar saktësinë e tij, nuk plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në nenin DH, pika 1 dhe 3 të Kushtetutës, Aneksi, Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk përmban asnjë nga elementët e parashikuara nga neni 38 pika 3, 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk është mbështetur në asnjë verifikim, nuk bazohet në asnjë provë prandaj ai duhet të konsiderohet i paplotë dhe i pavlerë për kontrollin e figurës sime.*

*.....prandaj jam treguar gjithmonë i kujdesshëm në sjelljen time si qytetar, gjyqtar, e funksionar i sistemit të drejtësisë. Mirëpo ne nuk jemi të imunizuar nga seksesët, mashtruesit që jashtë dijenisë sonë mund të abuzojnë me emrin tonë. Institucionet duhej të na vinin në dijeni ndryshe të informonin institucionet përkatëse e të nisej procedim penal, pra ose duhej të bashkëpunonim ose ti tregonin njëri-tjetrit rrugët e procedimit penal. Në rastet kur unë jam vënë në dijeni i jam drejtuar organeve kompetente dhe në dy raste në vitin 2007 dhe 2011 unë kam bërë kallëzim në Prokurorinë Tiranës ndaj dy personave të cilët më vonë janë dënuar për veprat penale të “Mashtrimit” dhe “Shpifjes për shkak të detyrës”. Bashkëngjitur këtyre*

---

<sup>87</sup> Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar në bashkëpunim me Grupin e Punës, brenda 60 ditëve nga konstituimi i Grupit të Punës, verifikon nëse informacioni është i saktë dhe nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

*shpjegimeve po paraqes rastet e kallëzimeve të mia dhe dënimeve të dhëna nga gjykata sipas këtyre kallëzimeve, si vijon:*

1. *Kallëzim i datës 18.7.2007 për veprën penale të “shpifjes për shkak të detyrës”, neni 240 i Kodit Penal ndaj shtetases A.L.*
2. *Vendim nr. \*\*\*, datë 23.4.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin e pandehura A.L. është deklaruar fajtor për veprën penale të “mashttrimit”, neni 143/2 të Kodit Penal dhe atë të “shpifjes për shkak të detyrës”*
3. *Kallëzim i datës 2.3.2011 i paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë*
4. *Vendimi nr. \*\*\*, datë 5.12.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me anë të të cilit e pandehura A.L. është deklaruar fajtor për veprën penale të “mashttrimit me pasoja të rënda” të kryer në bashkëpunim, nenet 143/2 dhe 25 të Kodit Penal dhe për veprën penale të “shpifjes për shkak të detyrës”, neni 240 /1 i Kodit Penal.*
5. *Vendimi nr. \*\*\*, datë 6.5.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për deklarimin fajtor të të pandehurit P.K. për veprën penale të “mashttrimit me pasoja të rënda”, nenet 143/2 dhe 25 të Kodit Penal.*

*Kam dorëzuar bashkë më shpjegimet kallëzimet dhe vendimet gjyqësore ndaj tyre. Nuk di nëse janë këto rastet që referon Raporti, por kushdo qofshin këto persona unë jam kategorikisht i prerë që unë në asnjë rrethanë, e asnjëherë nuk jam takuar kontaktuar me to, apo t'i kem ndihmuar në ndonjë çështje, apo të kem ushtruar ndikim për shkak të ndërhyrjes së tyre. Në mungesë të identifikimit të burimit që duhet të paraqiste Raporti i DSIK, unë po paraqes prova konkrete të cilat më vendosin në një raport të drejtë me ligjin dhe me detyrën time si gjyqtar duke hedhur poshtë të gjitha përfundimet e nxjerra nga Raporti jo i plotë i DSIK. Si rrjedhim, deklaroj se nuk jam takuar me asnjë person të dyshimtë, apo kontakt të papërshtashëm, nuk kam ndihmuar apo favorizuar asnjë person në ndonjë çështje, apo të kem ushtruar ndikim për shkak të ndërhyrjes së tyre...*

*Për sa argumentova më sipër kërkoj që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi të marrë në konsideratë shpjegimet e mia dhe provat bashkëlidhur atyre, të bëjë vetë verifikimin dhe vlerësimin e figurës sime duke marrë parasysh vetëm Raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, të DSIK i dorëzuar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019, mbi kontrollin e figurës për mua si subjekt rivlerësimi, i deklasifikuar plotësisht me raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017...*

*Në bazë të nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, germa “a”, nenit 36 dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, të vendosë që unë subjekti i rivlerësimit Sandër Simoni arrij një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.”*

### **Në lidhje me deklaratën e kontrollit të figurës**

*Nga verifikimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën për kontrollin e figurës, shtojca 3, në datën 25.1.2017.*

*Referuar kësaj deklarate, në rubrikën “të dhëna për sigurinë”, në lidhje me kontaktet e papërshtatshme apo përfshirje të anëtarëve të familjes në veprimtari të krimit të organizuar etj., subjekti i rivlerësimit, z. Sandër Simoni, ka deklaruar se nuk ka dijeni nëse anëtarë të familjes kanë kontakte të papërshtatshme apo janë të përfshirë në krimin e organizuar.*

*Komisioni është vënë në dijeni nga mjete të informimit publik, në vitin 2019, se shtetasi V.P., kushëri i parë me subjektin e rivlerësimit (djalë teze), ka qenë i dënuar në shtetin Italian në vitin 2003 për trafik lëndësh narkotike, por që nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në këtë deklaratë.*



Komisioni, për të qartësuar këtë situatë, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë lidhjen familjare që ka me shtetasin V.P., dhe nëse kanë frekuentim të vazhdueshëm me njëri- tjetrin.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“...shtetasi V.P. është kushëri nga ana e nënës së tij dhe për shkak të kësaj lidhje fisnore jemi takuar në raste jo të shpeshta familjare si raste dasmash, ditëlindje brenda fisit apo ceremoni ku ne kemi qenë të ftuar në të njëjtën kohe nga të afërm të përbashkët.*

Subjekti deklaroi: *“...nuk ka udhëtuar askund ndonjëherë me të dhe hera e fundit kur e ka takuar ka qenë muaji Korrik 2019 në një takim rastësor me të afërm të përbashkët. Nuk ka ndonjë marrëdhënie të afërt me të për shkak të moshës dhe për shkak të distancës që ka mbajtur subjekti meqë V.K. ishte person i angazhuar politikisht.”*

Subjekti ka shpjeguar: *“ ... në fillim të muajit gusht nga media kam dëgjuar si gjithë opinioni publik që një subjekt politik ka bërë publike disa të dhëna në lidhje me probleme të tij me drejtësinë italiane dhe se Prokuroria e Përgjithshme ka filluar procedurat e verifikimit sipas ligjit të dekriminalizimit për shkak se ai ishte subjekt i këtij ligji.*

*Unë nuk kam pasur asnjë dijeni për këtë pretendim dhe e kam mësuar nga media si gjithë të tjerët. Asnjë nga familjarët e mi, as nëna dhe as prindërit e tij me të cilët kam diskutuar më pas, nuk ishin në dijeni të asnjë fakti të tillë të pretenduar. As unë, as nëna ime, e asnjë nga familja ime nuk dimë që ai të ketë qenë i ndaluar, apo i dënuar në shtetin italian. Ne dinim vetëm faktin që ai ka qenë student në Itali. Edhe prindërit e tij L. e D.P. më kanë konfirmuar që nuk dinin asgjë në lidhje me sa thuhej në media dhe se edhe ai vetë nuk kishte dijeni. Ai vetë ishte funksionar dhe person publik dhe nuk ka deklaruar se ka qenë i ndaluar, apo i dënuar ndonjëherë për sa thuhej në media.*

*Nga ky moment që jam vënë në dijeni se po diskutohet një pretendim i tillë rreth tij, unë kam ndërprerë çdo marrëdhënie, komunikim e kontakt me të si dhe nuk jam takuar më asnjëherë me të”.*

Komisioni ka kryer verifikime dhe në sistemin TIMS për të parë nëse subjekti i rivlerësimit Sandër Simoni dhe shtetasi V.P. kanë udhëtuar bashkë në të njëjtat data apo me të njëjtin automjet apo linja ajrore, me qëllim vërtetimin e ndonjë lidhjeje të vazhdueshme shoqërore, përveç asaj familjare.

Nga verifikimi në sistemin TIMS, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi V.P. të kenë udhëtuar bashkë në të njëjtat data apo në të njëjtin automjet apo linjë ajrore.

### **Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit**

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoj subjektit që të japë shpjegime të përmbledhura në lidhje me shtetasin V.P.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar se: *“...unë me shtetasin V.P. kam lidhje për shkak të gjinisë si kushërinj të parë nga ana e nënës dhe takimet me të kanë qenë të radha në raste eventesh familjare si dasma, ditëlindje apo evente të tilla brenda fisit për shkak të kësaj lidhjeje. Një marrëdhënie e tillë farefisnore nuk është një marrëdhënie e afërt në kuptimin e anëtarit të familjes, marrëdhënie që mund të nënkuptojë dijeni për çdo fakt të jetës së të afërmit....unë nuk kam udhëtuar asnjëherë më të jashtë vendit apo me automjeti të përbashkët me të.*

*Unë në momentin e plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës nuk kam patur asnjë dijeni që ai ka patur probleme me drejtësinë italiane, apo aq më tepër vendim dënimi për ndonjë vepër penale. Asnjë njeri i imi, i familjes, nëna, babai, motrat, vëllai nuk kanë patur dijeni. Asnjë nga familja e tezes sime nuk na ka thënë një gjë të tillë. Unë kam qenë në dijeni vetëm që në vitet 2000 ka qenë student në Itali. Bashkëngjitur po dorëzoj një deklaratë të prindërve të*

tij L. e D.P. ku ata deklarojnë se nuk kanë qenë në dijeni të një fakti të tillë e se asnjëherë kjo nuk është diskutuar me mua.

Ai ka qenë funksionar shtetëror dhe publik, subjekt i ligjit të dekriminalizimit, ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe nuk ka deklaruar ndonjë problem të tillë me drejtësinë italiane që unë të vihesha në dijeni, duke kandiduar edhe për kryetar të një bashkie. Unë e kam ndjekur si qytetar këtë proces nga mediat, ku kam ndjekur dhe deklaratat e tij se nuk ka probleme me drejtësinë, e më vonë se nuk ka qenë në dijeni të tyre. Ai me këto qëndrime ka marrë përsipër vetë pasojën që rrjedh nga mosdeklarimi i një shtate të tillë. Për pasojë, unë nuk kisha si ta dija kur publikisht ky fakt nuk njihej as nga opinioni e as nga institucionet përgjegjëse që kanë lejuar kandidimin e tij për t’u zgjedhur si kryetar bashkie.

Në lidhje me këtë unë jam vënë në dijeni nga media si gjithë të tjerët në gusht të vitit 2019. Pasi jam vënë në dijeni si gjithë të tjerët nga media në gusht të vitit 2019, nuk kam patur asnjë kontakt më me të. Nga një njoftim zyrtar i Prokurorisë së Përgjithshme jam vënë në dijeni se nga ana e këtij institucioni ka rezultuar pas verifikimit se ai ka qenë i dënues në Itali për veprën penale të ‘Mbajtjes së lëndëve narkotike në bashkëpunim’, neni 110 i KP Italian, dhe jo atë të trafikimit siç është pretenduar në media nga një subjekt politik. Nga ky njoftim del se është dënues me 18 muaj burgim duke u pezulluar dënimi dhe mospërmendje.

Nga prindërit e tij më është deklaruar se procedimi ndaj tij ka të bëjë me një episod në të cilin ai nuk është i përfshirë, pasi bëhet fjalë për gjetjen e një sasive të vogël lënde narkotike me përbërës kryesor kimik si lëndë narkotike prej 3 gr. disa shokëve të tij studentë e deklaruar për përdorim vetjak, në konviktin ku ai ishte i regjistruar gjatë kohës së studimeve e se ai po e ndjek çështjen në shtetin italian nëpërmjet procedurës së revokimit të vendimit dhe rishikimit të tij. Bashkëngjitur deklarata noteriale e tezes sime D.P. dhe burrit të tezes L.P., në të cilën ata konfirmon këtë fakt dhe atë që asnjëherë nga ana e prindërve të tij, tezes sime, me mua nuk është diskutuar një gjë e tillë, pasi edhe ata nuk ishin në dijeni.

Në këto kushte unë nuk kam patur dijeni për dënimin e tij në shtetin italian e për rrjedhojë nuk kam patur se çfarë të deklaroj në formularin e deklaratës së figurës.

Sipas Kushtetutës dhe ligjit, kontrolli i figurës nis me deklaratën e detajuar për figurën, që mbulon periudhën nga 1 janari 2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit, pra subjekti i rivlerësimit deklaroi për kontakte të papërshtatshme referuar kësaj periudhe. Mënyra e kontrollit të figurës detajohet brenda parimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016 që në nenin 34 të tij, përcakton qartë objektin e kontrollit të figurës: ‘Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarameve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës’.

Që të deklarohet një kontakt i përshtatshëm apo i papërshtatshëm duhet që subjekti të jetë në dijeni të tij.<sup>88</sup> Unë nuk kam qenë në dijeni pasi bëhet fjalë për një vendim të dhënë në shtetin italian në vitin 2003. Lidhja ime nuk është aq e afërt sa që unë të merrja vesh këtë detaj nga jeta e tij personale një detaj shumë i hershëm i ndodhur në një shtet tjetër në një periudhë kur ne nuk kishim asnjë komunikim me njëri – tjetrin. Nuk është në rrethin e personave të afërm apo familjarë kontakti me të cilët është i pashmangshëm e për të cilët subjekti duhet të ketë dijeni eventualisht për jetën e tyre siç janë të afërmit e familjes si vëllai, motra, bashkëshorti/ia.

<sup>88</sup> Pika 179/b e Aneksit DH të Kushtetutës, pika 5 e nenit 34 të ligjit nr. 84/2016.

*Vendimi është dhënë në shtetin italian, një vendim me një masë të ulët dënimi si dënim alternativ e për rrjedhojë ai nuk ka vuajtur asnjë ditë burgim. Për pasojë unë nuk kisha si të vihesha në djeni të këtij vendimi. Gjatë kohës që kushëriri im ka qenë në Itali unë nuk kam patur asnjë kontakt me të.*

*Për arsye sa më sipër, unë nuk kisha mundësi për ta deklaruar këtë në deklaratën për kontrollin e figurës e se nuk jemi para rastit të mosdeklarimit të kontaktit të papërshtatshëm.*

*Sa sipër kërkoj që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, të konstatojë që në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, mbi kontrollin e figurës sime si subjekt i rivlerësimit, formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016,*

*Në bazë të nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, germa “a”, në nenin 36 dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, të vendosë që unë subjekti i rivlerësimit Sandër Simoni arrij një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”.*

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi mori në konsideratë provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, shpjegimet e dhëna prej tij, si dhe hetimin e thelluar të kryer, arriti në përfundimin se:

1. Nuk u vërtetua që subjekti i rivlerësimit të ketë apo të ketë pasur, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.
2. Nuk u vërtetua pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit, në pozicionin e anëtarit apo kryesuesit të trupës gjyqësore, në proceset gjyqësore me persona të dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar, duke hequr çdo dyshim mbi përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprimtari korruptive.
3. Subjekti i rivlerësimit e ka plotësuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 25.1.2017, ndërkohë që dënimi i shtetasit V.P. është dhënë në vitin 2003 në Itali dhe ngjarja është bërë publike në Shqipëri në vitin 2019, nuk u vërtetuan lidhje apo kontakte të vazhdueshme shoqërore mes tyre, përveçse atyre familjare. Subjekti e ka plotësuar me saktësi dhe vërtetësi deklaratën e kontrollit të figurës duke dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me marrëdhënien e tij me shtetasin V.P.
4. Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Rivlerësimi profesional sipas nenit 44 të ligjit 84/2016 është i bazuar në raportin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka hartuar raportin vlerësues nr. \*\*\* prot., datë 5.6.2018, për subjektin e rivlerësimit, z. Sandër Simoni.

Në raportin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe të miratuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë janë evidentuar aftësi të mira të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me:

- **Aftësitë organizative** ku përfshihen: a) *aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*; b) *aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*; c) *aftësia për të administruar dosjet*.
- **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale** ku përfshihen: a) *etika në punë*; b) *integriteti*; c) *paanësia*.
- **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional** ku përfshihen: a) *aftësitë e komunikimit*; b) *aftësia për të bashkëpunuar*; c) *gatishmëria për t'u angazhuar*.

## ❖ TRI DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

### Vlerësimi nga Grupi Vlerësues pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë i tri dokumenteve të paraqitura nga subjekti

**Dokumenti 1.** Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 11.12.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë<sup>89</sup>, ku subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në trup gjykues me pesë gjyqtarë dhe ka qenë kryesues. Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 12 ditë brenda afatit 12 mujor të përcaktuar nga ligji.

Gjykata Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur fajësinë dhe dënimin e të pandehurve sipas akuzave.

Mbi ankimin e të pandehurve Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.3.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 11.12.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Vendimi i dhënë nga trupi gjykues me kryesues Sandër Simoni, përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Në *pjesën hyrëse* të vendimit, janë përshkruar palët, akuzat ndaj secilit të pandehur, si dhe kërkimet përfundimtare të akuzës dhe të secilit prej të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre.

Në *pjesën arsyetuese* gjejnë pasqyrim rrethanat e çështjes, në analizë janë përfshirë edhe deklaratimet e shtetasve, por edhe aktet shkresore pjesë e hetimit paraprak, gjykata është ndalur në analizën ligjore të provave, çmimin e tyre në raport me kërkesat e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, lidhja e tyre me njëra-tjetrën, bindja e krijuar nga gjykata pas shqyrtimit të tyre; në analizën e figurës për veprën penale atribuar secilit të pandehur në raport me parashikimet e bëra nga dispozita përkatëse e Kodit Penal, provimi i fajësisë, rrethanat që merr parasysh gjykata në caktimin e masës së dënimit, disponimi për provat materiale.

Pjesa e tretë - *disponimi i gjykatës* - ka të pasqyruar me saktësi konkluzionin e arritur nga gjykata në pjesën arsyetuese-përshkruese në rastin konkret. Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm

**Dokumenti 2.** Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 20.4.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë<sup>90</sup>, ku subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në trup gjykues me 5 gjyqtarë,

<sup>89</sup> Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 11.12.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, kundër të pandehurit M.D., i akuzuar për veprat penale të “trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, në tentativë” dhe të “prodhimit dhe shitjes së lëndës narkotike” të parashikuara nga nenet 283/a/2, 22 dhe 283/1 të Kodit Penal; si dhe të pandehurve B.D. dhe A.D. të akuzuar për veprën penale të “trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, në tentativë” të parashikuara nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

<sup>90</sup> Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 11.12.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë kundër të pandehurit M. D., i akuzuar për veprat penale të trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, në tentativë” dhe të “prodhimit dhe shitjes së lëndës narkotike” të parashikuara nga nenet 283/a/2, 22 dhe 283/1 të Kodit Penal; si dhe të pandehurve B.D. dhe A.D. të akuzuar për veprën penale të “trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, në tentativë” të parashikuara nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

ku ka qenë kryesues dhe gjykimi ka zgjatur 10 muaj e 10 ditë, brenda afatit 12 mujor të përcaktuar nga ligji.

Gjykata Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë në seancë gjyqësore publike të datës 20.4.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit sipas akuzës dhe dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Mbi ankimin e të pandehurit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.6.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 20.4.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Vendimi i dhënë nga trupi gjykues me kryesues Sandër Simoni, përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Në pjesën hyrëse të vendimit, janë përshkruar palët, akuza ndaj të pandehurit, si dhe kërkimet përfundimtare të akuzës dhe të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

Në pjesën arsyetuese gjejnë pasqyrim rrethanat e çështjes ashtu siç i kanë rezultuar gjykatës gjatë gjykimit. Meqë i pandehuri ka qenë shtetas i huaj, gjykata është kujdesur që atij t'i respektohen garancitë procedurale të parashikuara nga neni 98 i Kodit të Procedurave Penale dhe nga neni 6 i KEDNj-k.psë, duke i caktuar një përkthyes të gjuhës spanjolle, si dhe duke i siguruar të drejtën e mbrojtjes, sipas neneve 6, 48 dhe 49 të Kodit të Procedurave Penale.

Janë marrë në analizë prova me dëshmitarë dhe prova shkresore, duke sqaruar se çfarë faktesh u provuan nga shqyrtimi i tyre. Më tej, gjykata është ndalur në analizën ligjore të provave, çmimin e tyre në raport me kërkesat e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, lidhjen e tyre me njëra-tjetrën dhe bindjen e krijuar nga gjykata pas shqyrtimit të tyre. Në përmbajtjen e vendimit, krahas referencave të shumta në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, por edhe në Kodin Penal në fuqi, gjykata është mbështetur edhe në vendimin Unifikues nr. 4, datë 15.4.2011, të Gjykatës së Lartë lidhur me kuptimin e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale dhe zbatimin e konkluzioneve të atij vendimi në rastin konkret.

Pjesa e tretë - *disponimi i gjykatës*, ka të pasqyruar me saktësi konkluzionin e arritur nga gjykata në pjesën arsyetuese-përshkruese në rastin konkret. Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm

**Dokumenti 3.** Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 27.4.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë<sup>91</sup>, ku subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në trup gjykues me tre gjyqtarë, ku ka qenë kryesues. Gjikimi ka zgjatur 1 vit - brenda afatit 1-vjeçar të përcaktuar nga neni 23, pika 2, e ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Gjykata Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë në seancë gjyqësore publike të datës 27.4.2016, ka vendosur konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të pasurive llogari bankare, duke i specifikuar detajet e tyre.

Mbi ankimin e të paditurve Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.6.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 27.4.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

---

<sup>91</sup> Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 27.4.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, që i përket paditësit Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë kundër të paditurve K.I. dhe Shoqërisë “\*\*\*” me objekt “konfiskimin e llogarive bankare në shumën 6,176.22 USD, 10,132.29 euro, 150,000 USD, 264,500 USD, 2,500.0000 USD etj.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.09.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga z. K.I. kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 27.6.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Vendimi është i arsyetuar në mënyrë të hollësishme dhe pas kontrollit të gjykatave më të larta, është konfirmuar ligjshmëria e tij dhe zgjidhja e drejtë e çështjes nga trupi gjykues me kryesues Sandër Simonin.

Në pjesën hyrëse të vendimit, janë përshkruar palët, paditësi dhe të paditurit, objekti i kërkesës, baza ligjore, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse.

Në pjesën arsyetuese gjejnë pasqyrim rrethanat e çështjes ashtu siç i kanë rezultuar gjykatës gjatë gjykimit. Gjyqtari ka sqaruar arsyet e kërkesës së Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për sekuestrimin e pasurive bankare në vlera monetare që disponohen nga të paditurit. Gjykata ka kryer gjatë procesit gjyqësor edhe një akt ekspertize kontabël, i domosdoshëm për sqarimin e rrethanave për të cilat kërkoheshin njohuri të posaçme teknike.

Pjesa e tretë - *disponimi i gjykatës*, ka të pasqyruar me saktësi dhe hollësi konkluzionin e arritur nga gjykata në pjesën arsyetuese-përshkruese në rastin konkret. Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni ka konstatuar të njëjtat gjetje me ato të evidentuara në raportin e Grupit të Punës pranë KLD-së. Komisioni vëren se të tre dokumentat janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, z. Sandër Simoni të standartizuara në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me vlerësimin profesional.

### **❖ PESË DOSJET GJYQËSORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT REFERUAR RAPORTIT TË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT PRANË KLD-së**

**Dosja 1.** Çështja penale nr. \*\*\* regj. themeltar, datë 24.11.2014 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda<sup>92</sup>, vendim i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka qenë kryesues i të trupit gjykues me 5 gjyqtarë.

### **Vlerësimi nga Grupi Vlerësues pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 21 ditë, në intervalin kohor 24.11.2014 – 15.12.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 12 muaj të përcaktuar nga pika 5, shkronja “f” e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Janë caktuar dy seanca gjyqësore, të cilat kanë qenë produktive. Janë mbikëqyrur aktet e njoftimit pa pasur vonesa në kryerjen e tyre. Në caktimin e seancës së dytë gjyqësore është respektuar afati ligjor. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe janë dokumentuar me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit në gjykim. Ka pasur 11-16 minuta vonesë në fillimin e seancave gjyqësore, por vonesa nuk ka sjellë pengesa në zhvillimin e tyre. Gjyqtari ka orientuar drejt debatin gjyqësor, si dhe ka vepruar me urdhra dhe vendime të ndërmjetme deri në shpalljen e vendimit.

Trupi gjykues ka mbyllur shqyrtimin gjyqësor, është tërhequr për marrjen e vendimit përfundimtar, të cilin e shpalli brenda seancës, duke vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurve, duke vendosur sipas kërkesës së prokurorisë.

---

<sup>92</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. themeltar, datë 24.11.2014 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kundër të pandehurve A.P., V.M. e P.F., të akuzuar për veprat penale të “trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, në tentativë” dhe të “moskallëzimit të krimin”, të parashikuara nga nenet 283/a/2 - 22 dhe 300 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.12.2014.

Vendimi nuk është ankimuar nga palët në proces dhe ka marrë formë të prerë.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kryesekretarinë e gjykatës në datën 19.12.2014 – pas 4 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale

Dokumentacioni në dosje është i rregullt. Në dosje ndodhet fashikulli i prokurorit, urdhri i kryesuesit për formimin e trupit gjykues, vendimi i subjektit të rivlerësimit për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e njoftimit, aktet e hetimit paraprak të bashkuara me fashikullin e gjykimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, procesverbali gjyqësor, konkluzionet përfundimtare të palëve dhe vendimi gjyqësor

Mënyra e komunikimit është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka pasur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.

Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 15.12.2014, është dhënë nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka qenë kryesues i të trupit gjykues i përbërë nga pesë gjyqtarë dhe përmban elementët e përcaktuar nga neni 383 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Vendimi paraqitet me strukturë të qëndrueshme. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni ka konstatuar të njëjtat gjetje me ato të evidentuara në raportin e Grupit të Punës pranë KLD-së. Komisioni vëren se vendimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, z. Sandër Simoni, paraqitet i standardizuar në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me vlerësimin profesional.

**Dosja 2.** Çështja penale nr. \*\*\* regj. themeltar, datë 8.1.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda<sup>93</sup>, ku vendimi gjyqësor është dhënë nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka qenë kryesues i të trupit gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë.

### **Vlerësimi nga Grupi Vlerësues pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 1 muaj e 26 ditë, në intervalin kohor 8.1.2015 - 6.3.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 12 muaj të përcaktuar nga pika 5, shkronja “F”, e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Janë caktuar pesë seanca gjyqësore, nga të cilat katër kanë qenë produktive. Pengesë në 1 seancë joproductive është bërë mungesa e prokurorit dhe e mbrojtësit (seanca 3).

Seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe janë dokumentuar me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit në gjykim. Ka patur 6-32 minuta vonesë në fillimin e seancave gjyqësore, por vonesa nuk ka sjellë pengesa në zhvillimin e tyre. Në rastin kur vonesa ka qenë 32 minuta shkak ka qenë pjesëmarrja e gjyqtarëve në një gjykim tjetër, i cili është relatuar rregullisht nga kryesuesi i seancës (seanca 5). Gjyqtari ka orientuar drejt debatin gjyqësor, si dhe ka vepruar me urdhra dhe vendime të ndërmjetme gjer në shpalljen e vendimit. Dokumentacioni në dosje është i rregullt.

---

<sup>93</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. themeltar, datë 8.1.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kundër të pandehurës L.T., e akuzuar për veprën penale të “trafikimit të lëndëve narkotikëve në tentativë” të parashikuar nga nenet 283/a/1-22 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.3.2015.

Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosje është normale. Mënyra e komunikimit është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka patur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.

Trupi gjykues, pasi është kthyer, ka vendosur: deklarimin fajtores të pandehurës për veprën penale të “trafikimit të narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/a/1 të Kodit Penal, dhe dënimin e saj me 7 vjet burgim sipas dhe kërkesës së Prokurorisë.

Mbi ankimin e të pandehurës, Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda me vendimin përfundimtar nr. \*\*\*, datë 21.4.2015, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 6.3.2015, të Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, me këtë ndryshim. Në zbatim të nenit 406, të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me burgim me një të tretën duke e dënuar përfundimisht të pandehurën L. T., sipas nenit 283/a/1 i Kodit Penal me 4 vjet e 8 muaj burgim”*.

Shkaku i cenimit lidhet me zbatimin e procedurës së gjykimit të shkurtuar pasi sipas Gjykatës së Apelit, duhej pranuar kjo kërkesë nga Gjykata e Shkallës së Parë.

Mbi rekursin e të pandehurës me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.10.2016, Gjykata e Lartë, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 21.4.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë me plotësimin: në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të dënuarën L. T, duke u vendosur në kohë prove 1 vit”*. *Arsyeja e plotësimit të vendimit lidhet me zbatimin e alternativës së dënimit të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal”*.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 6.3.2015, janë dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kryesekretarinë e gjykatës në datën 11.3.2015 – pas 5 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi gjyqësor paraqitet me strukturë të qëndrueshme dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, si dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni ka konstatuar të njëjtat gjetje me ato të evidentuara në raportin e Grupit të Punës pranë KLD-së. Komisioni vëren se cenimi i vendimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda lidhet me zbatimin e procedurës së gjykimit të shkurtuar pasi sipas Gjykatës së Apelit, duhej pranuar kjo kërkesa për gjykim të shkurtuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Në lidhje me mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar të të pandehurës, subjekti i rivlerësimit si kryesues i trupës gjyqësore është bazuar në nenin 404 të Kodit të Procedurës Penale dhe në vendimin Unifikues nr. 2/2003, me argumentin se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet dhe se duhet të merren prova të reja.

Komisioni mban parasysh nenin 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”<sup>94</sup>, se vendimi në fjalë ka të bëjë me vendimmarrjen e subjektit dhe nuk konstatohen problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me vlerësimin profesional.

**Dosja 3.** Çështja penale me nr. \*\*\* regj. them., datë regj. 4.12.2015, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda<sup>95</sup>, ku vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 7.4.2016, është dhënë nga subjekti i rivlerësimit ku në përbërje të trupit gjykues kanë qenë 5 gjyqtarë.

<sup>94</sup> Neni 72/4 i ligjit nr.96/2016 “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin me logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”.

<sup>95</sup> Çështja penale me nr. \*\*\* regj. themeltar, datë regj. 4.12.2015, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kundër të pandehurve M.Gj. e G.G., të akuzuar nga Prokuroria për veprën penale të “trafikimit të narkotikëve në



## **Vlerësimi i çështjes nga Grupi Vlerësues pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 4 muaj e 3 ditë në intervalin kohor 4.12.2015 - 7.4.2016, duke respektuar afatin 12 mujor të përcaktuar nga neni 5 shkronja "f" e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Janë caktuar 12 seanca gjyqësore, nga të cilat 7 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 5 seanca joproduktive kanë qenë mungesa e prokurorit (2 seanca), kërkesa e prokurorit për t'u njohur me aktet (1 seancë), mungesa e mbrojtësve (1 seancë) dhe mungesa e të pandehurit (1 seancë). Janë mbikëqyrur aktet e njoftimit pa patur vonesa në kryerjen e tyre. Në caktimin e seancave gjyqësore janë respektuar afatet ligjore.

Ka pasur seanca të filluara me disa minuta vonesë, por vonesa nuk ka sjellë pengesa në zhvillimin e tyre. Në rastin kur vonesa ka qenë më e lartë se 15 minuta, shkaku i vonesës është relatuar nga kryesuesi i seancës. Gjyqtari ka orientuar drejt debatin gjyqësor, si dhe ka vepruar me urdhra dhe vendime të ndërmjetme gjer në shpalljen e vendimit.

Trupi gjykues në bazë të nenit 378/6 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur deklarinimin fajtor të secilit prej të pandehurve për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike në bashkëpunim, në tentativë të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin e secilit prej tyre me 10 vjet burgim dhe në bazë të kërkesës së Prokurorisë.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin përfundimtar nr. \*\*\*, datë 13.6.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 7.4.2016.

Të pandehurit kanë ushtruar rekurs, por ende Gjykata e Lartë nuk ka dhënë ende vendim.

Nga pikëpamja formale, vendimi përmban 22 faqe dhe paraqitet me strukturë të qëndrueshme. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kryesekretarinë e gjykatës në datën 12.4.2016 – pas 5 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Dokumentacioni në dosje është i rregullt. Në dosje ndodhet fashikulli i prokurorit, urdhri i kryesuesit për formimin e trupit gjykues, vendimi i subjektit të rivlerësimit për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e njoftimit, procesverbalet e deklarimeve të hetimit paraprak të lexuara gjatë gjykimit, procesverbali gjyqësor, konkluzionet përfundimtare të palëve dhe vendimi gjyqësor.

Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosje është normale. Mënyra e komunikimit është në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka pasur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.

Vendimi gjyqësor paraqitet me strukturë të qëndrueshme, janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme.

## **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni ka konstatuar të njëjtat gjetje me ato të evidentuara në raportin e Grupit të Punës pranë KLD-së. Komisioni vëren se vendimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, z. Sandër

---

bashkëpunim, në tentativë", të parashikuar nga nenet 283/a/2 -22 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. 47, datë 7.4.2016.

Simoni, paraqitet i standardizuar në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me vlerësimin profesional.

**Dosja 4.** Çështja civile nr. \*\*\* regj. themeltar, datë 19.7.2016 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda<sup>96</sup>, ku vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 20.7.2016, është dhënë nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard duke respektuar afatin ligjor 5 ditor të përcaktuar nga ligji.

Gjyqtari i vetëm (subjekti) ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë, duke caktuar masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi pasurinë e paluajtshme kullotë me sip. 220 ha në Karaburun, si dhe pasurive të ardhura prej saj (të specifikuara në vendimin e gjykatës).

Vendimi nuk është ankimuar nga palët në proces.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 22.7.2016 – pas 2 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin 5 ditor të masave të sigurimit

Dokumentacioni në dosje është i rregullt. Në dosje ndodhet vendimi i subjektit të rivlerësimit për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e njoftimit, procesverbali gjyqësor dhe vendimi gjyqësor. Procesverbali i seancës gjyqësore është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera. Gjithashtu, procesverbali është i nënshkruar nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari. Dosja paraqitet e inventarizuar rregullisht dhe renditja e akteve nuk vështirëson përdorimin e saj.

Mënyra e komunimit është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka patur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.

Nga pikëpamja formale, vendimi paraqitet me strukturë të qëndrueshme. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni ka konstatuar të njëjtat gjetje me ato të evidentuara në raportin e Grupit të Punës pranë KLD-së. Komisioni vëren se vendimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, z. Sandër Simoni, paraqitet i standardizuar në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me vlerësimin profesional.

**Dosja 5.** Çështja penale nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 20.08.2014 regjistrimi, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda<sup>97</sup>, ku vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 21.08.2014, është dhënë nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm.

Është caktuar dhe zhvilluar një seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive. Janë kryer veprimet procedurale për zgjidhjen e çështjes dhe në përfundim të seancës është disponuar me vendim që ka përfunduar shqyrtimin e çështjes.

---

<sup>96</sup> Çështja civile nr. \*\*\* regj. themeltar, datë 19.7.2016 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me objekt “caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive për pasurinë e paluajtshme kullotë prej 220 ha në Karaburun, si dhe të gjitha pasurive të paluajtshme të derivuara prej saj”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.7.2016.

<sup>97</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. themeltar, datë 20.8.2014 regjistrimi, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me objekt “vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’, ndaj të dyshuarit K.I. për veprën penale të ‘shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë’, e parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.8.2014.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 26 orë, në intervalin kohor 20.8.2014 ora 11:30 – 21.8.2014 ora 13:30, duke respektuar afatin 48 orë të përcaktuar nga pika 5, e nenit 259 të Kodit të Procedurave Penale. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar të përcaktuar nga pika 2, e nenit 28 të Kushtetutës dhe pika 3 e nenit 5, të KEDNj-së.

Gjyqtari i vetëm e ka shpallur vlefhtësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasit K. I., në bazë të kërkesës së Prokurorisë.

Vendimi gjyqësor nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve dhe ka marrë formë të prerë.

Në procesverbalin gjyqësor vihet re se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, për sa i përket përbërjes së gjykatës, kërkesave paraprake dhe dhënies së fjalës palëve ndërgjyqëse, ka qenë i qartë. Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosje është normale. Mënyra e komunikimit është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka patur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.

Dokumentacioni në dosje është i rregullt. Nga pikëpamja formale, vendimi paraqitet me strukturë të qëndrueshme. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni ka konstatuar të njëjtat gjetje me ato të evidentuara në raportin e Grupit të Punës pranë KLD-së. Komisioni vëren se vendimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, z. Sandër Simoni, paraqitet i standardizuar në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me vlerësimin profesional.

### **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË**

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Sandër Simoni janë paraqitur dy ankesa (në vitin 2014) në Inspektoratin e KLD-së. Dy ankesat e paraqitura në vitin 2014, verifikuar bazuar në raportin periodik të kryetarit në lidhje me vendimet e cenuara i janë regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Sandër Simoni përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### **Etika e subjektit**

Komisioni, i informuar nga mjetet e informimit publik, ka konstatuar një rast konflikti ku subjekti është akuzuar nga një kolege e tij gjyqtare, znj. I.K., për plagjiaturë duke shkelur të drejtat e autorit në lidhje me botimin e një teme diplome, problematikë e përfunduar në një konflikt gjyqësor.

Komisioni bëri verifikime në faqen zyrtare *www.gjykata.gov.al* dhe konstatoi se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është zhvilluar procesi gjyqësor me palë paditëse I.K., i paditur Sandër Simoni me objekt “shpërbllim dëmi”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.6.2012, ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar kërkesë ankimore pala paditëse I.K. dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.5.2013 ka vendosur “prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 25.6.2012 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.2.2016 ka vendosur “rrezimin e kërkesë-padisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova.”

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2017, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 8.2.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

Nuk ka të dhëna nëse është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj këtij vendimi nga paditësja I.K.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime rreth konfliktit të konstatuar nga Komisioni, si dhe të depozitujë dokumentacionin respektiv të proceseve gjyqësore të zhvilluara.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar në lidhje me konfliktin gjyqësor<sup>98</sup> dhe ka bashkangjitur vendimet gjyqësore përkatëse të tri shkallëve të gjykimit, që vërteton se ka fituar proceset gjyqësore të nisura kundër tij.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti dhe shpjegimet e tij, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka depozituar prova të plota në lidhje me konfliktin gjyqësor të lartpërmendur, që ka të bëjë me etikën e tij si gjyqtar.

### **KONSTATIME TË TJERA**

Komisioni, nisur nga disa *indicie* të tjera për sa i përket aspektit profesional ka konsideruar të arsyeshme të bëjë hetime të mëtejshme për verifikimin e disa çështjeve penale në ngarkim të disa shtetasve. Për këtë qëllim Komisioni ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe me Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

#### **o Komisioni ka kryer hetime në lidhje me shtetasin I.H.**

Për këtë arsye, Komisioni ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>99</sup>, ku ka kërkuar informacion në lidhje me dosjen penale në emër të shtetasit I.H.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në përgjigje të saj, konfirmon se nga verifikimi nuk rezulton të ketë të pandehur me emrin I.H. por I.H.

Kjo çështje penale është gjykuar nga gjyqtari B.H. me objekt vleftësim i ligjshëm ndalimi ndaj të pandehurit I.R.H. i datëlindjes 17.2.1962, për të cilin gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të tij.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se çështja me të pandehurin I.H. nuk është gjykuar nga subjekti kur ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë kësaj gjykate, por kjo çështje është gjykuar nga një subjekt tjetër.

---

<sup>98</sup> Subjekti ka deklaruar se: “ ... është e vërtetë që kam pasur një mosmarrëveshje me një kolege gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, znj. I.K., ish - studente e Shkollës së Magjistraturës. Si pedagog i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës kam qenë me cilësinë e udhëheqësit në punimin e diplomës së studentes I.K. gjatë vitit akademik 2007. Pas disa viteve, në vitin 2012, kjo ish – studente, tashmë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Shkodër, më shfaqti pretendime për përfshirjen e saj si eksperte në këtë temë dhe në hartimin e manualit duke pretenduar se në të ka dhe pjesë nga punimi i diplomës së saj. Sipas vlerësimit tim, kjo mosmarrëveshje ishte e stisur nga ana e paditëses dhe bashkëshortit të saj avokat, pa ndonjë të drejtë e arsye, por nisur nga pakënaqësitë e tyre personale ndaj meje nisur nga qëndrimet parimore të miat. Edhe shkrimi në media në lidhje me këtë dhe të quajturit si akuzë për plagjiaturë është bërë me qëllim dëmtimi i imazhit tim publik. Nga ana e saj u mendua si një rast që duhej zgjidhur me padi gjyqësore dhe në vitin 2012 ka depozituar padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Proceset gjyqësore kanë përfunduar në favorin tim në të dyja shkallët e gjykimit me vendim të formës së prerë, duke u rrezuar padia e paditëses I.K. ngritur kundër meje”.

<sup>99</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2019, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

○ **Komisioni ka kryer hetime në lidhje me shtetasin K.H.N.**

Për këtë arsye Komisioni ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda<sup>100</sup>, ku ka kërkuar informacion në lidhje me çështjet penale në ngarkim të shtetasit K.H.N., e cila ka konfirmuar se nuk janë dhënë vendime nga kjo gjykatë ndaj këtij shtetasi.

Komisioni ka kryer korrespondencë dhe me Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda<sup>101</sup> nëse ka pasur të regjistruar kallëzime, procedime apo janë dhënë vendime ndaj shtetasit K.H.N. dhe kjo e fundit konfirmon se ndaj shtetasit K.N. nuk rezultojn të jetë regjistruar procedim penal në ngarkim të tij.

Komisioni ka kryer korrespondencë me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a.,<sup>102</sup> ku i ka kërkuar informacion në lidhje me të dhënat e personit që disponon numrin e telefonit \*\*\*, si dhe praktikën e regjistrimit të tij.

Shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. konfirmon se numri \*\*\* është regjistruar në fillim në emër të shtetasit K. N. i datëlindjes ... .. në datën 20.10.2005 dhe është deaktivizuar datë 23.7.2012. Më pas, ky numër është rihedhur përsëri në treg dhe është aktivizuar në emër të shtetasit Ç. G. i datëlindjes ... .. dhe më pas në datën 17.12.2017 ka kaluar në emër të S. N. i datëlindjes ... .., i cili e përdor aktualisht.

**Vlerësim i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë gjykuar çështje në ngarkim të shtetasit K.N., si dhe nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur të regjistruar në emër të tij apo të ketë përdorur numrin e telefonit \*\*\*.

○ **Komisioni ka kryer hetime në lidhje me shtetasit L.K., A.L., F.Ç. dhe M.Ç., E.Y., A. dhe P.K., R.Sh. dhe I.K.**

Komisioni, në korrespondencën e kryer me Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda<sup>103</sup>, ku ka kërkuar informacion në lidhje me çështjet penale në ngarkim të shtetasve të sipërpërmendur.

Gjykata ka konfirmuar se për shtetasit F.Ç. dhe M.Ç., E.Y., A. dhe P.K. dhe I.K. nuk rezultojn që kjo gjykatë të ketë dhënë vendime ndaj tyre.

Për shtetasit R.Sh., L.K., A.L., gjykata ka vendosur në dispozicion dosjet penale që ka gjykuar kjo gjykatë, por rezultoi se në asnjë nga trupat gjyquese nuk rezultojn që të ketë qenë pjesëmarrës në gjykimin subjekti Sandër Simoni.

**Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë pjesë e trupës që ka gjykuar për personat e pandehur. Këta të pandehur janë gjykuar nga subjekte të tjera.

**DENONCIMET NGA PUBLIKU**

Ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Sandër Simoni, janë depozituar 7 denoncime nga publiku.

**1. Denocim i shtetasit M.H. me nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2018**

<sup>100</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2019, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

<sup>101</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krimet e Rënda.

<sup>102</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.8.2019, nga “\*\*\*\*”.

<sup>103</sup> Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2019; \*\*\* prot., datë 2.9.2019; \*\*\* prot., datë 13.9.2019.

Shtetasi M.H. ngre ankesa kryesisht për subjektin B.D., por në faqen e parë të ankesës përmend 10 subjekte të tjera, duke përfshirë edhe subjektin Sandër Simoni. Gjatë ankesës, denoncuesi i referohet vetëm subjektit B.D. dhe jo subjektit të rivlerësimit Sandër Simoni.

#### **Vlerësim i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin bashkangjitur këtij denoncimi, vlerëson se ankuesi gjatë gjithë deklaramit i referohet subjektit B. D. dhe nuk përmend subjektin e rivlerësimit, z. Sandër Simoni, nuk jep asnjë *indicie* apo prova, që ta lidhë me çështjen në fjalë.

#### **2. Denoncim i shtetasit M.G. me nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2018**

Shtetasi M.G. ngre ankesa ndaj Prokurorisë së Krimeve të Rënda, si dhe ndaj Gjykatës së Krimeve të Rënda, përfshirë edhe subjektin Sandër Simoni, duke pretenduar se djali i tij, i cili është dënuar me 10 vite burg për trafikim lëndësh narkotike është i pafajshëm. Në lidhje me këtë denocim, kjo dosje ka qenë dhe pjesë e pesë dosjeve me short për subjektin e rivlerësimit, z. Sandër Simoni, për të cilën nuk janë konstatuar problematika.

Prokuroria e Krimeve të Rënda në konkluzionet përfundimtare ka kërkuar: deklaramin fajtor të shtetasit M.Gj. dhe G.G. për veprën penale të trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe dënimin e tyre me nga 10 vjet secili.

Gjykata e Krimeve të Rënda (ku subjekti Sandër Simoni ka qenë kryesues i trupës me pesë gjyqtarë), me vendimin nr. \*\*\*, datës 7.4.2016, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të shtetasit M.Gj. dhe G.G. për veprën penale të trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe dënimin e tyre me nga 10 vjet secili.”

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.6.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 7.4.2016.

Të pandehurit kanë ushtruar rekurs, por deri në datën e hartimit të këtij raporti, Gjykata e Lartë nuk ka dhënë ende vendim.

#### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie* apo prova që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin profesional.

#### **3. Denoncim i shtetasës M.H. me nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2018**

Shtetasja M.H. ngre ankesë për tri subjekte: F.H., D.M. dhe Sandër Simoni. Në ankimin e saj, kjo denoncuese nuk ka dhënë asnjë *indicie* apo provë në lidhje me një vendim të padrejtë dhe të pabazuar që pretendon se është dhënë nga trupi gjykues dhe pa referuar asnjë *indicie* apo provë konkrete.

#### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie* apo prova që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin profesional.

#### **4. Denoncim i shtetasit V.Ç. me nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2018**

Shtetasi V.Ç., në ankesën e tij, denoncon ngre ankesa për shumë subjekte rivlerësimi, duke përfshirë edhe subjektin Sandër Simoni, të cilin e denoncon pasi i është drejtuar me disa shkresa dhe nuk i ka kthyer përgjigje, por nuk ka referuar ndonjë *indicie* apo rrethanë konkrete që e lidh denoncuesin me subjektin e rivlerësimit.

#### **Vlerësim i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie* apo prova që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin profesional.

#### **5. Denoncim i shtetasit A.V. me nr. \*\*\* prot., datë 30.8.2019**

Shtetasi A.V. ngre ankesa për prokurorinë, Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda dhe subjektin Sandër Simoni e përmend si anëtar i trupit gjykues të gjykuar në Shkallë të Parë.

Denoncuesi nuk ka dhënë asnjë *indicie* apo provë konkrete që penalizon subjektin e rivlerësimit, z. Sandër Simoni.

#### **Vlerësim i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie* apo prova që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin profesional.

#### **6. Denoncim i shtetasit V.Ç. me nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2019**

Shtetasi V.Ç., në ankesën e tij, ngre ankesa për shumë subjekte rivlerësimi duke përfshirë edhe subjektin Sandër Simoni për moskthim përgjigje.

Këtë denoncim shtetasi V.Ç. ia ka drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili e ka përcjellë në Komision. Ky denoncim është i njëjtë me denoncimin e bërë më parë nga ky shtetas.

#### **Vlerësim i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie* apo prova që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin profesional.

#### **7. Denoncim i shtetasit E.F. me nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2019**

Shtetasja E.F. ngre ankesa për subjektet F.P., A.Q., A.N., E.V. dhe Sandër Simoni dhe kërkon nga Komisioni shkarkimin e tyre.

Në fillim ankuesja i referohet z. V.P., i cili ndërhyrte te gjyqtarja F.P. në një çështje ku është palë në Gjykatën e Apelit Administrativ. Z. V.P. ka qenë shefi i saj në një punë të mëparshme.

Subjektin Sandër Simoni ankuesja e akuzon se ka ndërhyrë te gjyqtarja F.P., pasi ky është edhe kushëri i parë me z. V.P.

Ankuesja E.F. kërkesës së saj i ka bashkangjitur vetëm një kallëzim penal, që supozohet se e ka depozituar te Prokuroria e Krimeve të Rënda (atë që referohet nga Komisioni më lart, ankuesja i referon në kallëzimin penal). Ankuesja E.F. nuk ka bashkangjitur prova apo të ketë dhënë *indicie* konkrete për sa pretendon në ankimin e saj.

#### **Vlerësim i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie* apo prova që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin profesional.

### **V. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Trupi gjykues, referuar nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Sandër Simoni:

- a. ka kryer deklarim të mjaftueshëm dhe të saktë të pasurisë;
- b. nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi tij dhe i personit të lidhur me të, si dhe huat ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruar.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Sandër Simoni, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Sandër Simoni, *ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, nga vlerësimi i secilit prej tri kriterëve:

- a. ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, sepse nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë, ka kryer deklarim të mjaftueshëm dhe të saktë të pasurisë, si dhe nuk rezulton me balancë financiare negative për vitet 2003 – 2016, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas nenit 59/b, të ligjit nr. 84/2016;
- c. konsiderohet “i aftë”, në vlerësimin e aftësive profesionale duke përmbushur kushtet ligjore të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 1/a, të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Sandër Simoni, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Vendimi, i arsyetuar, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.



3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
U shpall në Tiranë, në datën 17.1.2020.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Brunilda Bekteshi**

**Kryesuese**

**Olsi Komici**

**Relator**

**Roland Ilia**

**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore  
Olsida Goxhaj*